



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS**

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS

“Efektiviteti i procesit të certifikimit të materialit mbjellës bimor (fara e fidanë), i përdorur nga fermerët”

Tiranë 2023

PËRMBAJTJA

1. Përmbledhja.....	5
2. Problemi Social dhe Rëndësia e Auditimit	6
2.1 Konteksti i Problemit Social	6
2.2 Rëndësia e auditimit të Performancës.....	7
3. Subjekti/et nën auditim	8
3.1 Hyrje në subjektet nën auditim	8
3.2 Baza ligjore që rregullon çështjen nën auditim.....	13
3.3 Rëndësia e produkteve të subjektit.....	15
3.4 Peshë në buxhet.....	16
3.5 Përkufizimet dhe terminologjia.....	19
3.6 Skema e analizës së programit.....	21
3.7 Feedback-u i subjektit në fazën studimore.....	22
4. Detajet e auditimit.....	22
4.1 Vlerësimi i risqeve të aktiviteteve të subjektit	22
4.2 Pyetjet e auditimit	26
4.3 Fushëveprimi i auditimit	26
5. Shtjellimi i pyetjeve audituese	27
5.1 A ekziston një kuadër ligjor dhe rregullator i plotë dhe me ndarje të qarta të roleve dhe përgjegjësi mes aktorëve të përfshirë?	27
5.1.1 A kanë hartuar dhe miratuar institucionet përgjegjëse politika të duhura për menaxhimin dhe inspektimin e procesit të certifikimit të materialit shumëzues mbjellës bimor?	27
5.1.2 A kanë garantuar institucionet përgjegjëse mbikëqyrje të plotë ndaj furnizuesve dhe përdoruesve të materialit mbjellës shumëzues bimor?	33
5.2.1 A janë koordinuar midis tyre institucionet përgjegjëse lidhur me procesin e monitorimit, certifikimit, inspektimit të materialit mbjellës shumëzues bimor?	33
5.2.2 A i kanë shërbyer të ardhurat dytësore të krijuara nga ESHFF, AKU, QTTB, përmirësimit të menaxhimit të materialit shumëzues mbjellës bimor?	48
5.2.3. A kanë në dispozicion strukturat e kontrollit dhe inspektimit të AKU, QTTB-ve, ESHFF-së logjistikën e nevojshme dhe burimet njerëzore të mjaftueshme për realizimin e detyrave kontrolluese dhe inspektuese?	54
6. Grupi i punës	68
7. Anekset.....	Error! Bookmark not defined.

LISTA E SHKURTIMEVE

MBZHR	Ministria e Bujqësisë dhe e Zhvillimit Rural
SBZHRP	Strategjia e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Peshkimit, 2021–2027
ESHFF	Enti shtetëror i Farërave dhe Fidanëve
QTTB	Qendra e Transferimit të Teknologjisë Bujqësore
AKVMB	Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve
AKU	Autoriteti Kombëtar i Ushqimit
ARSHVMB	Agjencitë Rajonale të Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve
DRSHVMB	Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve
KVVRKK	Komisioni i Vlerësimit të Varieteteve për Regjistrim në Katalogun Kombëtar
KSHAV	Komisioni Shtetëror i Atestimit të Varieteteve
KK	Katalogu Kombëtar
BE	Bashkimi Evropian
ISTA	Shoqata ndërkombëtare e testimit të farërave (International Seed Testing Association)
UPOV	Unioni ndërkombëtar për mbrojtjen e varieteteve të reja të bimëve (International Union for the protection of new varieties of plants)
DA	Drejtoria e Auditimit
DPPPBSUZHPR	Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Programeve të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural dhe Peshkimit
DPSHBFFP	Drejtoria e Politikave të Shëndetit të Bimëve Farërave Fidanëve, Plehrave
DPSU	Drejtoria e Politikave të Sigurisë Ushqimore
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
CAC	Konformiteti Agrar i Komunitetit
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
PIK	Pikë e Inspektimit Kufitar
RSH	Republika e Shqipërisë
MSA	Marrëveshja e Stabilizim Asociimit
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
AGJVBP	Agjenda e gjelbër për vendet e Ballkanit Perëndimor
AFP	Arsimimi dhe formimi profesional
AM IPARD	Autoriteti menaxhues – Instrumenti për asistencë para aderimit për zhvillim rural
AKU	Autoriteti Kombëtar i Ushqimit
AT	Asistencë teknike
BE	Bashkimi Evropian
BB	Banka Botërore
BBP	Bio ekonomia e Bazuar në Pyje
CEFTA	Marrëveshje e Tregtisë së Lirë për Evropën Qendrore
DP	Drejtoria e Përgjithshme
FAO	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Ushqimin dhe Bujqësinë

GIZ	Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
INSTAT	Instituti i statistikave
IPA	Instrumenti për asistencë para aderimit
IPARD	Instrumenti për asistencë para aderimit për zhvillim rural
KMBM	Kushte të Mira bujqësore dhe mjedisore
KPNK	Kontributi i përcaktuar në nivel kombëtar
LEADER	Qasja e zhvillimit të rajoneve me drejtim/vendimmarrje të komunitetit (Liaison Entre Actions de Développement de l'Economie Rurale)
OBU	Operatorët e Biznesit Ushqimor
ONP (ILO)	Organizata Ndërkombëtare e Punës
OJF	Organizatë jofitimprurëse
OSHC	Organizatë e Shoqërisë Civile
OP	Organizata e Prodhuesve
DUS	Dallueshmëria Uniforme tërë dhe Stabiliteti i varietetit
VKP	Vlera e Kultivimit dhe Përdorimit
GFLV	Virusi i gjetheve të rrushit (Grapevine fanleaf virus)
QKL	Qendra Kombëtare e Licencimit
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
DDD	Dezinfektim, Dezinsektim, Deratizim
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (Organisation for Economic Co-operation and Development)
MMSHB	Materiali mbjellës shumëzues dhe bimor
PMP	Produkt për Mbrojtjen e Bimëve
DPPB	Drejtori i Përgjithshëm i Politikave Bujqësore

1. PËRMBLEDHJA

Zhvillimi bujqësor është shumë i rëndësishëm për sa i përket përmirësimit të standardit të jetesës dhe zbutjes së varfërisë. Përveç efekteve të drejtpërdrejta, rritja e të ardhurave dhe ushqimit për familjet bujqësore, do të ketë ndikim edhe në standardin e jetesës, si në zonat urbane, ashtu edhe në ato rurale, përmes produkteve ushqimore me çmime më të ulëta.

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka audituar bashkëveprimin e MBZHR dhe institucioneve të varësisë: ESHFF, AKU dhe Qendrat e Teknologjisë dhe Transformimit Bujqësor në lidhje me menaxhimin e integruar të materialit mbjellës shumëzues në shërbim të fermerëve dhe prodhimit bujqësor dhe procesin e monitorimit. Materiali mbjellës e shumëzues bimor, (fara e fidanë) duhet të jetë i prodhuar nën përgjegjësinë e kultivuesit nga bimë që kultivohen në përputhje me praktikën e pranuar për ruajtjen e pastërtisë varietore dhe ku janë zbatuar masa parandaluese ndaj organizmave të dëmshëm të bimëve, i cili destinohet për prodhimin e materialit bazë të shumëzimit. Nëpërmjet këtij auditimi u mundësua se pavarësisht përpjekjeve pozitive në drejtim të procesit të certifikimit, testimit dhe monitorimit të MMSHB, masat e marra nga institucionet duhet të ishin më efektive. Edhe pse, Enti Shtetëror i Farave si një institucion i krijuar prej vitit 2015 ka bërë hapa pozitivë në kuadër të përmirësimit të situatës në tërësi, evidentohen mangësi në plotësimin e kuadrit ligjor me akte nënligjore të përditësuara. Në përgjigje të pyetjes kryesore: A janë institucionet e menaxhimit të integruar të materialit mbjellës shumëzues bimor (fara e fidanë) në shërbim të fermerëve dhe prodhimit bujqësor? konstatuam se:

- Roli i “pa dukshëm” i MBZHR-së në këtë zinxhir nuk ka sjellë përmirësim të kontrollit dhe monitorimit permanent të materialit mbjellës shumëzues bimor i cili ndikon drejtpërdrejt në rritjen e sigurisë ushqimore.

- Mungesa të strukturave të dedikuara në MBZHR deri në korrik 2022, mungesa me burime njerëzore në ESHFF dhe QTTB, mungesa në investime për laboratorët e certifikimit të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor me infrastrukturën e nevojshme bashkëkohore, kanë sjellë performancë të dobët të sistemit të kontrollit dhe të inspektimit nga institucionet e varësisë.

- Nuk janë realizuar ende nga MBZHR dhe ESHFF¹, rekomandimet e UPOV-it duke mos respektuar bashkëpunimin me UPOV, ku vendi ynë aderonte me të drejta të plota.

- Nuk janë miratuar akte administrative normative nënligjore (udhëzime dhe urdhra), të cilat sjellin zgjidhje jo plotësisht racionale në përmirësimin e cilësisë mbi prodhimin bimor i siguruar nga material mbjellës shumëzues bimor (fara dhe fidanë).

- Nuk mbahet regjistër tip nga Sektori i Testimit të Varieteteve ku të evidentohet i gjithë procesi që kalon testimi dhe regjistrimi i varieteteve nga kërkesat për testim e regjistrim, arkëtimi i tarifave, kryerjen e testeve, deri në vendimmarrjen e KVVRRKK për testimet dhe regjistrimet në Katalogun Kombëtar.

- Rezultoi rënie e numrit të regjistrimeve të varieteteve të reja në Katalogun Kombëtar, për periudhën 2020-2022, si pasojë e mos finalizimit të procesit regjistrimit në Katalogun Kombëtar për varietetet e reja të testuar nga Enti Shtetëror i Farave e Fidanëve dhe të miratuara nga Komisioni i Vlerësimit të Varieteteve (KVVRRKK) ku nga 157 teste varietetesh janë regjistruar në Katalogun Kombëtar vetëm 41 prej tyre ose 26 % e numrit total çka tregon menaxhim pa efektivitet të burimeve njerëzore si në ESHFF, KVVRRKK ashtu edhe për Qendrat e Transferimit të Teknologjive Bujqësore në rajone. Konkretisht për periudhën në auditim, nuk janë regjistruar 116 varietete në Katalogun Kombëtar të specieve dhe varieteteve duke sjellë të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit në vlerën 2,320,000 lekë. (116 x 20,000).

¹ Përgjigja e pyetësorit nr.2 datë 26.06.2023 nga MBZHR (Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së bimëve dhe Peshkimit).

-Mos kryerja e asnjë çregjistrimi të varieteteve nga Katalogu Kombëtar prej Sektorit të Testimit të Varieteteve për shkak të tejkalimit të afateve të regjistrimit për një periudhë rreth 26 vjet, sjell risk të shtuar në sigurinë ushqimore pasi bazuar në këtë katalog inspektorët e AKU kryejnë verifikimin në PIK të farave dhe fidanëve të importuar.

-Mungesa e bashkëpunimit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural me institucionet e varësisë në drejtim të përpunimit të të dhënave vjetore në fushën e prodhimit dhe të tregtimit të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të krahasuar me sipërfaqet e mbjella të tij, mungesa e të dhënave në bashkërendim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave për importet dhe eksportet e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor ka ndikuar negativisht në hartimin e një plani korrekt dhe gjithë përfshirës me bazë risku për kontrollin e subjekteve prodhuese dhe tregtuese të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor si dhe nuk ka sjellë maksimizimin e të ardhurave që do të krijoheshin nga certifikimi i materialit mbjellës shumëzues bimor.

2. Problemi Social dhe Rëndësia e Auditimit

2.1 Konteksti i Problemit Social

Shqipëria ka një shumëllojshmëri klimash. Klima në Shqipëri është mesdhetare në pjesën bregdetare dhe në zonën malore ndihet klima e butë-kontinentale dhe malore.

Shqipëria, me një sipërfaqe prej 28,748 km², shquhet për relievin e saj mjaft të larmishëm. Rreth dy të tretat e territorit përbëhen nga male dhe kodra, ndërsa një e treta e mbetur është fushore, e cila shtrihet kryesisht në perëndim, përgjatë bregdetit të Adriatikut. Ky reliev i pasur, me thyerje dhe mikro forma të shumta, i pasur me burime ujore, pyje dhe florë e faunë, ofron mundësi për veprimtari bujqësore në blegtori (kryesisht të imta) dhe agro turizëm.

Një nga potencialet më të mëdha natyrore të Shqipërisë është numri i lartë i orëve me diell, tregues për të cilin Shqipëria renditet ndër vendet e para në Evropë.

Struktura e kulturave kryesore

Sipërfaqja totale bujqësore e shfrytëzuar e Shqipërisë është 1,174,081 hektarë, e strukturuar siç paraqitet në tabelën 1.

Tabela 1. Toka bujqësore në Shqipëri sipas përdorimit (2020).

Përdorimi bujqësor	Sipërfaqja (ha)	Shpërndarja në përqindje
Tokë are	611,346	52.07%
Kullota dhe livadhe	478,081	40.72%
Kulturat shumëvjeçare	84,654	7.21%

Burimi: MBZHR²

Zhvillimi bujqësor është shumë i rëndësishëm për sa i përket përmirësimit të standardit të jetesës dhe zbutjes së varfërisë. Përveç efekteve të drejtpërdrejta, rritja e të ardhurave dhe ushqimit për familjet bujqësore, do të ketë ndikim edhe në standardin e jetesës, si në zonat urbane, ashtu edhe në ato rurale, përmes produkteve ushqimore me çmime më të ulëta. Bota duhet të përballë me sfidën e plotësimit të nevojave të menjëhershme të ushqimit të njerëzve, duke mbështetur në të njëjtën kohë programe që ndërtojnë elasticitet afatgjatë. Alternativa është uria në një shkallë katastrofike.³ Gjithashtu migrimi i madh i të rinjve në Shqipëri 10-vjeçarin e fundit për arsye pune

²Plani i veprimit për përdorimin e qëndrueshëm të produkteve për mbrojtjen e bimëve në Shqipëri për vitet 2022-2032.

³ <https://www.wfp.org/emergencies/global-food-crisis>

ndikon negativisht në disponueshmërinë e forcës së punës në zonat rurale dhe përbën një sfidë të rëndësishme për të ardhmen e zhvillimit bujqësor dhe rural.

Materialit mbjellës e shumëzues bimor, (fara e fidanë) duhet të jetë i prodhuar nën përgjegjësinë e kultivuesit nga bimë që kultivohen në përputhje me praktikën e pranuarë për ruajtjen e pastërtisë varietore dhe ku janë zbatuar masa parandaluese ndaj organizmave të dëmshëm të bimëve, i cili destinohet për prodhimin e materialit bazë të shumëzimit. Materiali i shumëzimit rrjedh nga shumëzimi direkt i materialit bazë të shumëzimit ose materiali fillestar, i destinuar për prodhimin e bimëve të reja (fidanëve) ose të pjesëve të bimëve të destinuara për prodhimin e frutave, rrushit, ullinjve dhe agrumeve.

Pikërisht duke pasur parasysh misionin e departamentit është propozuar edhe tema mbi Efektivitetin dhe këqyrjen e procesit të materialit mbjellës për fara e fidanë, menaxhimin e këtij sistemi duke bashkë renduar punën me Qendrat e Teknologjisë dhe Transformimit bujqësor në 4 rajone dhe Autoritetin Kombëtar të Ushqimit, me cilësi dhe në kohë, për t' u ardhur në ndihmë fermerëve me qëllim garantimin e sigurisë ushqimore nëpërmjet kontrollit dhe mbjelljes së fidanëve dhe farave të certifikuara, kryerjes së analizave laboratorike në laboratorin e testimit të farave, për të gjitha mostrat e ardhura nga pikat zonale të testimit, sipas përcaktimeve ligjore. Tërësia e procesit të materialit shumëzues mbjellës e bimor në të cilën kalon fara nga kontrolli institucionale nga MBZHR, AKU, ESHFF dhe QTTB, është një komponent i rëndësishëm për të arritur te konsumatorët (fermerët) një farë me cilësi e parametra të larta në fuqinë e mbirjes, në fidanë të shëndetshëm të cilët shndërrohen në të korra me rendiment të lartë dhe cilësor.

2.2 Rëndësia e auditimit të Performancës

Auditimi në përgjithësi ka të bëjë me ekzaminimin sistematik dhe të pavarur të dokumentacionit tërësor të një institucioni, ndërsa auditimi i performancës për këqyrjen e procesit të certifikimit të materialit mbjellës bimor nga fermerët është një shqyrtim i pavarur, objektiv dhe i besueshëm i faktit nëse politikat qeveritare të bujqësisë kanë përcaktuar:

a) kushtet për prodhimin, përgatitjen tregtimin, përfshirë importin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor:

i) të bimëve bujqësore, të cilat përfshijnë drithërat, foragjeret, patatet, panxharin, bimët e vajit e të fibrave, perimet, pemët drufrutore, hardhitë, humusit, bimët eterovajore dhe medicinale të kultivuara;

ii) të bimëve dekorative;

iii) të bimëve pyjore;

b) detyrimet e personave të angazhuar në prodhimin, përgatitjen për treg, tregtimin, importimin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor; si dhe nëse operacionet financiare janë të mjaftueshme, aktivitetet e strukturave në varësi të MBZHR-së veprojnë në përputhje me parimet e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit dhe nëse ekziston mundësia për përmirësim të mëtejshëm.

Kultivimi i perimeve është një profesion mjaft i thjeshtë, por kërkon më shumë forcë dhe vëmendje. Shumica prej nesh në ditët e sotme janë të angazhuar në këtë profesion në shtëpi dhe kjo nuk është për t'u habitur, pasi edhe në shtëpi duhet të bëhen përpjekje për të marrë rezultatin e dëshiruar.

KLSH, nëpërmjet auditimeve, bën transparente përdorimin e fondeve publike, administrimin e pronës publike, kryerjen në kohë, me cilësi dhe kosto optimale të materialit mbjellës fara e fidanë, etj. Kryerja e auditimeve në përgjithësi dhe atyre të performancës në veçanti nga KLSH bëhet në përputhje të plotë me standardet INTOSAI dhe EUROSAT, të cilat gjejnë pasqyrim në **Strategjinë**

e Zhvillimit të KLSH 2023-2027⁴ dhe në Manualin e Auditimit të Performancës, miratuar me Vendim nr.196 datë 26.11.2021, të Kryetarit të KLSH-së.

Me shtimin e zhvillimeve të reja të cilat sjellin me vete edhe risqe të reja, auditimi i performancës sa vjen edhe bëhet më i rëndësishëm për të siguruar mbrojtjen e interesit publik. Për këtë, Kontrolli i Lartë i Shtetit gjithmonë e më shumë po vendos theksin në rritjen e numrit dhe të cilësisë të auditimeve, veçanërisht atyre të performancës.⁵

2.3 Auditime të mëparshme apo aktuale në këtë fushë.

KLSH bazuar në ligjin e tij organik ka kryer vazhdimisht auditime financiare e të përputhshmërisë dhe performancës, në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoritetin Kombëtar të Ushqimit, Qendra të Transferimit të Teknologjive Bujqësore, por auditimi i performancës me temë “Efektiviteti dhe këqyrja e procesit të certifikimit të materialit mbjellës për fara e fidanë” është për herë të parë që kryhet. Ky auditim ka për qëllim të auditojë performancën e procedurave për të gjitha hallkat e prodhimit, riprodhimit, shumëzimit, përpunimit dhe ruajtjes së materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, deri në vendosjen e tij në treg; performancën e testimit dhe të regjistrimit në Katalogun Kombëtar (KK); dhe nisur nga puna në terren u përcaktua që periudha e auditimit të shtrihet në periudhën 2020-2022, ku do të përfshihet edhe historiku dhe veprimtaria funksionale e institucioneve përkatëse në vite për të dhënë një tablo sa më të qartë të funksionimit të këtij sistemi me rëndësi për garantimin e sigurisë ushqimore dhe kryerjen e kontrolleve fushore, marrjen e mostrave për kryerjen e analizave laboratorike për çdo material mbjellës dhe shumëzues bimor, që kërkohet të certifikohet, duke zbatuar kërkesat dhe procedurat e përcaktuara në ligj dhe në aktet nënligjore, për këtë qëllim duke siguruar që shërbimi të jetë cilësor, profesional dhe në kohë.

3. Subjekti/et nën auditim

3.1 Hyrje në subjektet nën auditim

Subjekte të këtij auditimi janë institucionet shtetërore në nivel të qeverisjes qendrore (dhe institucionet e tyre të varësisë) që janë përgjegjëse për:

- ✓ Zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 10416, date 07.04.2011, “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”, si dhe të akteve nënligjore, të miratuara, në zbatim të tij.
- ✓ Ndjekjen e procedurave për të gjitha hallkat e prodhimit, riprodhimit, shumëzimit, përpunimit dhe ruajtjes së materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, deri në vendosjen e tij në treg;
- ✓ Monitorimin e rrjetit zonal për provat krahasuese për testim, të cilave u nënshtrohen varietetet e reja të prodhuara në vend ose të importuara për riprodhim, shumëzim e tregtim. Mbi bazën e rezultateve të provave krahasuese dhe metodave laboratorike bëhet vlerësimi, testimi dhe regjistrimi në Katalogun Kombëtar (KK)
- ✓ Ndjekjen e kryerjen e kontrolleve fushore, marrjen e mostrave për kryerjen e analizave laboratorike për çdo material mbjellës dhe shumëzues bimor, që kërkohet të certifikohet, duke zbatuar kërkesat dhe procedurat e përcaktuara në ligj dhe në aktet nënligjore, për këtë qëllim;

Subjektet nën auditim janë:

1. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe institucionet e varësisë:

⁴ KLSH: Strategjia e Zhvillimit Institucional 2023-2027, miratuar me Vendim nr.247 datë 29.12.2022

⁵Ligji nr. 10416, datë 07.04.2011, “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”, dhe aktet nënligjore;

2. Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve (ESHFF)⁶
3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU)
4. Qendrat e Transferimit të Teknologjisë Bujqësore⁷ (më tej QTTB)

Lidhja dhe varësia e subjekteve në auditim jepet në organigramën e mëposhtme:





Figura 1: Punoi grupi i auditimit

Bazuar në temën e auditimit tonë po paraqesim organigramën e pjesshme të MBZHR në lidhje me drejtoritë dhe sektorët që kanë detyrë funksionale menaxhimin dhe hartimin e politikave për materialin mbjellës bimor.

Figura 2 - Organigrama e pjesshme e MBZHR



I. Ndër të tjera MBZHR kujdeset për hartimin dhe zbatimin e politikave për sigurinë ushqimore, cilësinë e produkteve ushqimore, duke përfshirë gjithë zinxhirin ushqimor nga ferma në tavolinë; Hartimin dhe zbatimin e politikave për shëndetin e kafshëve e të bimëve, si dhe për garantimin e shëndetit të njerëzve nga sëmundjet që rrjedhin prej tyre; nëpërmjet Drejtorisë së Politikave të Shëndetit të bimëve (DPSHB) dhe Sektorit të Farave, fidanëve dhe produkteve plehëruese

⁶ VKM nr.204 datë 04.03.2015 “Për organizimin dhe funksionimin e ESHFF” në përputhje të plotë me kërkesat e ligjit nr. 10416 datë 07.04.2011 “ Për materialin mbjellës, shumëzues bimor”.

⁷ VKM nr. 515, datë 19.07.2006 “Për ristrukturimin e Instituteve Kërkimore Shkencore në varësi të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit”, i ndryshuar.

(SFFPP), sipas Urdhrit nr. 185, datë 29.03. 2023 “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të MBZHR-së

Detyrat dhe përgjegjësitë e DPSHB:

- a. Harton politikat dhe strategjitë për mbrojtjen e bimëve (shëndetin e bimëve dhe produktet për mbrojtjen e bimëve), materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, OMGJ dhe të produkteve plehëruese duke përafruar legjislacionin e BE-së në fushën e tij të përgjegjësisë;
- b. Harton legjislacionin, duke e përafruar me legjislacionin e BE-së, në fushën e tij të përgjegjësisë për mbrojtjen e bimëve (shëndetin e bimëve dhe produktet për mbrojtjen e bimëve), materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, OMGJ (Kapitulli 12 i *Acquis*) dhe të produkteve plehëruese (Kapitulli 1 i *Acquis*);
- c. Monitoron veprimtarinë e shërbimeve në kuadër të mbrojtjes së bimëve;
- ç. Harton rregulla për masat e veçanta të kontrollit për të parandaluar hyrjen dhe përhapjen e dëmtuesve brenda vendit;
- d. Koordinon dhe mbikëqyr zbatimin e Planin të veprimit për përdorimin e qëndrueshëm të produkteve për mbrojtjen e bimëve;
- dh. Zhvillon procedurat në lidhje me regjistrimin e PMB-ve, përbërësve aktivë, si dhe shtesave dhe bashkë formulimeve;
- e. Zhvillon procedurat në lidhje me regjistrimin e produkteve plehëruese;
- ë. Kontribuon në planifikimin e nevojave financiare për luftën kundër dëmtuesve;
- f. Vlerësimin e ndikimit rregullatorë.

Kjo drejtori përbëhet nga 2 sektorë.

Sektori i Farëve, Fidanëve dhe Produkteve Plehëruese dhe Sektori i Shëndetit, Mbrojtjes së Bimëve dhe Mbetjet

Sektori i Farëve, Fidanëve dhe Produkteve Plehëruese, ka këto përgjegjësi:

Qëllimi: Hartimi i politikave, strategjive dhe legjislacionit në fushën e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor (MMSHB), OMGJ dhe Produkteve Plehëruese dhe zbatimin e legjislacionit të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, OMGJ, si dhe për produktet plehëruese për rritjen e efikasitetit në të ushqyerit e bimëve, duke mbrojtur mjedisin dhe konsumatorin.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- a. Harton politikat, strategjitë dhe legjislacionin për prodhimin, regjistrimin, tregtimin, importin, eksportin, përdorimin, kontrollin e cilësisë, gjurmueshmërinë, informimin, reklamimin dhe inspektimin e veprimtarive që lidhen me produktet plehëruese, si dhe kushtet për prodhimin, përgatitjen për tregtim, tregtimin, përfshirë importin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor;
- b. Harton politikat dhe legjislacionin për produktet plehëruese;
- c. Zhvillon procedurat në lidhje me regjistrimin e produkteve plehëruese;
- ç. Mbikëqyr zbatimin e procedurave ligjore mbi regjistrimin, kontrollin, tregtimin, certifikimin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor;
- d. Harton Politikat dhe Legjislacionin për Materialin Mbajellës dhe Shumëzues Bimor dhe OMGJ-ve.

II. Enti Shtetëror i Farëve dhe Fidanëve është person juridik publik, që funksionon në varësi të ministrit, me financim nga Buxheti i Shtetit sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 10416, date 07.04.2011, “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”, si dhe të akteve nënligjore, të miratuara, në zbatim të tij.

Qëllimi i këtij institucioni është përcaktimi i rregullave për sigurimin e cilësisë së materialit mbjellës dhe shumëzues bimor për mbështetjen e prodhimit bujqësor, mbrojtjen e mjedisit dhe të konsumatorit, sipas Ligjit nr. 10416, date 07.04.2011. Ndër detyrat kryesore të ESHFF janë:

1. Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve:

- a) ndjek procedurat për të gjitha hallkat e prodhimit, riprodhimit, shumëzimit, përpunimit dhe ruajtjes së materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, deri në vendosjen e tij në treg;
- b) monitoron rrjetin zonal për provat krahasuese për testim, të cilave u nënshtrohen varietetet e reja të prodhuara në vend ose të importuara për riprodhim, shumëzim e tregtim. Mbi bazën e rezultateve të provave krahasuese dhe metodave laboratorike bën vlerësimin, testimin dhe regjistrimin në Katalogun Kombëtar (KK);
- c) ndjek kryerjen e kontrolleve fushore, marrjen e mostrave për kryerjen e analizave laboratorike për çdo material mbjellës dhe shumëzues bimor, që kërkohet të certifikohet, duke zbatuar kërkesat dhe procedurat e përcaktuara në ligj dhe në aktet nënligjore, për këtë qëllim;
- ç) kryen aprobinin fushor për të gjitha ngastrat e mbjella, për prodhimin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor;
- d) pajis materialin mbjellës dhe shumëzues bimor me certifikatën zyrtare për çdo specie dhe varietet;
- dh) kryen analizat laboratorike, në laboratorin e testimit të farave, për të gjitha mostrat e ardhura nga pikat zonale të testimit, sipas përcaktimit në ligjin nr. 10416, datë 7.4.2011, “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”, dhe akteve nënligjore;
- e) propozon tarifa të reja financiare, lidhur me shërbimet që kryen ESHFF-ja për çdo furnizues të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, të cilat miratohen me udhëzim të përbashkët të ministrit dhe ministrit të Financave;
- f) bashkëpunon me organizmat ndërkombëtare, si dhe me institucionet homologe të shteteve të tjera, për përditësimin e kriterëve që aplikohen për testimin dhe certifikimin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor;
- g) informon, periodikisht, MBZHR-në për certifikimin zyrtar të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, varietetet e reja, që janë në proces testimi apo regjistrimi në Katalogun Kombëtar, të specieve e varieteteve të reja të përditësuara, përdorimin e fondeve buxhetore nëpërmjet situacionit të shpenzimeve si dhe regjistrin e prokurimeve publike, etj.
- h) realizon të ardhura nga pagesat që bëjnë subjektet juridike e fizike për:
- i) kryerjen e analizave të materialit mbjellës e shumëzues bimor;
- ii) shërbimin e certifikimit zyrtar;
- iii) testimin e varieteteve të reja, në prova krahasuese, në rrjetin zonal.

Struktura organizative dhe organika e ESHFF –së miratohet me urdhër të Kryeministrit.

ESHFF-ja organizohet si më poshtë vijon:

- a. Sektori i Testimit
- b. Sektori i Certifikimit
- c. Sektori i Laboratorit
- d. Sektori i Financës




Figura 3: Organigramma e Entit Shtetëror të farave dhe Fidanëve

III. Gjatë fazës së terrenit të këtij auditimi dhe pas fokusimit të problemit nga grupi i auditimit u përfshinë si raste studimore *Qendrat e Transferimit të Teknologjisë Bujqësore*⁸ (më tej QTTB). *Qendrat e Transferimit të Teknologjisë Bujqësore* (më tej QTTB) janë institucione të varësisë së MBZHR të cilat kanë për detyrë:

- Identifikimin, testimin, përshtatjen dhe futjen në praktikat bujqësore të metodave dhe materialeve (in puteve) të reja për vendin.
- Përgatitjen e paketave teknologjike për kulturat bujqësore kryesore dhe mbarështimin e kafshëve.
- Kërkime dhe teste në ferma bujqësore për problemet e ngritura nga fermerët e rajoneve përkatës.
- Trajnime për specialistë të bujqësisë, fermerë, studentë të shkencave bujqësore dhe subjekte të tjerë të interesuar.

Konkretisht janë 5- QTTB të emërtuara në vijim:

1. QTTB Fushë-Krujë aplikon eksperimente dhe studime për bimët bishtajore me graminore (tërshërë, elb, gruri dhe bimët foragjere (jonxhë, tërfil) etj.
2. QTTB Shkodër, aplikon eksperimente për bimën e misrit, bimët aromatike e mjekësore të kultivuara si dhe duhanin.
3. QTTB Lushnjë, aplikon eksperimente për drithërat dhe perimet.
4. QTTB Vlorë, aplikon eksperimente për ullinjtë dhe agrumet.
5. QTTB Korçë, aplikon eksperimente për pemët frutorë-farore (molla) dhe bimët e arave (patate, elb, thekër) etj.

IV. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU), është institucion në varësi të MBZHR dhe është përgjegjës për vlerësimin e riskut që bazohet në vlefshmërinë e të dhënave shkencore dhe të vendimeve të marra në mënyrë të pavarur, objektive dhe transparente, në lidhje me farërat dhe fidanët në tregun vendas. AKU-ja funksionon në varësi të ministrit, sipas përcaktimit të bërë në

⁸ VKM nr. 515, datë 19.07.2006 “Për ristrukturimin e Instituteve Kërkimore Shkencore në varësi të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit”, i ndryshuar.

legjislacionin në fuqi për ushqimin. Detyrat e AKU-së për realizimin e qëllimit të këtij ligji⁹ janë si më poshtë:

- a) të kontrollojë materialin mbjellës dhe shumëzues bimor të furnizuesit, në çdo kohë dhe në çdo vend ku ai prodhohet, magazinohet, përpunohet, përgatitet për treg e tregtohet;
 - b) të kontrollojë materialin mbjellës dhe shumëzues bimor nëse plotëson kërkesat e përcaktuara në këtë ligj;
 - c) të kontrollojë në magazinat e furnizuesve ose në treg materialin mbjellës shumëzues bimor të importuar, për plotësimin e kërkesave për tregtim, të përcaktuara në këtë ligj;
 - ç) të kontrollojë përfituesit e kontratave publike të shërbimeve,
- Inspektori i AKU-së kontrollon plotësimin e kërkesave për tregtim, ose merr mostra dhe i dërgon për analiza laboratorike.¹⁰

3.2 Baza ligjore që rregullon çështjen nën auditim.

Baza ligjore kryesore që rregullon aktivitetin e subjektit lidhur me çështjen nën auditim që do të jetë burimi i kriterëve të auditimit.

Kriteret politike

- Plani i Përafrimit të Legjislacionit të Planit Kombëtar të Integritimit Evropian (PKIE)
- Strategjia ndër sektoriale për zhvillimin rural dhe bujqësor (SNZHRB), miratuar me VKM nr. 709, datë 29.10.2014”Për miratimin e strategjisë për vitet 2014-2020.
- Strategjia e Bujqësisë, zhvillimit rural dhe peshkimit për vitet 2021-2027, miratuar me VKM. Nr. 460, datë 29.06.2022.

Kriteret teknike

- Ligji nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”
- Ligj nr.10 416, datë 7.4.2011 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”.
- Ligj Nr. 105/2015 “Për Disa Shtesa Dhe Ndryshime Në Ligjin Nr. 10 416, Datë 7.4.2011, “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”, të ndryshuar.
- VKM Nr. 332, datë 18.4.2013 “Për përcaktimin e kriterëve të tregtimit e të certifikimit të farave të perimeve”.
- VKM Nr. 523, datë 13.7.2016 “Për përcaktimin e kriterëve të tregtimit e certifikimit të materialeve të shumëzimit dhe të fidanëve të bimëve zbukuruese”.
- VKM Nr. 319, datë 27.4.2016 “Për përcaktimin e procedurës e të metodës së testimit të varieteteve”.
- VKM Nr. 574, datë 24.6.2015 “Për kriteret e tregtimit, certifikimit dhe testimit të farës së patates”.
- VKM Nr. 204, datë 4.3.2015 “Për organizimin dhe funksionimin e Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve”.
- VKM Nr. 309, datë 21.5.2014 “Për kriteret e tregtimit, certifikimit dhe testimit të farës së panxharit”.
- VKM Nr. 530, datë 13.6.2013 “Për përcaktimin e kriterëve të tregtimit dhe të certifikimit të materialit mbjellës dhe shumëzues të perimeve, përveç farës”.
- VKM Nr. 240, datë 27.3.2013 “Për përcaktimin e kriterëve të tregtimit dhe të certifikimit të materialeve të shumëzimit dhe të fidanëve të bimëve drufrutore”.

⁹ Ligji 10416, datë 7.4.2011 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”, neni 42

¹⁰ Ligji 10416, datë 7.4.2011 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”, neni 24, pika 4,5.

- VKM Nr. 531, datë 13.6.2013 “Për përcaktimin e përbërjes dhe të mënyrës së funksionimit të komisionit të vlerësimit të varieteteve për regjistrim në katalogun kombëtar”.
- Udhëzim Nr. 5, datë 16.2.2012 “Për sasitë e tregtueshme të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, varieteti i të cilit është në proces regjistrimi në katalogun kombëtar, si dhe për formën dhe përmbajtjen e kërkesës për autorizimin e importit të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të certifikuar jo përfundimisht ose në proces regjistrimi në katalogun kombëtar”.
- Udhëzim nr. 5, datë 7.4.2016 “Për ndryshimin e Udhëzimit nr. 5, datë 12.2.2012, “për sasitë e tregtueshme të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, varieteti i të cilit është në proces regjistrimi në katalogun kombëtar, si dhe për formën dhe përmbajtjen e kërkesës për autorizimin e importit të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të certifikuar jo përfundimisht ose në proces regjistrimi në katalogun kombëtar”.
- Udhëzim Nr.620, datë 29.12.2005 “Për strukturën varietore të fidanëve dhe materialeve të shumëzimit vegetativ të hardhisë, që prodhohen në vend dhe importohen”.
- Udhëzimi nr. 9 datë 29.05.2014 “Për një ndryshim në udhëzimin nr. 8, datë 08.05.2007 “Mbi tarifat e të ardhurave dytësore të aplikueshme ndaj institucioneve të varësisë dhe MBUMK”.
- VKM nr. 515, datë 19.07.2006 “Për ristrukturimin e Institucioneve kërkimore e shkencore në varësi të Ministrisë së Bujqësisë”. Sot quhen Qendra të transformimit të teknologjive bujqësore (QTTB).

Autoriteti Kombëtar Ushqimor (AKU).

- Ligji Nr.10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.
- Ligji Nr.10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.
- Ligji Nr. 106/2016 “Për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre”.
- Ligj Nr. 87/2013 “Për kategorizimin e prodhimit, emërtimin dhe tregtimin e vajit të ullirit dhe vajit të bërsisë së ullirit”.
- Ligj Nr. 105/2016 “Për mbrojtjen e bimëve”
- VKM Nr.463, datë 5.7.2006 “Për miratimin e planit kombëtar për zbatimin e marrëveshjes së stabilizim-asociimit”.
- VKM Nr. 335, datë 6.6.2018 “Për miratimin e rregullave për regjistrimin, të procedurës dhe kriterëve të vlerësimit të produkteve për mbrojtjen e bimëve”.
- VKM Nr. 434, datë 11.7.2018 “Për etiketimin e ushqimeve dhe informimin e konsumatorit”.
- VKM Nr. 760, datë 16.9.2015 “Për kërkesat për gjurmimin e ushqimit dhe ushqimit për kafshë përgjatë zinxhirit ushqimor”.
- VKM Nr. 708, datë 9.9.2020 “Për organizimin dhe funksionimin e autoritetit kombëtar të ushqimit”.

- VKM Nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”.

Kriteret e monitorimit dhe raportimit

Urdhrat për monitorimin e:

- Autorizimit të importeve të veçanta
- Regjistrimit të varieteteve në Katalogun Kombëtar
- Testimin e varieteteve sipas species ose hibridit
- Certifikimin, ri etiketimin dhe ri ambalazhimit e fidanëve
- Raporte vjetore monitorimi;
- Raporte nga Auditi i Brendshëm i MBZHR-së.

Kriteret e tjera/Praktikat më të mira

- Akte të tjera ligjore dhe nën ligjore në funksion të auditimit.

3.3 Rëndësia e produkteve të subjektit.

Fara është baza e jetës në bujqësi, shërben për sigurinë ushqimore si dhe ruajtjen e bio diversitetit. Ajo është gjithashtu një mjet për ofrimin e teknologjive të reja dhe shërbimeve mbështetëse në zonat rurale. Farërat dhe fidanët janë komponentët më vitalë të sistemit bujqësor që shërbejnë si një element i rëndësishëm në strategjitë për zhvillimin e bujqësisë dhe uljen e varfërisë. Rëndësia e farërave cilësore po kuptohet dhe po shihet gjithashtu si një mjet bazë për një furnizim të sigurt ushqimor për shkak të pasigurisë ushqimore që po ndodh nëpër botë. Farat cilësore sigurojnë një qëndrueshmëri të mirë të korrjes për shkak të cilësive të tyre të larta gjenetike dhe fiziologjike. Pra, me përmirësimet institucionale dhe teknologjike në sektorët e farërave, farat cilësore mund të përdoren si zgjidhje për sigurinë ushqimore, përveç vetë-mjaftueshmërisë ushqimore. Burimi i mirë i farërave për pemët duhet të sigurojë një material mbjellës të shëndetshëm me rritje të shpejtë, gjenetikisht të larmishëm. Përzgjedhja e burimeve të mira të farës rezulton në fara me cilësi të lartë dhe për këtë arsye arrihen produkte përfundimtare superiore. Cilësia gjenetike e burimit të farës është faktori vendimtar për suksesin e çdo programi të mbjelljes së pemëve, prandaj burimet e farës duhet të identifikohen dhe zgjidhen me kujdes. Përzgjedhja e burimeve të farës bazohet në supozimin se karakteristikat e pemëve të farës ka të ngjarë të transmetohen te pasardhësit e tyre. Fermerët zakonisht mbjellin pemë në ferma ose toka komunitare për të rritur produkte që plotësojnë nevojat shtëpiake dhe kërkesat e tregut. Farat e pemëve, një input kyç që përcakton suksesin e çdo aktiviteti të mbjelljes së pemëve, shpesh janë në mungesë.

Prodhimi i frutave dhe perimeve përballet ende me sfida të ndryshme, përfshi informalitetin e sektorit të materialit mbjellës, kostot e larta të inputeve të blera dhe lëndës djegëse (që prekin veçanërisht serrat me ngrohje), produktivitetin e ulët dhe humbjet e mëdha të pas vjeljes, sidomos në rastin e frutave. Standardet e sigurisë ushqimore të frutave dhe perimeve janë gjithashtu një sfidë për t'u adresuar që të rriten eksportet drejt tregjeve të shteteve anëtare dhe drejt atyre që pritet të bëhen anëtare të BE-së. Zhvillimi i industrisë së përpunimit të frutave dhe perimeve është penguar nga vështirësitë për të siguruar lëndën e parë për industrinë e përpunimit në sasi të mjaftueshme dhe cilësinë e kërkuar. Me rritjen e ofertës nga ferma, kjo vështirësi është më pak e rëndësishme se në të kaluarën, por industrinë në këtë sektor po ndeshen akoma me mjaft vështirësi: menaxhimi i dobët i zinxhirit të vlerës

- kontratat formale ose jo formale mes industrisë dhe fermave

- nuk ka ndihmuar për sa i përket sigurimit të ofertës së lëndës së parë nga ferma për industrinë e përpunimit.

Sipërfaqet totale të kultivuara (Tabela 2) me tokë arë dhe vreshta, janë relativisht të qëndrueshme, totali i sipërfaqeve me agrume, perime në fushë të hapur dhe mbi të gjitha perime serre, është rritur ndjeshëm në vitin 2019 krahasuar me vitin 2015, duke treguar një rritje graduale të orientimit të bujqësisë për treg.

Tabela 2. Sipërfaqet e kultivuara (2015 – 2019)

Kultura	Sipërfaqja e kultivimit (ha) në vitin					Ndryshimi (2015-2019)	
	2015	2016	2017	2018	2019	Vlera (ndryshimi ne ha)	%
Perimet	37,168	38,803	39,423	39,468	41,440	4,272	11.49
Perimet e serrës	1,244	1,406	1,540	1,650	1,734	490	39.39
Pemishtet	205	205	203	185	190	-15	-7.37
Ullishtat	9,225	9,608	9,786	10,008	10,288	1,063	11.52
Agrumet	1,282	1,354	1,394	1,454	1,521	239	18.64
Vreshtat	10,438	10,533	10,695	10,787	10,842	404	3.87
Total	59,562	61,909	63,041	63,552	66,015	6,453	10.83

Burimi: MBZHR 2020

Përdorimi i ulët dhe i paekuilibruar i plehrave organike dhe minerale, mos aplikimi i qarkullimeve të duhura bujqësore, masat jo efektive për mbrojtjen e bimëve, teknikat e papërshtatshme të bujqësisë për nevojat vetjake, masat jo efektive për sigurimin e kullimit, përmbytjet, shtimi i erozionit për shkak të shpyllëzimit pa kriter, të cilat janë evidentuar në shumë raste, ndikojnë në uljen e pjellorisë si dhe në degradimin e tokave bujqësore. Përmasa e vogël mesatare e fermave, niveli i lartë i fragmentimit, investimet e vogla lidhur me tokën, erozioni, degradimi dhe humbja e tokës bujqësore (për përdorime të tjera) vazhdojnë të jenë sfida të mëdha për ekonominë tonë.

Për sa më sipër *Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural* (më tej MBZHR) është përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e politikave orientuese, mbështetëse dhe nxitëse për prodhimin bujqësor e blegtoral, si dhe kujdeset për zhvillimin e koordinuar të bujqësisë. Ajo përcakton politikat dhe zbaton mbështetjen financiare të qeverisë për fermerët dhe agrobizneset bazuar në politikat e programit të qeverisë për mbështetjen e tyre; harton dhe zbaton politikat për sigurinë ushqimore, cilësinë e produkteve ushqimore, duke përfshirë gjithë zinxhirin ushqimor nga ferma në tavolinë; harton dhe zbaton politikat për shëndetin e bimëve, si dhe për garantimin e shëndetit të njerëzve nga sëmundjet që rrjedhin prej tyre. Në këtë auditim përveç MBZHR-së, janë përfshirë edhe *Enti Shtetëror i Farave*, Qendrat e Transferimit të Teknologjisë Bujqësore (më tej QTTB), si dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU), të cilat së bashku me MBZHR janë përgjegjëse për konceptimin dhe zbatimin e politikave shtetërore për çështjet e bujqësisë dhe zhvillimit rural, sigurisë ushqimore e mbrojtjes së konsumatorit, përafrimin e legjislacionit dhe krijimin e një baze të konsoliduar ligjore brenda fushës së përgjegjësisë, në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.

3.4 Pesha në buxhet.

Buxheti për materialet mbjellëse bimore (fara e fidanë) të përdorur nga fermerët, është akorduar në buxhetin e programeve;

- “Siguria Ushqimore dhe Mbrojtjes së Konsumatorit” për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, dhe AKU-në,

- “Zhvillimi Rural” për ESHFF-në dhe
- “Këshillimi dhe Informacioni Bujqësor” për QTTB-të




Figura 4: Buxheti i programeve “Siguria Ushqimore”, “Zhvillimi Rural” dhe “Këshillimi dhe Informacioni Bujqësor” fakt viti 2022.(në 000/lekë)

Gjatë periudhës 2020-2021, buxheti i planifikuar për materialet mbjellëse bimore (fara e fidanë) të përdorur nga fermerët është 330,063 mijë lekë; janë shpenzuar për këtë periudhë **313,515** mijë lekë ose 95 % e buxhetit të planifikuar, pasqyruar në tabelat e mëposhtme.

Tabela 3: Buxheti i MBZHR, AKU, ESHFF dhe QTTB-ve për periudhën 2020- 2022
(në lekë)

	Llogaria Ekonomike	Buxheti Fillestar	Plani (ndryshime)	Fakti
2020 I	“Pagat dhe përfitimet e punonjësve” 600	67,726,894	62,286,825	58,663,429
	“Kontribute për sigurime shoqërore & shëndetësore” 601	8,964,720	8,070,933	7,467,734
	“Blerje mallrash & shërbimesh” 602	25,558,126	23,934,595	21,729,076
	“Transferte korrente e familjare” 605,606	140,000	140,000	210,000
	“Investime afatgjata materiale” 231	15,850,000	15,850,000	14,626,000
	Totali	118,239,740	110,282,353	102,696,239
2021 II	Llogaria Ekonomike	Buxheti Fillestar	Plani (me ndryshime)	Fakti
	“Pagat dhe përfitimet punonjësve” 600	71,343,344	69,809,105	67,894,898
	“Kontribute për sigurime shoqërore & shëndetësore” 601	9,468,653	9,333,513	8,986,317
	“Blerje mallrash& shërbimesh” 602	28,239,367	27,533,483	25,535,746
	“Transferte korrente e familjare” 605,606	70,000	138,000	207,700
	“Investime afatgjata material” 231	9,880,000	960,000	532,000

	Totali	119,001,364	107,774,101	103,156,661
2022 III	Llogaria Ekonomike	Buxheti Fillestar	Plani (me ndryshime)	Fakti
	“Pagat dhe përfitimet punonjësve” 600	71,090,105	67,201,794	64,723,937
	“Kontribute për sigurime shoqërore & shëndetësore” 601	9,576,951	8,613,141	8,441,036
	“Blerje mallrash & shërbimesh” 602	27,941,237	26,245,938	25,017,169
	“Transferte korrent e familjare” 605,606	360,000	906,000	959,450
	“Investime afatgjata material” 231	9,040,000	9,040,000	8,521,000
	Totali	118,008,294	112,006,873	107,662,592
IV	TOTALI I+II+III	355,249,398	330,063,327	313,515,492

Punoi grupi i auditimit, burimi MBZHR.

Referuar tabelës së mësipërme, sipas llogarive ekonomike për materialet mbjellëse bimore (fara e fidanë) të përdorur nga fermerët, rezulton se realizimi i buxhetit në vitin 2020 është në masën 94% të tij, për të vijuar me rritje të realizimit të buxhetit në masën 95% në vitin 2021 dhe në vitin 2022 në masën 96%, rezulton një performancë efektive krahasuar me buxhetin e miratuar. Për tre vitet 2020-2022 janë kryer ndryshime buxhetore në pakësim të tij, përkatësisht për vitin 2020 në masën 6% të buxhetit të planifikuar, për vitin 2021 është ndryshuar me 12%, dhe për vitin 2022, ndryshuar me 5% me pak se buxheti fillestar.

Sa i përket peshës që ka buxheti i planifikuar për materialet mbjellëse bimore (fara e fidanë) të përdorur nga fermerët, ndaj buxhetit të MBZHR-së gjithsej, rezulton se për periudhën 2020-2022, pesha që ka pasur buxheti i dedikuar për këto materiale ndaj buxhetit të MBZHR-së, është rreth 4% në vitin 2020, 3% në vitin 2021 dhe 2% në vitin 2022.

Tabela 4. Pesha në buxhetin faktik të MBZHR-së.

(në 000/lekë)

Programi "Siguria Ushqimore dhe Mbrojtjes së Konsumatorit"(SU)	Buxheti faktik 2020	Buxheti faktik 2021	Buxheti faktik 2022
ESHFF(1)	40,138	28,940	34,837
AKU(2)	54,499	65,734	62,801
QTTB (3)	4,488	4,904	6,446
MBZHR(4)	3,571	3,578	3,578
Total programi Siguria Ushqimore 04220 (5)	1,375,681	1,580,034	1,709,233
Total programi Zhvillimi Rural 04250 (6)	3,491,253	6,386,930	8,787,252
Total programi Këshillimi dhe Informacioni Bujqësor , 04860 (7)	426,731	560,410	616,423

Total i buxhetit të MBZHR (8)	10,040,608	12,849,087	13,559,803
Pesha e programit SU ne buxhetin e MBZHR-së (%) (5)/(8)	14%	12%	13%
Pesha e programit ZhR ne buxhetin e MBZHR-së (%) (6)/(8)	35%	50%	65%
Pesha e programit KIB ne buxhetin e MBZHR-së (%) (7)/(8)	4%	4%	5%
Pesha e ESHFF në buxhetin e MBZHR-së (%) (1)/(8)	0.4%	0.2%	0.3%

Burimi MBZHR, përpunoi grupi i auditimit.

Në këtë mënyrë shpenzimet faktike për materialet mbjellëse bimore (fara e fidanë) të përdorur nga fermerët, zënë një peshë të vogël në shpenzimet buxhetore që kryen MBZHR-ja në shkallë vendi, gjithashtu duhet vënë në dukje, se shpenzimet buxhetore nuk kanë ndjekur të njëjtën prirje të rritjes proporcionale të tyre siç ka ndodhur me buxhetin e përgjithshëm të MBZHR-së ndër vite.

3.5 Përkufizimet dhe terminologjia

- "ESHFF" është Enti Shtetëror i Farërave dhe i Fidanëve në Ministrinë e Bujqësisë dhe Ushqimit.
- "KSHAV" është Komisioni Shtetëror i Atestimit të Varieteteve, i cili funksionon pranë ESHFF-së dhe që shqyrton, kualifikon ose jo varietetet e reja, të cilat shënohen në regjistrin e së drejtës të seleksionuesit.

- "Bord apelimi" është organi që ka për detyrë shqyrtimin e ankesës së aplikantit për vendimet e KSHAV-it për të drejtën e seleksionuesit.

- "Patentë" nënkupton dokumentin ligjor që vërteton të drejtën e seleksionuesit dhe emërtimin e varietetit.

- "Licencë e detyrueshme" nënkupton licencën e dhënë në mbështetje të këtij ligji.

- "UPOV" është Unioni Ndërkombëtar për Mbrojtjen e Varieteteve të Reja.

- "Mutant" nënkupton një bimë të re të përftuar nga një varietet i njohur më parë, si rezultat i ndryshimeve thelbësore të ndodhura në rrugë natyrore ose të nxitura artificialisht.

- "Regjistri i aplikimit" është regjistri që mbahet nga ESHFF-ja për të gjithë personat që aplikojnë për të fituar të drejtën e seleksionuesit të bimëve. Aplikimet e këtij regjistri botohen periodikisht.

- "Regjistri i së drejtës të seleksionuesit" është regjistri ku regjistrohen të gjithë personat fizikë dhe juridikë që kanë fituar të drejtën e seleksionuesit. Edhe ky regjistër mbahet nga ESHFF-ja. Të dhënat e këtij regjistri botohen periodikisht.

- "Certifikim zyrtar" është një procedurë e përcaktuar, që kryhet nga ESHFF-ja, në bazë të kërkesës së paraqitur nga furnizuesi

- "Farat bazë (për bimët e arave, si drithëra, perime, patate, foragjere etj.)" janë:

i) farat e prodhuara në përputhje me praktikën e pranuar për ruajtjen e pastërtisë varietore dhe shëndetësore, të parashikuara për prodhimin e farave të kategorisë "Fara të certifikuar"; 1961.

- "Material i certifikuar (për bimët drufrutore)" është materiali që rrjedh nga shumëzimi direkt i materialit bazë të shumëzimit ose materiali fillestar, i destinuar për prodhimin e bimëve të reja (fidanëve) ose të pjesëve të bimëve të destinuar për prodhimin e frutave, rrushit, ullinjve dhe agrumeve.

-“Komisioni i Vlerësimit të Varieteteve për Regjistrim në Katalogun Kombëtar (KVVRKK)” është organ që ngrihet dhe funksionon sipas përcaktimeve të këtij ligji.

“Material mbjellës dhe shumëzues bimor” janë farat, fidanët, e gjithë bima ose pjesë të saj, si tuberat, bulbat, rizomat, kalemat, sythat, nënshartesat, shartesat e të tjera, nëse janë përcaktuar për:

a) shtim ose/dhe riprodhim të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor;

b) mbjellje me qëllim prodhimin e bimëve.

-“Laborator reference” është laborator i cili vlerëson cilësinë dhe besueshmërinë e kryerjes së analizave laboratorike për treguesit cilësorë të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor.

varieteteve ose kategorive të njëjta, të identifikueshme për origjinën dhe për homogjenitetin e tyre,

-“Testim” janë provat krahasuese, që kryhen në dy a më shumë zona, për të vërtetuar.

aftësitë prodhuese dhe cilësore të një varieteti. për Mbrojtjen e Varieteteve të Reja të Bimëve.

- “Varietet” është një grup bimor, brenda një taksoni të vetëm botanik, të nivelit më të ulët të klasifikimit, që mund të jetë:

a) i përcaktuar nga shprehja e karakteristikave që rezultojnë nga një gjenotip i dhënë ose kombinim gjenotipesh;

b) i dallueshëm nga një grupim tjetër bimor nga shprehja e të paktën njëre nga karakteristikat e sipërpërmendura;

c) i konsideruar si një grupim, me qëllim përshtatshmërinë e tij për t’u shumëzuar i pandryshuar.

nuk janë shënuar si të tilla.

-“Materiale shumëzimi dhe fidanë të certifikuar”, materialet e shumëzimit dhe fidanët pajisur me certifikatë zyrtare, që vërteton identitetin, pastërtinë varietore dhe pastërtinë fito sanitare nga organizmat dhe sëmundjet e dëmshëm, të listuar në aneksin 2 bashkëlidhur këtij vendimi.

- “Shumëzim”, riprodhimi me mënyrë vegjetative ose mënyra të tjera, i bimëve zbukuruese.

-“Numër i referencës së lotit” ose “numër i referencës së ngarkesës”, çdo shenjë numerike ose alfanumerike, e cila mundëson që lotet ose ngarkesat të dallohen dhe të gjurmohen.

-“Person përgjegjës i kualifikuar”, çdo person, fizik ose juridik, me profesion agronom ose inxhinier për mbarështimin e pyjeve, me arsim të lartë, në cilësinë e furnizuesit ose i punësuar prej tij, dhe që ka akt përfaqësimi nga furnizuesi për të vepruar në emër të tij për detyrimet që rrjedhin nga ligji nr. 10416, datë 7.4.2011, “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”, të ndryshuar.


- “Material shumëzues”, pjesët e bimëve dhe gjithë materiali bimor, përfshirë nënshartesat, të destinuara për shtimin dhe prodhimin e perimeve.

- “Material mbjellës”, bimë të tëra dhe pjesë të tyre, duke përfshirë, për bimët e shartuara, komponentët e shartimit, të destinuara për mbjellje për prodhimin e perimeve.

- “Identitet”, tërësia e veçorive botanike, biologjike dhe morfologjike që zotëron një varietet, vlera e të cilave është e njohur dhe plotëson qëllimet e përdorimit.

- ISTA Shoqata ndërkombëtare e testimit të farërave.

3.6 Skema e analizës së programit.



3.7 Feedback-u i subjektit në fazën studimore

Gjatë fazës studimore, grupi i auditimit ka mbledhur të dhëna nga MBZHR, ESHFF, AKU e Qendrat e transferimit të teknologjive bujqësore (QTTB): Lushnjë, Vlorë, Korçë, Fushë-Krujë dhe Shkodër. Nga takimet paraprake me drejtuesit përkatës të institucioneve të sipërcituar u krijua një tablo më e qartë mbi ecurinë e aktivitetit dhe performancës për materialin mbjellës e shumëzues bimor të përdorur nga fermerët dhe procesin e certifikimit të tyre. Subjektet kanë vendosur në dispozicion informacionin e kërkuar në format elektronik në përgjigje të kërkesave nga grupi i auditimit në formë pyetësori drejtuar çdo institucioni, drejtorie etj. Pyetësorët janë hartuar në përputhje me dispozitat e nenit 15, pika dh, të Ligjit 154/2014 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”. Subjektet në auditim kanë qenë të disponueshëm në garantimin e informacionit dhe dokumenteve të kërkuara.

4. DETAJET E AUDITIMIT

4.1 Vlerësimi i risqeve të aktiviteteve të subjektit

Risqet e aktivitetit të subjekteve janë ato risqe me të cilat përballen institucionet e audituara për realizimin e funksioneve dhe përgjegjësi që lindin nga aktiviteti i tyre në drejtim të hartimit dhe monitorimit të zbatimit të politikave, strategjive, programeve e legjislacionit specifik të mbrojtjes së bimëve, materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, OMGJ dhe të produkteve plehëruese me synimin parandalimin e hyrjes së dëmtuesve në territorin e Republikës së Shqipërisë, rritjen e efikasitetit në të ushqyerit e bimëve si dhe mbrojtjen e shëndetit të njerëzve, kafshëve dhe mjedisit nga përdorimi i produkteve për mbrojtjen e bimëve dhe produkteve plehëruese.

Risqet e subjekteve të audituar përfshijnë funksionimin e strukturave të ESHFF dhe AKU nëpërmjet administrimit efektiv dhe eficient të burimeve njerëzore (specialistë, laborantë, inspektorë, etj.) shfrytëzimit të mekanizmave të financimit për sigurimin e analizave të certifikuara laboratorike, mbulimin me kontrole dhe monitorime të fermerëve në përdorimin e farave dhe fidanëve të certifikuar nga ESHFF, për sigurimin e dhe mbrojtjen e shëndetit të njerëzve, kafshëve dhe mjedisit. Në përmbledhje për sa më sipër risqet që përballen subjektet e auditimit janë sigurimi që certifikimi dhe testimi i varieteteve të reja të jetë cilësor, profesional dhe në kohë duke zbatuar parimet e **ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit**. Në tabelën në vijim janë grupuar risqet sipas nivelit strategjik dhe operacional. Janë marrë në konsideratë vetëm risqet e nivelit mesatar dhe të lartë, si dhe është analizuar niveli i vështirësisë që hasin subjektet në tejkalimin e këtyre risqeve. Për të përcaktuar nivelin e riskut, grupi i auditimit është bazuar në SBZHRP 2021-2027, Plane të Monitorimit në terren për periudhën 2020-2022, Analiza vjetore 2020-2022, aktet nënligjore dhe rregulloret e brendshme të institucioneve subjekt auditimi të cilat jo gjithmonë janë të sinkronizuara ligjet si dhe evidentimin paraprak të mangësive logjistike të këtyre institucioneve. Në funksion të përmbushjes së kësaj kornize, është lidhur secili risk me pyetjet audituese që drejtojnë këtë program auditimi.

Kjo analizë paraqitet në tabelat në vijim.

Tabela 5. Analiza SWOT e trajtimit të procesit për materialin mbjellës e shumëzues bimor

FUQITË (S)

Strategjia e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Peshkimit 2021-2027.

Legjislacioni për materialin mbjellës e shumëzues bimor në procesin e certifikimit të farave dhe fidanëve.

Legjislacioni për mbrojtjen e bimëve.

Legjislacioni për të drejtën e seleksionerit të bimëve. (Varietetet autoktone shqiptare të raportuara në UPOV).

Komisioni i Vlerësimit të Varieteteve për Regjistrim në Katalogun Kombëtar. (KVRKK)

Bashkëpunimi i ESHFF me QTTB-të në kryerjen e procesit të plotë për testimin e farave dhe fidanëve të importuar, mbjelljen e tyre deri në marrjen e produktit përfundimtar.

Inspektimi dhe kontrolli i dokumentacionit, si dhe shqyrtimi pamor dhe/ose laboratorik i materialit mbjellës dhe shumëzues bimor nga AKU tek furnizuesit.

Katalogu Kombëtar i testimit të Varieteteve.

Pajisja me certifikatë fito-sanitare të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor për sigurimin e shëndetit të bimëve.

Regjistri i certifikimit të farave dhe fidanëve

Laboratorët e testimit të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor pranë ESHFF, AKU dhe QTTB-ve.

Anëtarësimi i Republikës së Shqipërisë në institucionet ndërkombëtare si UPOV dhe ISTA.

MUNDËSITË (O)

Plotësimi i katalogut kombëtar për testimin e varieteteve.

Përmirësimi i regjistrimit të certifikimeve të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor.

Regjistrimi i varieteteve të reja për të drejtën e seleksionerit të Shqipërisë në UPOV. Akreditimi sa më shpejt i laboratorëve që shërbejnë për testimin e farave dhe fidanëve të importuar. në procesin e certifikimit të tyre.

DOBËSITË (Ë)

Mungesë e monitorimit dhe kontrollit të ecurisë së veprimtarisë së strukturave që ka në varësi MBZHR dhe konkretisht Drejtoria e Politikave të shëndetit të bimëve, farave, fidanëve dhe plehrave.

Mos plotësimi i organikës me burime njerëzore.

Ekzistenca e buxheteve “historike” të pandryshuara nga viti në vit.

Mos rritja e të ardhurave dytësore nga procesi i certifikimit dhe testimit të varieteteve.

Mos përditësimi i Katalogut Kombëtar me varietete të reja të testuara.

Mos akreditimi i laboratorit qendror në ESHFF si edhe e njëjta situatë edhe për laboratorët e AKU dhe QTTB-ve për bimët.

Mos bashkërendimi i punës ndërmjet institucioneve objekt auditimi: ESHFF dhe AKU, marrëdhënie të cilat kushtëzohen nga Ligji 10416, dt. 07.04.2011, i ndryshuar “Për materialin mbjellës shumëzues bimor” e si rrjedhim tregtimin e pa kontrolluar të shitjes së farave e fidanëve nga furnizuesit të pa certifikuar.

Mos hartimi në vite i udhëzimeve, akteve nënligjore dhe urdhrave në funksion të Ligjeve për mbrojtjen e bimëve dhe garantimin e jetës së konsumatorit.

Mungesa e pajisjeve teknologjike e bashkëkohore në laboratorët ekzistues në ESHFF, AKU, QTTB-të. dhe funksionimi i disa pajisjeve ekzistente.

Mungesa e një sistemi transparent dhe gjithëpërfshirës për matjen, monitorimin dhe raportimin mbi progresin drejt arritjes së objektivave.

KËRCËNIME (TH)

Zhvillimi i ulët ekonomik i vendit, rrjedhimisht mbështetje jo e duhur me financime për bujqësinë.

Shitja e pa kontrolluar e farave dhe fidanëve të pa certifikuara nga institucionet përkatëse.

Modifikimi gjenetikisht i materialit mbjellës shumëzues bimor.

Krizat globale, faktorët natyrorë dhe industrialë, që ndikojnë në ndotjen e ambientit.(veprimi i parazitëve mbi materialin mbjellës bimor). Tregtimi i PMB-ve të paregjistruara¹¹ dhe pamundësia për të gjurmuar

¹¹ Problematikë në këto raste është edhe mungesa e gjurmimit nga organet përgjegjëse.

Koordinimi i institucioneve (ESHFF, AKU) në lidhje me importimin dhe tregtimin e kontrolluar mbjellës dhe shumëzues bimor
Për afrimi i legjislacionit me BE-në dhe UPOV si dhe nxjerrja në kohë e akteve nënligjore dhe udhëzimeve përkatëse.
Plotësimi i vendeve vakant me burime njerëzore të specializuara.

PMB-të. Tregtimi i PMB-ve përtej afateve të skadencës (të vjetruara).
Mungesa e nxitjes së brezit të ri për t' u shkolluar në fushën e bujqësisë si dhe emigrimi në masë i të rinjve.
Migrimi i popullsisë nga zonat rurale në drejtim të qyteteve duke lënë pa fuqi punëtore bujqësinë.

Punoi: Grupi i Auditimit.

Tabela 6. Kategorizimi i Riskut

Nr.	Risk i Subjektit	Kategorizimi i riskut	Niveli i riskut
1	Mungesa e zbatimit të buxheteve të qeverisë në nivele të ndryshme të saj, të harmonizuara, të mjaftueshme dhe të përshtatshme.	Risk Financiar	I mesëm
2	Mungesa e rregullimeve institucionale efektive, koherencës vertikale dhe horizontale.	Risk Strategjik	I Lartë
3	Mosplotësimi i organikës me burimet njerëzore me specialistët sipas fushave.	Risk Operacional	I lartë
4	Aktet nënligjore dhe udhëzime që rregullojnë procesin e monitorimit, kontrollit dhe inspektimit të procesit të certifikimit të materialit mbjellës shumëzues bimor të cilat nuk janë të përditësuara dhe mund të mos jenë në koherencë me Ligjin nr. 10416, dt. 07.04.2011, "Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor", i ndryshuar. Ligji nr.105/2016, "Për mbrojtjen e bimëve".	Risk Strategjik	I lartë
5	Mungesa e Planeve të Menaxhimit dhe Monitorimit nga ESHFF dhe AKU në përcaktimin e objektivave kryesorë për materialin mbjellës shumëzues bimor.	Risk Operacional	I lartë
6	Mungesa e përcaktimit të afateve konkrete për realizimin e detyrave të parashikuara në planet vjetore të punës.	Risk Operacional	I lartë
7	Mos rritja e të ardhurave dytësore nga menaxhimi jo efektiv i procesit të certifikimit dhe testimit të varieteteve.	Risk operacional	I mesëm
8	Nuk ka një përshkrim të saktë të metodologjisë së ndjekur për monitorimin e procesit të certifikimit për fara dhe fidanë. Bashkëpunimi dhe koordinimi midis strukturave përgjegjëse për monitorimin e materialit mbjellës shumëzues bimor mund të mos jetë efektiv.	Risk operacional	I lartë
9	Mos përditësimi i Katalogut Kombëtar me varietete të reja të testuara.	Risk Rregullator	I mesëm
10	Mungesa e pajisjeve teknologjike e bashkëkohore në laboratorët ekzistues në ESHFF, AKU, QTTB-të. dhe funksionimi i disa pajisjeve ekzistente.	Risk operacional	I lartë
11	Mos akreditimi i laboratorëve për certifikimin e analizave për materialin mbjellës shumëzues bimor	Risk Financiar dhe operacional	I lartë

Punoi: Grupi i Auditimit.

a) Brenda kontrollit menaxherial:


- Mungesa e zbatimit të buxheteve të qeverisë në nivele të ndryshme të saj, të harmonizuara, të mjaftueshme dhe të përshtatshme.
- Mungesa e koordinimit, bashkëpunimit dhe komunikimit efektiv ndërmjet institucioneve të qeverisë dhe subjekteve në nivele të ndryshme.
- Mos përditësimi i Katalogut Kombëtar me varietete të reja të testuara.
- Mungesa e pajisjeve teknologjike e bashkëkohore në laboratorët ekzistues në ESHFF, AKU, QTTB-të.
- Mungesa e një sistemi transparent dhe gjithëpërfshirës për matjen, monitorimin dhe raportimin mbi progresin drejt arritjes së objektivave.
- Mos akreditimi i laboratorëve për certifikimin e analizave për materialin mbjellës shumëzues bimor
- Nuk ka një përshkrim të saktë të metodologjisë së ndjekur për monitorimin e procesit të certifikimit për fara dhe fidanë. Bashkëpunimi dhe koordinimi midis strukturave përgjegjëse për monitorimin e materialit mbjellës shumëzues bimor rezulton jo efektiv.
- Mos plotësimi i organikës me burimet njerëzore me specialistët sipas fushave.

a) Jashtë kontrollit menaxheriale:

- Aktet nënligjore dhe udhëzime që rregullojnë procesin e monitorimit, kontrollit dhe inspektimit të procesit të certifikimit të materialit mbjellës shumëzues bimor të cilat nuk janë të përditësuara dhe mund të mos jenë në koherencë me Ligjin nr. 10416, dt. 07.04.2011, "Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor", i ndryshuar.
- Zhvillimi i ulët ekonomik i vendit.
- Mungesa e investimeve në infrastrukturë.
- Krizat globale dhe fatkeqësitë natyrore në rritje.
- Mungesa e nxitjes për brezin e ri në fushën e bujqësisë si dhe emigrimi i të rinjve e të rejave nga zonat rurale në ato urbane apo edhe jashtë kufijve të vendit.

4.2 Pyetjet e auditimit

A janë institucionet e menaxhimit të integruar të materialit mbjellës shumëzues bimor (fara e fidanë) në shërbim të fermerëve dhe prodhimit bujqësor?



4.3 Fushëveprimi i auditimit

Ky auditim ka në fokus procesin e certifikimit të materialit mbjellës shumëzues bimor të importuar dhe më pas të përdorur nga fermerët, orientuar kundrejt efektivitetit të veprimtarisë së institucioneve subjekt auditimi në nivel të qeverisjes qendrore si dhe institucioneve të tyre të varësisë në nivel rajonal.

Për këtë arsye në trajtimin e kësaj tematike grupi i auditimit ka përfshirë si subjekte auditimi: Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Entin Shtetëror të Farave dhe Fidanëve, Autoritetin Kombëtar të Ushqimit, si dhe Qendra të Transformimit dhe Teknologjive Bujqësore të cilat nëpërmjet politikave, ligjeve, udhëzimeve janë përgjegjëse për rregullimin e aktivitetit për gjithë materialin mbjellës dhe shumëzues bimor, të prodhuar në vend si dhe gjithë masat e marra për disiplinimin, krijimin, shumëzimin, prodhimin, ruajtjen, përpunimin, shpërndarjen, tregtimin si dhe kontrollin e farave dhe fidanëve.

Periodha e auditimit është 2020-2022. Siç u përmend edhe në kapitujt e mësipërm subjektet kryesore ku u fokusua ky auditim janë ESHFF, AKU si dhe QTTB-të Vlorë, Lushnjë, Korçë, Shkodër dhe Fushë-Krujë. Qëllimi i këtyre vizitave ka qenë për të parë nga afër procedurat e mbjelljes së farave dhe fidanëve të importuar, procesin e rritjes së tyre deri në produktin final, testimin e varieteteve, takim me fermerë të zonave të ndryshme, të cilat do të shërbejnë për plotësimin e fakteve, evidencave mbi të cilat do të bazohen gjetjet e auditimit.

Periodha e auditimit e përzgjedhur për trajtimin e kësaj teme përfshiu vitet 2020 – 2022, pa përjashtuar këtu edhe përfshirjen e periudhave kohore të mëparshme që mund të shpjegojnë çështje, fenomene dhe dukuri të cilat reflektohen në gjendjen aktuale të materialit mbjellës shumëzues bimor.

5. SHTJELLIMI I PYETJEVE AUDITUESE

Për pyetjen kryesore: **A janë institucionet e menaxhimit të integruar të materialit mbjellës shumëzues bimor (fara e fidanë) në shërbim të fermerëve dhe prodhimit bujqësor?**

Mesazhi i auditimit:

Në kushtet e zhvillimit dhe modernizimit të bujqësisë, është parësore siguri i cilësisë së materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, në mbështetje të prodhimit bujqësor, mbrojtjes së mjedisit dhe të konsumatorit, nëpërmjet forcimit të bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstitutional, kontrollit dhe inspektimit të furnizuesve, rritjes së burimeve njerëzore e logjistike të institucioneve përgjegjëse, për një menaxhim sa më efektiv në procesin e certifikimit dhe testimit të farave dhe fidanëve.

Masat e marra nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe institucionet e varësisë kanë qenë pjesërisht efektive në drejtim të procesit të testimit të varieteteve dhe certifikimit të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor. Enti Shtetëror i Farave ka bërë hapa pozitivë në përmirësimin e situatës, por evidentohen mangësi në përditësimin e akteve ligjore e nënligjore në përputhje me Ligjin nr.10416 datë 07.04.2011 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor” i ndryshuar. Raportet Vjetore të monitorimit, certifikimit dhe testimit të varieteteve të reja nga Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve dhe Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nuk kanë dhënë garanci për sigurinë e tregut ushqimor. Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve nuk ka arritur të maksimizojë mbledhjen e të ardhurave të veta, për mos finalizim të procesit të regjistrimit në Katalogun Kombëtar të Varieteteve dhe mos koordinim në kohë të institucioneve për kryerjen e certifikimit të disa llojeve të materialit mbjellës shumëzues bimor.

5.1 A ekziston një kuadër ligjor dhe rregullator i plotë dhe me ndarje të qarta të roleve dhe përgjegjësi mes aktorëve të përfshirë?

5.1.1 A kanë hartuar dhe miratuar institucionet përgjegjëse politika të duhura për menaxhimin dhe inspektimin e procesit të certifikimit të materialit shumëzues mbjellës bimor?

Institucionet në nivel qendror (Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR) dhe institucionet e saj të varësisë, (Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve (ESHFF), Qendrat e Transferimit të Teknologjisë Bujqësore (QTTB), Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU), janë përgjegjëse për hartimin e strategjive, të kuadrit ligjor dhe nënligjor, për menaxhimin e materialit shumëzues mbjellës bimor.

Institucionet e mësipërme për periudhën në auditim kanë hartuar dokumente politik (strategji kombëtare/sectoriale) për zhvillimin bujqësor dhe rural, të cilat janë të përfshira edhe në Strategjitë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim(SKZHI) (2014-2020) dhe (2021-2027).

Grupi i auditimit u fokusua, në kontrollin për vendosjen e objektivave, në hartimin e planeve të veprimit dhe të monitorimit të strategjive, me qëllim identifikimin e veprimeve për realizimin dhe për analizimin e treguesve të dokumenteve politik, nga strukturat përgjegjëse, pasi prodhimi bimor i siguroar nga material mbjellës shumëzues bimor (fara dhe fidanë) me cilësi, është tregues mjaft i rëndësishëm për tregun e produkteve bujqësore dhe të sigurisë së MMSHB-së.

Sa më sipër, kemi konstatuar se:

Këshilli i Ministrave në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR), kanë miratuar strategjitë për zhvillimin bujqësor¹².

(i) Strategjia Ndër sektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor (SNSZHB) 2014-2020, ka pasur objektiv kryesor përcaktimin e kuadrit strategjik për zhvillimin e sektorit të bujqësisë dhe të zonave rurale, në përshtatshmëri dhe me instrumentet e politikave institucionale për anëtarësimin në BE¹³, me synimin e rritjes dhe sigurimit të qëndrueshëm të ekonomisë bujqësore, të ruajtjes së mjedisit dhe faktorëve sociale. Strategjia e mësipërme është edhe pjesë integrale e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim(SKZHI).

Në (SNSZHB), në Rubrikën 1.7.2 (Siguria Ushqimore), shprehet se:

(a) “Të gjithë fidanët dhe farërat i nënshtrohen analizave fito sanitare në laboratorët e mbrojtjes së bimëve, të cilët gjenden në Durrës. Baza e të dhënave për bimët dhe origjinën e produkteve bimore është funksionale. Megjithatë, ka nevojë për përmirësime të mëtejshme të sistemeve për sa i përket mirëmbajtjes, aksesit dhe qëndrueshmërisë. Detyrat kryesore në fushën fito sanitare janë të lidhura me finalizimin e regjistrit dhe krijimin e një regjistri të plotë të të gjitha produkteve dhe tregtarëve të farërave dhe fidanëve. Një tjetër detyrë e rëndësishme është identifikimi dhe krijimi i zonave të pastra për bimët mëmë.”

Për këtë pikë u konstatua se ESHFF mban në mënyrë manuale regjistrin e prodhuesve në bazë të kërkesave të subjekteve për testim dhe certifikim dhe AKU regjistrin e importuesve të farave dhe fidanëve veprime që sjellin një regjister jo të unifikuar dhe që të jetë i plotë për të gjithë institucionet e varësisë. Regjistri i ESHFF-së nuk është i krijuar si detyrim i objektivave të SNSZHB (2014-2020), por si detyrim ligjor¹⁴ i institucionit.

(b) Në (SNSZHB), sipas objektivave strategjike të përcaktuara për periudhën 2014-2020, konstatohet se duhet të miratohet Plan i hollësishëm Veprimi, duke u shprehur se :

“-krijimin e një zone të pastër nga sëmundjet virale dhe bakteriale për prodhimin e fidanëve dhe farave pa baktere në rrethin e Korçës, si qendra më e rëndësishme për prodhimin dhe shpërndarjen e materialit për mbjelljen e pemëve frutore.

-krijimi i pemëtoreve “mëmë” me qëllim garantimin e materialit për mbjellje, të cilat nuk kanë sëmundje.”

Për pikën (b) nga MBZHR nuk raportohet asnjë e dhënë për krijimin e zonave të pastra nga sëmundjet virale në rrethin e Korçës apo krijimi i pemëtoreve “mëmë”, duke konstatuar që këto objektiva të SNSZHB, kanë ngelur vetëm të shkruara në dokumente.

(c) Në (SNSZHB), bazuar në Rubrikën 1.2.5 (Fruta dhe Perime) citohet se,

¹²Strategjia ndër sektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor (SNSZHB)2014-2020, miratuar me VKM nr.709 datë 29.10.2014 dhe Strategjia e Bujqësisë zhvillimit rural dhe peshkimit për vitet 2021-2027, miratuar me VKM nr.460 datë 29.06.2022.

¹³ Komisioni Evropian (Shpjegim i Bashkimit. Evropian Evropë 2020-Strategjia e rritjes evropiane, Luksemburg 2013)

¹⁴ Ligji nr.8880 datë 15.04.2002 “Për të drejtat e seleksionerit të bimëve” neni 18 pika 1 dhe neni 19 pika 1.

“prodhimi i frutave dhe perimeve përballet ende me sfida të ndryshme, përfshi informalitetin e sektorit të materialit mbjellës.... Sektori ka nevojë për zbatimin e standardeve të sigurisë dhe cilësisë së ushqimit, për të cilat shumica e operatorëve nuk janë gati; kjo do të thotë kosto më të larta për ta, prandaj në këtë drejtim kohët e fundit Qeveria e Shqipërisë ka propozuar ndryshime në ligjin për tatimin e vlerës së shtuar....”

Në lidhje mbi pikën (c), për të ndihmuar prodhuesit bujqësor me qëllim që të rrisin investimet në bujqësi, nga Këshilli i Ministrave është miratuar lehtësia fiskale¹⁵, duke përjashtuar furnizuesit nga pagesa për tatimin mbi vlerën e shtuar. Kjo arritje është e shprehur edhe në rubrikën 2.3 (Arritjet dhe mësimet) e strategjisë së 2021-2027.

Gjithashtu për implementimin e SNSZHB (2014-2020), u konstatua se, MBZHR nuk ka realizuar Plane Veprimi dhe Monitorimi për secilin vit me qëllim që të mundësonte identifikimin e veprimeve të strukturave përgjegjëse, afatet, kostot, produktet, si dhe realizimi i Planeve të monitorimit të strategjisë, do të mundësonte analizimin e treguesve të performancës, mbi arritjet e objektivave të strategjisë, mbi mangësitë e evidentuara, mbi analizimin e shkaqeve të mos realizimit, mbi mundësitë e përmirësimit të punës, të cilat plotësojnë njëra tjetrën duke ndikuar në zhvillimin bujqësor të vendit.

Nga verifikimi në faqen zyrtare <http://www.eshff.gov.al>, është konstatuar se kjo nuk është pasuruar dhe plotësuar me të gjitha ligjet, ndryshimet e tyre, urdhra e rregullore të institucionit për publikun, kundrejt detyrimit ligjor¹⁶.

2. Hartimi i SBZHRP 2021-2027 është bazuar në Strategjinë Kombëtare për Integrimin Evropian dhe përkatësisht të kërkesat dhe objektivat e parashtruara në Kapitullin e Negocimit 11 (Bujqësia dhe zhvillimi Rural), 12 (Siguria Ushqimore, Veterinare dhe Mbrojtja e Bimëve) dhe 13 (Peshkimi).

Nga auditimi, në bazë të metodës krahasimore midis dy strategjive të SNSZHB (2014-2020) me SBZHRP(2021-2027), u konstatua mos vendosje e objektivave të drejtpërdrejta dhe të qarta për institucionet përgjegjëse, për vazhdimin dhe forcimin e mëtejshëm, për menaxhimin e procesit të testimit të varieteteve dhe të materialit shumëzues mbjellës bimor.

MBZHR (Sektori i farërave dhe fidanëve në Drejtorinë e Politikave të Shëndetit të Bimëve) dhe strukturat e ESHFF dhe AKU, nuk dalin si aktorë aktivë, për rritjen cilësore të prodhimit bimor, siguruar nga materiali mbjellës shumëzues bimor (fara dhe fidanë). Nisur nga ky fakt, në rubrikën 4.2 (Përshkrimi i instrumenteve dhe i masave të ndërhyrjes së planifikuara, në kuadër të SBZHRP 2021-2027) strukturat mbi menaxhimin e farave dhe fidanëve nuk janë të përfshira, për rrjedhojë në SBZHRP 2021-2027 nuk kemi objektiva konkretë dhe të matshëm, ndonëse prodhimi bimor i siguruar nga materiali mbjellës shumëzues bimor (fara dhe fidanë) me cilësi, është tregues mjaft i rëndësishëm për monitorimin dhe menaxhimin e tregut të produkteve bujqësore.

1. Gjetje nga auditimi:

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nuk ka hartuar Plane Veprimi dhe Monitorimi për përshkrimin e veprimeve (aktivitetet) specifike që duhet të ndërmerreshin për realizimin e SNZHRB 2014-2020, Plane monitorimi për periudhat: afatshkurtër (2014 dhe 2015), afatmesme (2016-2020) dhe për periudhën afatgjatë (pas vitit 2020).

¹⁵ VKM nr.12 datë 09.01.2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr.953 datë 29.12.2014 “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr.92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar neni 51 germa “nj”.

¹⁶ Ligji nr.8880 datë 15.04.2002 “Për të drejtat e seleksionerit të bimëve” neni 18 pika 1 dhe neni 19 pika 1.

- Në SBZHRP 2021-2027, nuk janë përmendur në mënyrë të drejtpërdrejtë politika ose objektiva konkretë dhe të matshëm për institucionet shtetërore të përfshira në procesin e menaxhimit të testimit të varieteteve dhe certifikimit të materialit shumëzues mbjellës bimor.

- Enti Shtetëror i Farëve dhe Fidanëve nuk ka pasuruar, përditësuar dhe plotësuar me të gjitha ligjet, ndryshimet e tyre, urdhra e rregullore të institucionit për publikun, faqen e WEB-it kundrejt detyrimit ligjor për informimin e publikut në lidhje me materialin mbjellës shumëzues e bimor.

- Enti Shtetëror i Farëve dhe Fidanëve aktualisht mban manualisht regjistrin për prodhimin e materialit mbjellës shumëzues bimor i cili nuk është format i miratuar nga MBZHR.

1. Konkluzion: Mos vendosja e objektivave të qartë dhe konkretë dhe mos hartimi i planeve të veprimit dhe të monitorimit, përbëjnë risqe të shtuara në veprimtarinë e certifikimit të materialit mbjellës shumëzues bimor. Ekzistenca e tyre do të mundësonte identifikimin e veprimeve të strukturave përgjegjëse, afatet, kostot, produktet, etj., ndërsa planet e monitorimit strategjik, do të mundësonin analizimin e treguesve të performancës, mbi arritjet e objektivave të strategjisë, mbi mangësitë e evidentuara, analizimin e shkaqeve të mos realizimit dhe mundësitë e përmirësimit të punës, të cilat plotësojnë njëra tjetrën duke ndikuar në zhvillimin bujqësor të vendit.

1.1. Rekomandimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, të përfshijë në Strategjinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për vitet 2021-2027, objektiva konkretë e me afate të mirë përcaktuara, për menaxhimin, mbrojtjen dhe sigurimin e cilësisë së materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, në mbështetje të prodhimit bujqësor, mbrojtjen e mjedisit dhe të konsumatorit.

Brenda vitit 2024

Nën pyetja 5.1.2 A janë aktet nën ligjore të përditësuara dhe në koherencë me kuadrin ligjor kryesor për menaxhimin e materialit mbjellës bimor?

Materiali mbjellës shumëzues bimor, mbështetet në ligjin bazik¹⁷ miratuar në vitin 2011, i cili në periudha të ndryshme deri në vitin 2019, ka pësuar ndryshime të pjesshme, në referim të propozimeve nga MBZHR. Ligji "Për materialin mbjellës shumëzues e bimor" ka folur mbi përgjegjësitë e ESHFF-së, të AKU-së, por nuk është shprehur në mënyrë shteruese mbi mënyrën e koordinimit të tyre, duke i lënë institucionet të fragmentizuara në veprimtaritë e tyre në lidhje me farat dhe fidanët.

Më poshtë po paraqesim mbi ecurinë e përditësimit në koherencë të akteve nën ligjore të me kuadrin ligjor kryesor për menaxhimin e materialit mbjellës bimor.

-Në referim të bazës ligjore¹⁸ konstatohet se ESHFF ka përgjegjësi të verifikojë dhe të analizojë mostrat për të gjitha sasi të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të importuar, për çdo specie, varietet dhe lot, të sjella nga Inspektoriati që mbulon fushën përkatëse pranë Autoritetit Kombëtar të Ushqimit. Çdo 6 muaj, mbas mbarimit të periudhës së garancisë së fuqisë mbirëse për materialin e importuar (mostrat e çdo specije, varieteti dhe loti, të importuara apo të prodhuara në vendin tonë), ESHFF-ja duhet të pranojë për ri analizim në laboratorin e saj për treguesit e fuqisë mbirëse. Gjithashtu, po në referim të bazës ligjore¹⁹ konstatohet se Autoriteti Kombëtar i Ushqimit në rolin e autoritetit inspektues dhe kontrollues, ka përgjegjësi të kontrollojë materialin mbjellës dhe shumëzues bimor të furnizuesit, në çdo kohë dhe në çdo vend ku ai magazinohet, përpunohet, përgatitet për treg e tregtohet. Çdo 6 muaj, Sektori i Kontrollit që mbulon fushën përkatëse pranë AKU duhet të kërkojë që furnizuesit të kryejnë ri analizimin për treguesit e fuqisë mbirëse për çdo specie, varieteti dhe loti, të importuara apo të prodhuara në vendin tonë në laboratorin e ESHFF-

¹⁷ Ligji nr.10416 datë 07.04.2011 "Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor" i ndryshuar

¹⁸ Ligji nr.10416 datë 07.04.2011 "Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor" i ndryshuar, neni 41, pika e.

¹⁹ Ligji nr.10416 datë 07.04.2011 "Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor" i ndryshuar, neni 42, pika 1/a

së. Mostrat për ri analiza laboratorike duhet të merren nga specialisti i autorizuar i ish-Drejtorive të Bujqësisë (DB)-së sot AREB-e.

Nisur nga këndvështrimi juridik, pranë furnizuesve që operojnë në fushën e farave dhe fidanëve, mostrat për ri analiza laboratorike duhet të merren nga specialisti i autorizuar i Drejtorisë së Bujqësisë (DB)-së, pra ligji përfshin një strukturë tjetër bujqësore, e cila dhe “de jure” e “de facto” është suprimuar prej vitit 2018. Sot këtë “rol” e kryejnë Agjencitë Rurale të Ekstensionit Bujqësor (AREB)²⁰, ku në referim të përshkrimit të detyrave funksionale që ata kanë nuk pasqyrohet ky proces. Nga informacionet dhe dokumentacionet e marra nëpërmjet pyetësorëve nuk ka tregues të matshëm se sa mostra janë marrë nga inspektorët e AREBE-ve për ri analizim proces i cili garanton fuqinë mbirëse të farës.

Mos përcaktimi i saktë në bazën ligjore i roleve të institucioneve të varësisë (AKU, ESHFF, AREB) mbi procesin e ri analizimit të materialit mbjellës shumëzues bimor për treguesit e fuqisë mbirëse për mostrat e çdo specijeje, varieteti dhe loti, të importuara apo të prodhuara në vendin tonë, paraqet risk të shtuar në cilësinë e materialit mbjellës shumëzues bimor (MMSHB), dhe si një tregues mjaft i rëndësishëm për monitorimin dhe menaxhimin e tregut të produkteve bujqësore. Nisur nga ky fakt, nga MBZHR duhet të kishte iniciuar ndryshimin e kuadrit ligjor dhe rregullator me ndarje të qarta të roleve dhe përgjegjësiave mes aktorëve të përfshirë për menaxhimin e materialit mbjellës bimor.

Hallka e mekanizmit të zinxhirit, për kryerjen e ri analizimit për treguesit e fuqisë mbirëse për mostrat e çdo specijeje, varieteti dhe loti, të importuara apo të prodhuara në vendin tonë, nuk ka funksionuar dhe nuk ka të dhëna për numrin e analizave laboratorike mbi fuqinë mbirëse të farës në lidhje me stokun e MMSHB në magazinat e operatorëve bujqësorë nga AKU apo nga ESHFF duke e lënë këtë proces të pa monitoruar dhe me risk të shtuar.

- Në lidhje me aktin normativ të Këshillit të Ministrave²¹, u konstatua se, sipas pikës III (Funksionet dhe mënyra e funksionimit të Komisionit të Vlerësimit të Varieteteve për Regjistrim në Katalogun Kombëtar (në vijim KVVRRKK) pika 3, komisioni nuk është vendimmarrës i fundit, por i propozon ESHFF-së për vazhdimin e marrjes së vendimit përfundimtar.

Në referim, të pikës II (Përbërja e komisionit të vlerësimit të varieteteve për regjistrim në katalogun kombëtar) pika ç, pika 3/a(i), pika b(i) dhe pika c(i), mbajnë emërtesa të cilat për shkak të ristrukturimeve ndër vite në lidhje me organizimin dhe funksionimin e MBZHR me urdhër nga Kryeministri, nuk funksionojnë më, për rrjedhojë anëtarët të cilët marrin pjesë në KVVRRKK, nuk janë në përputhshmëri dhe në koherencë me organizimin dhe funksionimin e MBZHR, ndonëse *de jure* ligji²² kërkon funksionimin KVVRRKK, *de facto* strukturat janë të suprimuara.

-Në zbatim të ligjit bazik, për materialin mbjellës dhe shumëzuesin bimor, i ndryshuar²³, janë miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave 13 (trembëdhjetë) akte nënligjore, ndërsa vazhdon jetë ende e paplotësuar korniza e kuadrit nënligjor (VKM, udhëzime dhe urdhra)²⁴, me tregues rendor 17 deri në 27, të paraqitura në tabelën e aneksit 2 bashkëlidhur këtij raporti.

²⁰VKM nr. 147, datë 13.3.2018 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencive Rajonale të Ekstensionit Bujqësor”

²¹ VKM nr.531 datë 13.06.2013 “Për përcaktimin e përbërjes dhe të mënyrës së funksionimit të Komisionit të Vlerësimit të varieteteve për regjistrimin në katalogun kombëtar”

²² Ligji nr.10416 datë 07.04.2011 “Mbi materialin mbjellës dhe shumëzuesin bimor” i ndryshuar, neni 40

²³ Ligji nr.10416 datë 07.04.2011 “Për materialin mbjellës dhe shumëzuesin bimor” i ndryshuar me ligjin nr.67/2013 datë 14.02.2013; nr.105/2015 datë 01.10.2015; nr.12/2019 datë 05.03.2019.

²⁴ Ligji nr.900 datë 30.01.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” Kreu IV (Aktet) pika ç dhe d.

MBZHR dhe ESHFF²⁵, në përgjigje të pyetësorëve referojnë se “Për ligjin për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor, i ndryshuar disa herë (një ligj që daton nga viti 2011) është ngritur një grup pune nga Ministri i MBZHR nr.1757 datë 20.03.2023 për hartimin e projekt ligjit për shtesa dhe ndryshime”, por ende nuk ka produkt të këtij grupi pune e rrjedhimisht ligji aktual vazhdon të mbetet i njëjtë duke sjellë problematikat e sipër cituara.

-Në referim të miratimit dhe hyrjes në fuqi të Udhëzimit të Përbashkët të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE) dhe të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR) nr. 19 datë 22.11.2022 “Mbi tarifat e të ardhurave dytësore, të aplikueshme nga institucionet vartëse të MBZHR”, për shërbime që kryhen nga ESHFF është aplikuar dhe zbatuar Udhëzimi i përbashkët nr. 8 datë 08.05.2007 “Për tarifat e të ardhurave dytësore, të aplikueshme nga institucionet vartëse të MBZHR”, i ndryshuar, është konstatuar se:

Udhëzimi nr. 8, datë 08.05.2007:”Mbi tarifat e të ardhurave dytësore të aplikueshme nga institucionet e varësisë të MBUMK” bazuar në Ligjin nr.8732 datë 24.01.2001 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor’ i shfuqizuar ka pësuar ndryshime në vitin 2014 me Udhëzimin e Përbashkët nr. 9 datë 29.05.2014” Për një ndryshim në Udhëzimi nr. 8”, dhe ky i fundit bazuar në ligjin e ri nr.10416 datë 07.04.2011 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor’ i ndryshuar. Në aspektin juridik, hartimi dhe miratimi i Udhëzimit nr. 9 është mbështetur në Ligjin nr.10416 datë 07.04.2011 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor’ i ndryshuar e për rrjedhojë duhet të ishte shfuqizuar Udhëzimi nr.8, i cili mbështetej në ligjin e mëparshëm²⁶, të vitit 2001. Kjo mangësi juridike është rregulluar me miratimin e aktit normativ nënligjor Udhëzimi nr. 19 datë 22.11.2022. Pra në një hapësirë prej 8 vitesh është operuar nga MBZHR me Udhëzime jo në përputhshmëri dhe koherencë me kuadrin ligjor.

2. Gjetje nga auditimi:

- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe institucionet përgjegjëse, për menaxhimin dhe inspektimin në fushën e farave dhe fidanëve, operojnë me ligjin për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor, i cili ndër vite ka pësuar shtesa dhe ndryshime, ndërsa miratimi i plotë i paketës nënligjore rezultoi i përcaktuar, për shkak të disa ndryshimeve të miratuara dhe riorganizimit të institucioneve përfshirëse në këtë fushë.

-Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në mars të vitit 2023 ka ngritur një grup pune për hartimin e projekt ligjit të ri, por ende nuk ka një produkt konkret.

2. Konkluzion: Mos miratimi i akteve administrative normative nënligjore (udhëzime dhe urdhra) në kohë, kanë reflektuar në zgjidhje jo plotësisht racionale, duke mos përcaktuar të saktë rolin të institucioneve të varësisë (AKU, ESHFF, AREBE) mbi hallkat e procesit të materialit mbjellës shumëzues bimor, konkretisht për treguesit e fuqisë mbirëse për mostrat e çdo specijeje, varieteti dhe loti, të importuara apo të prodhuara në vendin tonë. Mos vendosja e qartë e roleve të institucioneve në formatin juridik, ka shtuar riskun në sigurinë e cilësisë të sigurisë së MMSHB-së, si një tregues mjaft i rëndësishëm për monitorimin dhe menaxhimin e tregut të produkteve bujqësore.

2.1. Rekomandimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, të marrë masa për hartimin dhe miratimin e plotë të paketës së akteve nënligjore (VKM, urdhra e udhëzime) të zbatimit të ligjit për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor në përshtatshmëri edhe me Direktivat e BE-së

²⁵ Përgjigja e pyetësorit nr.2 datë 26.06.2023 nga MBZHR(Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së bimëve dhe Peshkimit) dhe ESHFF.

²⁶ Ligji nr.8732 datë 24.01.2001 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor’ i shfuqizuar.

5.2 A kanë garantuar institucionet përgjegjëse mbikëqyrje të plotë ndaj furnizuesve dhe përdoruesve të materialit mbjellës shumëzues bimor?

5.2.1 A janë koordinuar midis tyre institucionet përgjegjëse lidhur me procesin e monitorimit, certifikimit, inspektimit të materialit mbjellës shumëzues bimor?

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nuk ka realizuar një analizë të detajuar në lidhje me sipërfaqet e mbjella me material mbjellës dhe shumëzues bimor të kulturave të bimëve medicinale luleshtrydhes, fasules, duhanit, luledielliit sojës dhe panxhar sheqerit duke dhënë statistika që nuk garantojnë dhe nuk japin siguri për kontrollin e fidanëve të certifikuar.

-Nuk ka të dhëna konkrete dhe në kohë reale as nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe as nga institucionet e varësisë në lidhje me sasitë e importuara dhe ato të eksportuara të materialit mbjellës shumëzues bimor të tyre, duke krijuar një gjendje konfuze dhe të pa qartë për garantimin e procesit të certifikimit të materialit mbjellës shumëzues bimor i cili ndikon në sigurinë e MMSHB-së.

- ESHFF nuk disponon listë zyrtare të unifikuar me MBZHR të furnizuesve për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor mbi bazën e të cilës hartohet plani i kontroleve me bazë risku nga AKU.

Mos kryerja e detyrave funksionale nga Sektori i Testimit të Varieteteve dhe konkretisht analizë për çdo varietet që i përket Katalogut Kombëtar për shkak të tejkalimit të afateve të regjistrimit për një periudhë prej 26 vjet sjell risk të shtuar në sigurinë e MMSHB-së, pasi bazuar në këtë katalog inspektorët e AKU kryejnë verifikimin në PIK të farave dhe fidanëve të importuar.

Me gjithë punën e përbashkët të kryer nga ESHFF dhe QTTB, mos finalizimi i procesit të Publikimit dhe regjistrimit të varieteteve të reja në Katalogun Kombëtar të Specieve dhe Varieteteve për testimin e varieteteve të reja edhe pse janë përdorur burime njerëzore e monetare nga Qendrat e Transferimit të Teknologjive Bujqësore konkretisht 28 akt-marrëveshje të lidhura me një fond të buxhetit të shtetit prej 1,703,000 lekë e bën këtë proces shumë të rëndësishëm të pa finalizuar që ti shërbejë procedurave të mbjelljes së tyre nga fermerët në funksion të rritjes së cilësisë së farave dhe fidanëve si dhe të rritjes së sigurisë ushqimore të prodhimit të frutave dhe perimeve. Regjistrimi i varieteteve të reja në Katalogun Kombëtar sjell njëkohësisht edhe rritjen e të ardhurave dytësore si për Entin Shtetëror të Farave por edhe për buxhetin e shtetit.

ESHFF është pjesë e programit buxhetor 04250, “Zhvillimi Rural” në mbështetje të prodhimit bujqësor, blegtoral, agro përpunimit dhe marketingut”. Në këtë kuadër, në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimit nr. 9, datë 28.02.2020, “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të buxhetit”, udhëzimeve përkatëse të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, ESHFF, harton programin buxhetor afatmesëm (3 vjeçar), si dhe vjetor, duke përcaktuar qartazi:

- Objektivin e punës për vitin buxhetor;
- Produktet që do të realizojë;
- Aktivitetet që do të kryejë për të përmbushur objektivat;
- Indikatorët; si dhe
- Buxhetin e nevojshëm për përmbushjen e qëllimit.

Pas paraqitjes së kërkesës nga ESHFF, bëhet vlerësimi nga EMP e 04250, si dhe detajimi i fondeve përkatëse.

Në bazë të ecurisë së indikatorit, bëhet dhe monitorimi i punës së ESHFF, përmes planit të aktiviteteve.

Ndër drejtimet kryesore ku mbështetet puna e ESHFF, përmendim:

- Ngritja në nivele më të larta e bashkëpunimit me AKU, QTTB-të, AZHBR-në, AREB-t, me specialistë të mbrojtjes së bimëve, akademinë, etj.;
- Certifikimi i materialit mbjellës bimor sipas kritereve ligjore të miratuara, sipas skemave të OECD-së, si dhe direktivave të BE-së;
- Shpërndarja e metodikave për prodhimin, certifikimin dhe testimin, sipas kritereve shkencore duke bashkëpunuar me specialistë të QTTB-ve dhe furnizuesit e licencuar;
- Kryerja e provave të testimit dhe regjistrimi në katalogun kombëtar, në bazë të rezultateve dhe cilësisë së tyre;
- Bashkëpunimi midis ESHFF me QTTB-të dhe subjektet private për ngritjen e provave fushore nëpërmjet lidhjes së Akt - Marrëveshjeve dhe kontratave të shërbimit;
- Bashkëpunimi me anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Varieteteve për Regjistrim në Katalogun Kombëtar (KVVRKK), si dhe kontrollin e parcelave të testimit dhe grumbullimit të të dhënave sipas fazave fenologjike dhe metodikave të UPOV-t;
- Kryerja e analizave zyrtare për treguesit cilësor të farave dhe fidanëve në përputhje me metodikën e ISTA-s.

Për plotësimin e këtyre objektivave janë konstatuar në vijim:

1. Materiali mbjellës dhe shumëzues bimor i një specije të përcaktuar tregtohet nëse:

- a. Varieteti është i regjistruar në KK;
- b. është prodhuar nën mbikëqyrjen e ESHFF-së;
- c. janë kryer verifikimet e kërkesave për certifikimin e cilësive të kategorive të përcaktuara të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor;
- d. janë verifikuar treguesit cilësorë specifikë, në përputhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore të tij;²⁷
- e. është vërtetuar gjendja shëndetësore me certifikatë fitosanitare.

Katalogu Kombëtar është lista zyrtare e varieteteve të specieve të bimëve, materiali mbjellës shumëzues bimor i të cilave prodhohet, përgatitet për treg, importohet dhe tregtohet në Republikën e Shqipërisë.

Procedurat për regjistrimet në katalogun kombëtar kryhen në bazë të kërkesave të subjekteve për regjistrim dhe realizohen nga Enti Shtetëror i Farërave dhe Fidanëve²⁸ në bashkëpunim me QTTB-të, nëpërmjet lidhjes së Akt - Marrëveshjeve dhe kontratave të shërbimit.

Testimi i varietetit kryhet për të verifikuar dallueshmëri, uniformitet dhe stabilitet dhe për vlerën e kultivimit dhe përdorimit të materialit shumëzues dhe mbjellës bimor. Pjesë integrale e këtij procesi është Komisioni i Vlerësimit të Varieteteve për Regjistrim në Katalogun Kombëtar, i cili ka këto funksione:

- a) të vlerësojë rezultatet e testimit zyrtar të varieteteve të reja për dallueshmëri, uniformitet, stabilitet (DUS) që janë produkt i punës krijuese dhe përmirësuese gjenetike të institucioneve publike, private, të vendit ose të huaja, sipas procedurave të parashikuara në dispozitat e ligjit nr. 8880, datë 15.4.2002 “Për të drejtat e seleksionerit të bimëve”, të ndryshuar;
- b) të vlerësojë rezultatet e testimit zyrtar të varieteteve ekzistuese të regjistruara sipas rregullave të UPOV-it në vendet e BE-së ose vende të tjera për vlerën e kultivimit dhe përdorimit (VKP), të parashikuar në ligjin nr. 10416, datë 7.4.2011, “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”, të ndryshuar;

²⁷Ligji nr.10416, neni 33 pika 4 datë 7.4.2011 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”

²⁸Neni 29 i ligjit nr.10 416, neni 33 pika 4 datë 7.4.2011 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”, VKM nr. 319, datë 27.4.2016 për përcaktimin e procedurës e të metodës së testimit të varieteteve

c) të vlerësojë për regjistrim varietetet të cilat nuk plotësojnë kërkesat për regjistrim, por kanë vlera të veçanta në kultivim dhe përdorim, varietetet në konservim, si dhe ato me vlera të veçanta që miratohen me udhëzim të ministrit;

ç) të bëjë vlerësimet dhe propozimet përkatëse për regjistrim ose jo të varietetit sipas përcaktimit të shkronjave “a”, “b” dhe “c” të kësaj pike.

Në lidhje me mënyrën e funksionimit të Komisionit të vlerësimit të varieteteve për regjistrim në katalogun kombëtar, KVVRKK, u konstatua se:

KVVRKK përbëhet nga 11 (njëmbëdhjetë) anëtarë, ndër të cilët 9 (nëntë) anëtarë marrin pjesë në të gjitha mbledhjet e Komisionit, ndërsa 2 (dy) anëtarët e tjerë ndryshojnë në varësi të çështjeve të cilat trajtojnë specie të veçanta ose/dhe grup-speciesh të bimëve. Lista emërore e anëtarëve të KVVRKK-së miratohet me urdhër të Ministrit të MBZHR-së dhe për periudhën në auditim ka vetëm një urdhër të Sekretarit të Përgjithshëm të MBZHR-së nr. 606, datë 01.12.2021 “Për ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të Varieteteve për Regjistrim në Katalogun Kombëtar”.²⁹

Kryetar i komisionit është zv/Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, i cili sipas pikës III, 2, germa “a” dhe thërret mbledhjen e këtij komisioni.

Sekretar i komisionit është përgjegjësi i sektorit të testimit në ESHFF pa të drejtë vote, i cili mban protokollin dhe proces verbalin e mbledhjes.

Komisioni ***mblidhet të paktën katër herë në vit***, por në bazë të nevojave që dalin për shqyrtimin e varieteteve të reja, Komisioni mund të mblidhet sa herë që kjo të jetë e nevojshme.³⁰

Ndërsa sipas rregullores së ESHFF me nr.2391/3 prot të MBZHR-së, datë 01.06.2020, Drejtori i saj ka detyrë të mbledhë Komisionin e Vlerësimit të Varieteteve për Regjistrim në Katalogun Kombëtar jo më pak se dy herë në vit. Kjo është në kundërshtim me VKM nr. 531 datë 13.6.2013 “Për përcaktimin e përbërjes dhe të mënyrës së funksionimit të komisionit të vlerësimit të varieteteve për regjistrim në katalogun kombëtar”, ku Komisioni mblidhet të paktën katër herë në vit. Pra ka mos përputhje në hartimin e rregullores e cila duhet të jetë patjetër pjesë integrale e VKM së sipër cituar dhe jo ndryshe nga ajo.

Rezultoi se ky komision është mbledhur respektivisht 2 herë për vitin 2020, asnjë takim për vitin 2021, 1 (një) herë për vitin 2022, për të cilat janë marrë përkatësisht këto vendime:

1. Vendimi nr. 41, datë 30.01.2020

2. Vendimi nr. 42, datë 24.12.2020

3. Vendimi nr. 43, datë 02.02.2022

Pra ky komision rezulton të ketë qenë jo efektiv për funksionin që ka, pasi në 3 vite është mbledhur gjithsej 3 herë kur duhet të mblidhet të paktën katër herë në vit, $4 \text{ vite} \cdot 3/\text{vit} = 12$ herë ose e thënë ndryshe 12 herë për 3 vite.

Përgjegjësi i sektorit të testimit është njëkohësisht Sekretar i Komisionit të Vlerësimit të Varieteteve për Regjistrim në Katalogun Kombëtar (KVVRKK). Ndër detyrat e tjera, lidhur me KVVRKK ai duhet të:

- ✓ Të vlerësojë dhe pranojë kërkesat e QTTB-ve, dhe subjekteve të ndryshme të vendit apo të huaj për ***regjistrimin e varieteteve të reja***.
- ✓ Të organizojë dhe kontrollojë punën për kryerjen e provave zonale të testimit të varieteteve.
- ✓ ***Të informojë institucionet dhe subjektet e ndryshme për rezultatet e arritura në provat e testimit.***

²⁹ VKM nr. 531, datë 13.6.2013 “Për përcaktimin e përbërjes dhe të mënyrës së funksionimit të komisionit të vlerësimit të varieteteve për regjistrim në katalogun kombëtar”.

³⁰ Vendim nr. 531, datë 13.6.2013 “Për përcaktimin e përbërjes dhe të mënyrës së funksionimit të komisionit të vlerësimit të varieteteve për regjistrim në katalogun kombëtar

- ✓ ***Të ndjekë procedurat për zbatimin e vendimeve të KVVRKK-s dhe të bëjë njoftimin pas shpalljes së regjistrimit të varietetit nga Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.***

Për periudhën në auditim nga ana e Sektorit të Testimit të Varieteteve, janë realizuar:

- ngritja e provave fushore të testimit në zonat e caktuara, me qëllim regjistrimin në Katalogun Kombëtar.
- hartimi i metodikave sipas kriterëve shkencorë, duke bashkëpunuar ngushtë me sektorët e ESHFF si dhe me QTTB-të.
- post-kontrollin e varieteteve.

Provafushore janë ngritur pranë QTTB-ve dhe në subjekte private në ato zona ku nuk ishte e mundur ngritja e provave pranë QTTB-ve.

Pas hartimit të listave të fermerëve të përzgjedhur janë kryer të gjitha procedurat përkatëse konform Vendimeve të Këshillit të Ministrave.

Nëse varieteti plotëson kushtet e përcaktuara në këtë ligj për regjistrimin në KK, me propozim të KVVRKK-së, ESHFF-ja merr vendim për regjistrimin e varietetit në KK. Vendimi është i formës së prerë dhe botohet në buletin zyrtar të tij.³¹

Nisur nga të dhënat zyrtare të marra nga pyetësorët drejtuar ESHFF, rezultoi se në Katalogun Kombëtar për periudhën në auditim janë regjistruar si më poshtë vijon:

Për vitin 2020, KVVRKK ka vendosur regjistrimin e 113 varieteteve të reja në katalogun kombëtar dhe ka regjistruar vetëm 20 varietete, për vitin 2021 nuk ka vendime të KVVRKK për regjistrime në katalogun kombëtar dhe për vitin 2022 KVVRKK ka vendosur për regjistrimin e 44 varieteteve në KK dhe ka regjistruar vetëm 12. Të dhëna për katalogun kombëtar dhe vendimet e KVVRKK janë publike përveç atyre që konsiderohen sekret për biznesin dhe vihen në dispozicion në përputhje me legjislacionin e mbrojtjes së të dhënave.³²

Tabela 8: Regjistrimet në KK për vitin 2020

Miratuar	Nr.	Regjistruar	Nr.
Grurë	4	Grurë	3
Duhan	10	Duhan	10
Peme Frutore	10	Peme Frutore	2
Qepujke	3	Qepujke	2
Bime Aromatike	7	Bime Aromatike	-
Misër	16	Misër	1
Patate	17	Patate	2
Totali	67		20

Regjistrimet në KK për vitin 2021 (për vendime të marra në 2020)

Miratuar	Nr.	Regjistruar	Nr.
Grurë	11	Grurë	-
Elb	2	Elb	1
Perime	4	Perime	3
Misër	19	Misër	5 (regj. 2022)
Patate	10	Patate	-
Totali	46		9

³¹ Ligji nr.10416, datë 7.4.2011 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor” (ndryshuar me ligjin nr. 67/2013, datë 14.2.2013, nr.105/2015, datë 1.10.2015, nr. 12/2019, datë 5.3.2019), neni 35.

³² Neni 38 pik 3 e ligjit nr.10 416, neni 33 pika 4 datë 7.4.2011 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”

Regjistrimet në KK për vitin 2022 dhe totali për 3 vjet.

Miratuar	Nr.	Regjistruar	Nr.
Grurë	4	Grurë	4
Perime	8	Perime	1
Misër	22	Misër	6
Patate	10	Patate	1
Totali	44		12
Totali 2020-2022	157		41

Burimi ESHFF përpunoi grupi i auditimit

Megjithëse KVVRKK ka marrë 3- vendime të formës së prerë për regjistrim në KK, konstatohet se për periudhën në auditim numri i regjistrimeve në KK ka rënë ndjeshëm me argumentin se subjektet që kërkojnë të regjistrojnë varietetet e miratuara duhet të shlyejnë detyrimet financiare³³, dhe konkretisht të paraqitura në tabelat e mësipërme nga 157 testime të kryera dhe vendosur për regjistrim në KK, janë regjistruar vetëm 41 ose e thënë ndryshe vetëm 26 % e tyre. Mos regjistrimi i varieteteve të reja në KK dhe jo efektiviteti i funksionimit të KVVRKK sjell risk të shtuar në cilësinë e MMSHB-së, pasi referuar Katalogut Kombëtar, inspektorët e AKU kryejnë verifikimin në PIK të farave dhe fidanëve të importuar.

Bashkëpunimi me QTTB-të.

ESHFF në bashkëpunim me QTTB përgatit skemën e testimit dhe merr pjesë në procesin e caktimit të ngastrës së tokës dhe mbjelljes së materialit mbjellës dhe shumëzues bimor. Testimi i varietetit kryhet për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor në afate kohore të ndryshme në varësi të varietetit. Periudhat e testimit të varietetit fillojnë nga momenti i mbjelljes së mostrës së materialit mbjellës dhe shumëzues bimor deri në daljen në prodhim të frytit të tij. Për bimët e arave dhe perimet është deri në një vit, ndërsa për drufrutorët është 3 vjet. Për periudhën në auditim për vitet 2020-2022 ESHFF ka lidhur kontrata bashkëpunimi për testimin e varieteteve me QTTB-të Shkodër, Lushnje, Vlorë dhe Korçë për testimin e varieteteve të misrit të hershëm të mesëm dhe të vonë, për testimin e varietetit të grurit të butë, bizele, pazi, sallatë, patate e hershme dhe patate e vonë si dhe mollë kumbull caperi dhe lajthi.³⁴

Mos kryerja e pagesës nga operatorët bujqësorë për regjistrimin e varieteteve të reja në Katalogun Kombëtar edhe pas marrjes së vendimit nga KVVRKK, ka sjellë një proces të mangët si dhe kosto jo efektive në burime njerëzore dhe monetare.

QTTB Vlorë në bashkëpunim me Entin Shtetëror të Farave dhe Fidanëve ka lidhur 4 kontrata të paraqitura në tabelën bashkëlidhur.

QTTB- Vlorë

Tabela 9: Tabela e kontratave mes QTTB dhe ESHFF

Nr.	Viti	Numri i marrëveshjeve të QTTB Vlorë me ESHFF	Vlera e kontraktuar ndërmjet QTTB Vlorë dhe ESHFF	vlera e paguar nga ESHFF
1	2022	4	520,000	265,000

³³ Udhëzimi nr. 8, datë 08.05.2007, "Për tarifat e të ardhurave dytësore të aplikueshme nga institucionet e varësisë të MBZHR-së", i ndryshuar.

³⁴ Aneks 1, Tabela e kontratave të testimit të varieteteve.

Burimi i të dhënave, ESHFF dhe QTTB, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.

QTTB Lushnjë në bashkëpunim me Entin Shtetëror të Farave dhe Fidanëve ka lidhur 14 kontrata të paraqitura në tabelën bashkëlidhur.

Tabela 10: Tabela e kontratave mes QTTB dhe ESHFF

Nr	Viti	Numri i marrëveshjeve të QTTB Lushnjë me ESHFF	vlera e kontraktuar dhe e paguar nga ESHFF
1	2020	1	60,000
2	2021	6	320,000
3	2022	7	265,000
	Totali	14	645,000

Burimi i të dhënave, ESHFF dhe QTTB, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.

QTTB Shkodër në bashkëpunim me Entin Shtetëror të Farave dhe Fidanëve ka lidhur 3 kontrata të paraqitura në tabelën bashkëlidhur.

Tabela 11: Tabela e kontratave mes QTTB dhe ESHFF

Nr.	Viti	Numri i marrëveshjeve të QTTB Shkodër me ESHFF	vlera e kontraktuar dhe e paguar nga ESHFF
1	2020	1	180,000
2	2021	1	180,000
3	2022	1	175,000
	Totali	3	373,000

Burimi i të dhënave, ESHFF dhe QTTB, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.

QTTB Korçë në bashkëpunim me Entin Shtetëror të Farave dhe Fidanëve ka lidhur 7 kontrata të paraqitura në tabelën bashkëlidhur.

Tabela 12: Tabela e kontratave mes QTTB dhe ESHFF

Nr.	Viti	Numri i marrëveshjeve të QTTB Korçë me ESHFF	vlera e kontraktuar dhe e paguar nga ESHFF
1	2020	2	120,000
2	2021	1	60,000
3	2022	4	240,000
	Totali	7	420,000

Burimi i të dhënave, ESHFF dhe QTTB, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.

Pra për periudhë në auditim janë lidhur gjithsej 28 marrëveshje (kontrata) për 28 varietete ndërmjet QTTB-ve dhe ESHFF³⁵ me një vlerë të paguar nga buxheti i shtetit prej 1,703,000 lekë dhe me gjithë testimet e kryera pas marrjes së vendimeve nga KVRKK kanë mbetur pa regjistruar në KK 116 varietete të reja kjo për arsyen se:

³⁵ Ligj nr.10 416, datë 7.4.2011 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”, i ndryshuar, neni 33, pika 7

Nëse do të ishin ndjekur të gjitha procedurat deri në regjistrimin e varieteteve në KK pas vendimeve të marra nga KVVRRKK, sipas Udhëzimit nr.19 datë 22.11.2022 i MBZHR dhe MFE “Mbi tarifat e te ardhurave dytësore të aplikueshme nga institucionet e varësisë së MBZHR”, do të ishin arkëtuar në buxhetin e shtetit:

*116 varietete të testuar*20,000 lekë/për regjistrim = 2,320,000 lekë të ardhura.*

Numri 116 varietete është shpjeguar në tabelën 8 në faqet 36-37 të RPA, të punuar nga grupi i auditimit me burim informacioni ESHFF, ku shprehen saktë dhe qartë numri i miratimeve të testimit të varieteteve nga KVVRRKK dhe numri i regjistrimeve në Katalogun Kombëtar për periudhën e auditimit. Diferenca ndërmjet miratimit dhe regjistrimit përbën shifrën 116.(157-41).

Sektori i testimit të varieteteve pranë ESHFF nuk ka informuar me shkresë zyrtare subjektet për vendimet e KVVRRKK për pagesën e tarifave të regjistrimit dhe regjistrimin e tyre në Katalogun Kombëtar duke mos dokumentuar procesin e të gjitha këtyre veprimtarive.³⁶, veprime nw kundërshtim me rregulloren e ESHFF, miratuar me urdhër të ministrit të MBZHR nr. 2391/3prot., datë 01.06.2020, kreu V germa a si dhe kreu VI germa b nënpika 1, 4 dhe 6, ku citohet se:

a. Komunikimi në rrugë shkresore dhe elektronike

Komunikimi shkresor duhet të jetë etik dhe institucional dhe të respektojë hierarkinë administrative piramidale si më poshtë vijon: Drejtori i ESHFF-së/ Përgjegjës sektori/ Specialist, për shkresat që hyjnë në insttucion dhe anasjelltas për shkresat në dalje. Në rastet e delegimit të kompetencave hierarkia administrative e shkresave në dalje përcaktohet në urdhërat e delegimit. Për strukturat në varësinë direkte të ESHFF-së, komunikimi shkresor bëhet sipas rendit hierarkik. Komunikimi zyrtar me institucionet e tjera bëhet në rrugë zyrtare me shkrim dhe firmoset nga titullarët e institucionit ose nga personat e autorizuar për këtë qëllim, sipas kompetencave të përcaktuara në ligj. Në rastet kur kërkesat vinë nga institucionet e tjera përmes postës elektronike, përgjigjja e përgatitur dërgohet në rrugë zyrtare si dhe përmes postës elektronike me dijeni /miratim të tutullarit të institucionit.

b. Detyrat e përgjegjës të sektorit të testimit varieteteve

1. Përgjegjësi i sektorit të testimit është njëkohësisht Sekretar i Komisionit Vlerësimit të Varieteteve per Regjistrim në Katalogun Kombëtar (**KVVRRKK**).

4. Përgatit raportet përfundimtare mbi rezultatet e provave të testimit dhe ja paraqet Komisionit Shtetëror per Regjistrim të Atestimit të Varieteteve me propozimet përkatëse.

6. Ndjek procedurat për zbatimin e vendimeve të **KVVRRKK-s** dhe bën njoftimin pas shpalljes së rregjistrimit të varietetit nga Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Vlerëson dhe pranon kërkesën e aplikantit që dëshiron të fitojë të drejtën e seleksionerit dhe të mbrojë një varietet, për përmbushjen e kërkesave formale.

Subjektet që kanë bërë kërkesë për regjistrim në katalogun kombëtar duhet të paguajnë tarifën e regjistrimit për tu regjistruar në Katalogun Kombëtar të specieve dhe varieteteve.³⁷

ESHFF nëpërmjet sektorit të testimit të varieteteve të reja informon subjektet për rezultatet e testimit të varietetit si dhe ndjek procedurat për zbatimin e vendimeve të KVVRRKK-s dhe bën njoftimin pas

³⁶ Ligji nr. 10 296, datë 08.07.2010 i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 23 pika 5

³⁷ Udhëzimi nr.19 datë 22.11.2022 i MBZHR dhe MFE “Mbi tarifat e te ardhurave dytësore të aplikueshme nga institucionet e varësisë së MBZHR”, kreu II tarifat për testim dhe regjistrim në KK, nr. 73 rendor i tabelës

shpalljes së regjistrimit të varietetit .³⁸

Komunikimet me institucionet bëhen me rrugë shkresore dhe elektronike³⁹.

Për sa më sipër konstatohet që me gjithë punën e përbashkët të kryer nga ESHFF dhe QTTB për testimin e varieteteve të reja procesi ka mbetur i pa finalizuar pasi edhe me daljen e rezultateve pozitive të testeve nuk është kryer regjistrimi i këtyre varieteteve të reja në KK, për të cilat mban përgjegjësi Përgjegjësi i sektorit të Testimit të Varieteteve me specialistët e këtij sektori për mos kryerje të detyrave funksionale të sipër cituara në përputhje me Rregulloren e ESHFF.

Në vlerësimin e grupit të auditimit nga strukturat përkatëse duhet të ketë një impenjim dhe përgjegjësi administrative të lartë për ndërgjegjësimin e subjekteve private në kryerjen e pagesave për këto regjistrime. Titullarët e njësive publike miratojnë dhe vënë në funksionim sisteme informacioni dhe komunikimi, që sigurojnë: Identifikimin, mbledhjen dhe përhapjen e një informacioni të vërtetë dhe të besueshëm në një format të përshtatshëm, brenda afateve të duhura, duke bërë të mundur që çdo punonjës të marrë përsipër përgjegjësitë përkatëse;

Nga shqyrtimi i faqes së zyrtare të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Entit Shtetëror të Farërave dhe Fidanëve si dhe Autoritetit Kombëtar i Ushqimit u konstatua që vetëm AKU ka të publikuar Katalogun Kombëtar të Specieve dhe Varieteteve.⁴⁰, (mars 2022) ndërkohë që është detyrë parësore e ESHFF publikimi në web i KK.

Ky katalog përmban 1,962 specie dhe varietete të regjistruara në Katalogun Kombëtar dhe që figurojnë aty që nga viti 1950 deri në vitin 2022.

Për periudhën e auditimit vitet 2020-2022, (të dhëna të marra progresivisht) rezultojnë përkatësisht të publikuara në këtë katalog 91 varietete për vitin 2020, 2 varietete të publikuara për vitin 2021 dhe 15 varietete të publikuara për vitin 2022.⁴¹, të dhëna që nuk përputhen në KK e paraqitur nga ESHFF pasi ky katalog nuk ri freskohet në kohë reale fakt ky që tregon një bashkëpunim jo efektiv ndërmjet ESHFF dhe AKU-së.

Enti Shtetëror i Farërave dhe Fidanëve duhet të kryejë procedurat e regjistrimit dhe çregjistrimit të varieteteve në Katalogun Kombëtar të Specieve dhe Varieteteve.⁴² U konstatua se për një periudhë prej 26 vjet nga viti 1996 e deri në 2022 nga KVRKK në bashkëpunim me ESHFF nuk është kryer asnjë çregjistrim varieteti nga KK për shkak të tejkalimit të afateve të regjistrimit⁴³. Nuk është kryer asnjë analizë nga Sektori i Testimit të Varieteteve për çdo varietet që i përket KK ku të shënohet afati përkatës dhe koha e tejkalimit të këtij afati për t'iu paraqitur më pas Komisionit përkatës (KVRKK) për marrjen e vendimit. Ky fakt sjell risk të shtuar në cilësinë e MMSHB-së pasi mbi këtë katalog inspektorët e AKU kryejnë verifikimin në PIK të farave dhe fidanëve të importuar.

1. Gjetje nga auditimi:

- Nuk mbahet regjistër nga Sektori i Testimit të Varieteteve ku të evidentohet i gjithë procesi që kalon testimi dhe regjistrimi i varieteteve nga kërkesat për testim e regjistrim, arkëtimi i tarifave, kryerjen e testeve, deri në vendim marrjen e Komisionit të Vlerësimit të Varieteteve (KVRKK) për testimet dhe regjistrimet në Katalogun Kombëtar.

³⁸ Rregullore e ESHFF, miratuar me urdhër të ministrit të MBZHR nr. 2391/3prot., datë 01.06.2020, kreu VI, germa b nënpika 4 dhe 6.

³⁹ Rregullore e ESHFF, kreu v germa a

⁴⁰ <https://aku.gov.al/wp-content/uploads/2022/03/Katalogu-Kombetar-i-specieve-dhe-varieteteve-15.3.2.22.pdf>

⁴¹ Aneks 2 Tabela e varieteteve të regjistruara në KK për vitet 2020-2022.

⁴² Neni 41 pika 1 germa a

⁴³ Ligji 10416, datë 07.04.2011, "Për materialin mbjellës shumëzues dhe bimor", i ndryshuar, neni 36.

- Mungon një rakordim periodik mujor i Sektorit të Testimit të Varieteteve me sektorin e financës në Entin Shtetëror të Farave dhe Fidanëve për të ardhurat nga tarifat e testeve, regjistrimeve në Katalogun Kombëtar dhe kontratat e shërbimeve të testimit.

1.1. Rekomandimi: Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve të evidentojë të gjithë procesin që kalon testi i regjistrimit të varieteteve të reja për fara dhe fidanë, nga kërkesa, kryerja e testeve, nxjerrja e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Varieteteve deri në Regjistrimin në Katalogun Kombëtar të Specieve dhe Varieteteve dhe duke kryer rakordim periodik mujor me degën e financës.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua mos përputhje e rregullores së brendshme të Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve në kundërshtim me VKM nr. 531 datë 13.6.2013 “Për përcaktimin e përbërjes dhe të mënyrës së funksionimit të komisionit të vlerësimit të varieteteve për regjistrim në katalogun kombëtar”, e cila duhet të jetë pjesë integrale e VKM së sipër cituar dhe jo ndryshe nga ajo. Sipas VKM Komisioni duhet të mbledhet të paktën katër herë në vit ndërsa sipas rregullores duhet të mbledhet 2 herë në vit.

2.1 Rekomandimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural me Entin Shtetëror të Farave dhe Fidanëve në përputhje me ndryshimet ligjore për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor të rishikojnë hartimin dhe miratimin e një rregulloreje të re “Për organizimin dhe funksionimin e Brendshëm të Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve”.

Brenda vitit 2024

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua, rënie e numrit të regjistrimeve të varieteteve të reja në Katalogun Kombëtar, për periudhën 2020-2022, si pasojë e mos finalizimit të procesit të regjistrimit në këtë Katalog për varietetet e reja të testuara nga Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve me Komisionin e Vlerësimit të Varieteteve (KVVRKK) ku nga 157 teste varietetesh për periudhën në auditim janë regjistruar në Katalogun Kombëtar vetëm 41 prej tyre ose 26 % e numrit total çka tregon menaxhim pa efektivitet të burimeve njerëzore si në ESHFF, KVVRKK ashtu edhe për Qendrat e Transferimit të Teknologjive Bujqësore në rajone.

4. Gjetje nga auditimi: Nga Enti Shtetëror i Farëve dhe Fidanëve për periudhën në auditim, nuk janë regjistruar 116 varietete në Katalogun Kombëtar të specieve dhe varieteteve duke sjellë ulje të të ardhurave dytësore në buxhetin e Entit Shtetëror të Farëve dhe Fidanëve si dhe mos finalizim të procesit të regjistrimit të varieteteve të reja në Katalogun Kombëtar.

3.1 Rekomandimi: Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve të marrë masa për kryerjen e njoftimeve zyrtare ndaj operatorëve bujqësorë për kryerjen e pagesave të përcaktuara për regjistrimin e varieteteve të reja në Katalogun Kombëtar, me qëllim pasurimin dhe rifreskimin e tij.

Brenda vitit 2024

5. Gjetje nga auditimi: Enti Shtetëror i Farëve dhe Fidanëve nuk ka të publikuar në faqen e tij zyrtare, Katalogun Kombëtar të Specieve dhe Varieteteve si dhe nuk ka kryer procedurat e rifreskimit të të dhënave të këtij katalogu për vitet 2020-2022 me regjistrime dhe çregjistrime të varieteteve. Gjithashtu konstatohet se Enti Shtetëror i Farëve dhe Fidanëve nuk ka kryer asnjë çregjistrim varieteti për një periudhë prej 26 vite.

Menjëherë dhe në vijimësi

1. Konkluzion. (1-5 gjetje)

Mos kryerja e detyrave funksionale nga Sektori i Testimit të Varieteteve dhe konkretisht analizë për çdo varietet që i përket Katalogut Kombëtar për shkak të tejkalimit të afateve të regjistrimit për një periudhë prej 26 vjet sjell risk të shtuar në cilësinë e MMSHB-së pasi bazuar në këtë katalog inspektorët e AKU kryejnë verifikimin në PIK të farave dhe fidanëve të importuar.

Mos finalizimi i procesit të Publikimit dhe regjistrimit të varieteteve të reja në Katalogun Kombëtar të Specieve dhe Varieteteve, mos zbatimi korrekt i detyrimeve dhe funksioneve nga Komisioni i Vlerësimit të Varieteteve për Regjistrim në Katalogun Kombëtar i cili është mbledhur 3 herë në 3 vjet kur duhet të ishte mbledhur 12 herë, përdorimi i burimeve njerëzore e monetare nga Qendrat e Transferimit të Teknologjive Bujqësore pa efektivitet, ka sjellë mungesë të ardhurash si për Entin Shtetëror të Farave por edhe për buxhetin e shtetit.

5.1 Rekomandimi: Enti Shtetëror i Farërave dhe Fidanëve/Spektori i Testimit të Varieteteve të marrë masa të menjëhershme për analizimin e çdo varieteti që për shkaqe të tejkalimit të afatit të regjistrimit në Katalogun Kombëtar duhet të çregjistrohen dhe ti paraqesë këto përfundime në Komisionin e Vlerësimit të Varieteteve për të marrë vendimin përkatës.

Brenda vitit 2024

5.2 Rekomandimi: Enti Shtetëror i Farërave dhe Fidanëve të marrë masa për publikimin në faqen e tij zyrtare të Katalogut Kombëtar të specieve dhe varieteteve si dhe të kryejë përditësimin e tij me regjistrimet e reja dhe çregjistrimet sipas procedurave të mirë përcaktuara.

Ecuria e procesit të certifikimit të materialit mbjellës shumëzues bimor.

- ESHFF-ja është organi përgjegjës për kryerjen e certifikimit zyrtar të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor⁴⁴/Spektori i Certifikimit.

ESHFF kryen procesin e certifikimit të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor në varësi të kërkesave të subjekteve furnizuese⁴⁵.

Procesi i certifikimit zyrtar të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor për periudhën 2020-qershor 2022 ka qenë me kërkesë të subjekteve tregtuese të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor duke dorëzuar dokumentacionin përkatës pranë ESHFF, kurse për periudhën qershor 2022 e në vazhdim ky proces realizohet on line nëpërmjet portalit e-albania.⁴⁶

Kërkesat që duhet të plotësohen për certifikimin e farave të drithërave të prodhuara në vend dhe procedura e certifikimit të tyre⁴⁷ pasqyron hapat dhe dokumentacionin që duhet të plotësojnë subjektet tregtuese të farës së drithërave për pajisjen e tyre me certifikatë zyrtare në mënyrë që materiali mbjellës dhe shumëzues bimor (farëra e drithërave) të jete i gatshëm për mbjellje nga fermerët me qëllim prodhimin e drithërave. Drithërat kryesore që kultivohen në Shqipëri janë gruri, misri, elbi, thekra dhe tagjira.

Për periudhën në auditim sasia e drithërave të certifikuar nga ESHFF është 1,040,900 kg në vitin 2020, në vitin 2021 është 973,400 kg dhe në vitin 2022 është 1,064,500 kg ndërsa sasia e mbjellë në hektar në Shqipëri është 131,310 ha për vitin 2020, në vitin 2021 është 134,339 ha kurse në vitin 2022 është 132,839 ha, të cilat paraqiten në mënyrë tabelore dhe grafikusht në vijim:

Tabela. 13: Drithërat

Nr.	Emërtimi	Njësia	2020	2021	2022
1	Drithëra në total të certifikuar nga ESHFF	Kg	1,040,900	973,400	1,064,500
2	Sasia e mbjellë ne Shqipëri	Hektarë	131,310	134,339	132,839

Te dhënat ESHFF,MBZHR përpunoi grupi i auditimit

⁴⁴ Ligji nr.10416 datë 07.04.2011 “Mbi materialin mbjellës dhe shumëzuesin bimor” i ndryshuar, neni 14 pika 1


⁴⁵ Ligji nr.10416 datë 07.04.2011 “Mbi materialin mbjellës dhe shumëzuesin bimor” i ndryshuar, neni 15 pika 1

⁴⁶ Kërkesë e ESHFF me nr.258.prot., datë 30.04.2022 drejtuar AKSH-it.

⁴⁷ KM nr. 86, datë 30.1.2013, “Për përcaktimin e kriterëve të tregtimit, certifikimit dhe testimit tëvarieteteve për farat e drithërave”, kreu III pika 1.2

Më poshtë paraqitet grafiku i certifikimit të farës së drithërave nga ESHFF për vitet 2020-2022 e krahasuar me sasinë në hektar të fushave të mbjella në Shqipëri.

Grafiku nr. 1



Te dhënat ESHFF, MBZHR përpunoi grupi i auditimit

Për sa më sipër vihet re që sasia në kg e drithërave të certifikuar nga ESHFF dhe sipërfaqet e mbjella me to në vendin tonë për periudhën në auditim ka pësuar luhatje të lehta dhe jo domethënëse.

Materiali mbjellës dhe shumëzues bimor i perimeve përveç farës, që të tregtohet, duhet të plotësojë kushtet⁴⁸ dhe kriteret e përgjithshme, si dhe kriteret teknike. Materiali mbjellës dhe shumëzues bimor të perimeve përveç farës që prodhohet në vend duhet të certifikohet nga Enti Shtetëror i Farërave dhe Fidanëve.⁴⁹

Llojet e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të perimeve dhe bostanoreve që janë prodhuar tregtuar dhe mbjelle në Shqipëri për periudhën në auditim janë domate, spec, trangull, patëllxhan, brokoli, lakër, lakër e kuqe, lakër koke, lulëlakër, sallatë jeshile, qepë, kungull shalqi, pjepër. MBZHR në përgjigjen e saj⁵⁰, drejtuar grupit të auditimit ka vënë në dispozicion sasinë e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të certifikuar nga ESHFF për periudhën 2020-2022 dhe sasinë e mbjella në hektar. Më poshtë paraqitet tabela e sasive të fidanëve të certifikuar me sipërfaqet e mbjella me perime & bostanore për periudhën në auditim.

Tabela 14: Perimet dhe Bostanoret

Nr.	Perime & bostanore	Njësia	2020	2021	2022
1	Certifikimi i tyre në ESHFF	Fidanë	6,911,800	9,040,400	53,049,950
2	Sasia e mbjellë në Shqipëri	Hektar	33,502	33,506	33,797

Të dhënat ESHFF, MBZHR përpunoi grupi i auditimit


Më poshtë paraqitet grafiku i krahasimit të fidanëve perimorë & bostanorë për sasinë e certifikuar nga ESHFF me sasinë në hektar të mbjellë në Shqipëri për vitet 2020-2022.

⁴⁸ VKM nr. 530, datë 13.6.2013 'Për përcaktimin e kriterëve të tregtimit dhe të certifikimit të materialit mbjellës dhe shumëzues të perimeve, përveç farës' kreu II, pika 1 dhe 2.

⁴⁹ VKM nr. 530, datë 13.6.2013 'Për përcaktimin e kriterëve të tregtimit dhe të certifikimit të materialit mbjellës dhe shumëzues të perimeve, përveç farës' kreu II, pika 1 germa c.

⁵⁰ Përgjigje e pyetësorit nr.3

Grafiku nr. 2



Te dhënat ESHFF,MBZHR përpunoi grupi i auditimit

Nga grafiku i mësipërm konstatohet se materiali mbjellës dhe shumëzues bimor i certifikuar nga ESHFF ka pësuar rritje të konsiderueshme për vitin 2022 në lidhje me perimet & bostanoret krahasuar me vitet e mëparshme.

Procedurat për certifikimin e materialit të shumëzimit dhe të fidanëve drufrutorë⁵¹,përcaktojnë hapat që ndiqen nga subjektet për certifikimin e fidanëve drufrutorë.

Materiali mbjellës dhe shumëzues bimor i certifikuar në lidhje me fidanët drufrutore.⁵² ka pësuar rënie në procesin e certifikimit për vitin 2022.

Grupi i auditimit mori në shqyrtim të dhënat për certifikimet e kryera nga ESHFF për pemët frutore që përbëhen nga arra, bajame, dardhe, fik, ftua gështenje, hurma, kajsi kivi, kumbull, lajthi, manaferre, mollë, mushmollë, qersh dhe shegë si edhe ullinjë, agrumet që përbëhen nga portokall, mandarinë limon etj. Gjithashtu u përdoren të dhënat për certifikimet e pjergullave dhe vreshtave. Certifikimet e kryera nga ESHFF për fidanët drufrutorë të mësipërm si dhe sipërfaqet e mbjella për periudhën e auditimit janë si më poshtë vijon:

Tabela 15. Fidanë dru frutorë

Nr.	Emërtimi	Njësia	2020	2021	2022
1	Fidanë drufrutorë	Fidanë	800,000	616,400	370,650
2	Sipërfaqet e mbjella	hektar	86,912	87,630	88,243

Te dhënat MBZHR përpunoi grupi i auditimit

Siç vihet re nga tabela e mësipërme numri i certifikimeve për fidanët drufrutorë ka pësuar rënie të ndjeshme për periudhën në auditim.


Në fund të vitit 2022 rezultojnë të mbjella në Shqipëri 88,243 ha me pemë frutore e krahasuar me vitin 2020 ka rritje 1,331 ha të cilat kanë ardhur si rrjedhojë e përdorimit të fidanëve të certifikuar nga ESHFF të vitit 2021 dhe vitit 2022 (616,400+370,650) =987,050 fidanë.

⁵¹ VKM nr. 240, datë 27.3.2013 “Për përcaktimin e kritereve të tregtimit dhe të certifikimit të materialeve të shumëzimit dhe të fidanëve të bimëve drufrutore” kreu IV

⁵² Aneks 3 bashkëngjitur raportit.

Më poshtë paraqitet grafiku i numrit të certifikimeve të fidanëve drufrutorë në Shqipëri për periudhën 2020-2022.

Grafiku nr. 3



Te dhënat ESHFF,MBZHR përpunoi grupi i auditimit

Materiali mbjellës dhe shumëzues bimor i certifikuar për bimët medicinale ka ardhur me një rënie të pashpjegueshme pasi certifikimi i materialit mbjellës së tyre nga ESHFF rezulton nga 78,4 milion fidanë në vitin 2021, në zero fidanë në vitin 2022. Sasia e mbjelljes në hektar të bimëve medicinale për vitin 2020 është 6,297 ha, për vitin 2021 rezultojnë 7,040 ha kurse për vitin 2022 rezultojnë 7,098 ha. Të dhëna në mënyrë tabelore në vijim


Tabela 16: Bimë medicinale

Nr.	Emërtimi	Njësia	2020	2021	2022
1	Bimë Medicinale dhe erëza	Fidanë	22,760,000	78,404,000	-
2	Sipërfaqet e mbjella	Hektar	6,297	7,040	7,098

Të dhënat ESHFF.MBZHR përpunoi grupi i auditimit

Më poshtë paraqitet grafiku i certifikimeve të kryera nga ESHFF për bimët medicinale krahasuar me sipërfaqet e mbjella për periudhën 2020-2022.

Grafiku nr.4



Te dhënat ESHFF, MBZHR përpunoi grupi i auditimit

Për periudhën në auditim nuk është certifikuar nga ESHFF asnjë material mbjellës dhe shumëzues bimor për kulturat e luleshtrydhes, fasules, duhanit, luledielliit sojës dhe panxhar sheqerit.⁵³ ndërkohë që rezultojnë sipërfaqe të tëra të mbjella në hektar për secilën nga këto kultura shprehur në tabelën në vijim:

Tabela 17: Fidanët e certifikuar në raport me sipërfaqet e mbjella

Nr.	Emërtimi	2020	2021	2022
1	Luleshtrydhe	121	120	131
2	Fasule	13,346	13,363	12,993
3	Duhan	757	829	832
4	Luledielli	542	389	333
5	Sojë	171	155	239
6	Panxharsheqeri	837	757	659

Te dhënat ESHFF, MBZHR përpunoi grupi i auditimit

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nuk ka realizuar një analizë të detajuar në lidhje me sipërfaqet e mbjella me material mbjellës dhe shumëzues bimor të kulturave të luleshtrydhes, fasules, duhanit, luledielliit sojës dhe panxhar sheqerit.

Për vitet 2020-2022 nuk është certifikuar asnjë material mbjellës dhe shumëzues bimor i luleshtrydhes ndërkohë që rezultojnë të mbjella 121 hektarë për vitin 2020, 120 hektarë për vitin 2021 dhe 131 hektarë për vitin 2022.

- Për kulturën e fasules nuk është certifikuar asnjë material mbjellës dhe shumëzues bimor nga ana e ESHFF ndërkohë që rezultojnë për vitin 2020 të mbjella 13,346 hektarë, për vitin 2021 rezultojnë 13,363 hektarë të mbjella dhe për vitin 2022 rezultojnë 12,993 hektarë të mbjella.

- Për periudhën 2020-2022 nuk është certifikuar asnjë material mbjellës dhe shumëzues bimor për duhanin ndërkohë që janë mbjellë 757 hektarë për vitin 2020, për vitin 2021 janë mbjellë 829 hektarë dhe për vitin 2022 janë mbjellë 832 hektarë.

⁵³ Përgjigje e pyetësorit nr.3

- Për periudhën 2020-2022 nuk është certifikuar asnjë material mbjellës dhe shumëzues bimor për lulediellin ndërkohë që janë mbjellë 542 hektarë për vitin 2020, për vitin 2021 janë mbjellë 389 hektarë dhe për vitin 2022 janë mbjellë 333 hektarë.

-Për periudhën 2020-2022 nuk është certifikuar asnjë material mbjellës dhe shumëzues bimor për panxhar sheqerin ndërkohë që janë mbjellë 837 hektarë për vitin 2020, për vitin 2021 janë mbjellë 757 hektarë dhe për vitin 2022 janë mbjellë 659 hektarë.

Për periudhën 2020-2022 nuk është certifikuar asnjë material mbjellës dhe shumëzues bimor për sojën ndërkohë që janë mbjellë 171 hektarë për vitin 2020, për vitin 2021 janë mbjellë 155 hektarë dhe për vitin 2022 janë mbjellë 239 hektarë.

Entit shtetëror i Farërave dhe Fidanëve kryen procesin e certifikimit të gjithë llojeve të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor në varësi të kërkesave që bëjnë subjektet në lidhje certifikimin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor.⁵⁴

Materiali mbjellës dhe shumëzues bimor dhe drufrutore që të tregtohet duhet që jete i certifikuar⁵⁵

ESHFF-ja, për mbajtjen dhe ruajtjen e të dhënave të furnizuesve të licencuar, të të dhënave të prodhimit, të importit dhe të eksportit të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të KK-së mund të marrë dhe mund të përdorë të dhëna, të mbajtura nga ente shtetërore të autorizuar, subjekte, agjenci publike, koncesionare dhe autoritete të tjera të autorizuar.⁵⁶

Për sa më sipër Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural si dhe ESHFF nuk disponojnë të dhëna numerike të specifikuar për secilin fidan perimor & bostanor për sa i përket importit dhe eksportit të tyre si dhe nuk ka bashkëpunim në asnjë moment as me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave por edhe me AKU për të marrë të dhëna në kohë reale mbi sasitë e importit apo të eksportit në lidhje me MMSHB. Ndërkohë procesin e kontrollit për subjektet tregtuese për të verifikuar nëse materialet që tregtojnë janë të certifikuar kryhet nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.⁵⁷

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit kryen kontrollin pranë subjekteve që tregtojnë material mbjellës dhe shumëzues bimor në bazë të planeve me bazë risku të miratuara nga MBZHR.⁵⁸

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit për zbatimin e këtyre detyrave duhet të bashkëpunojë me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, veprime të pakryera.

⁵⁴ VKM nr. 240, datë 27.3.2013 “Për përcaktimin e kriterëve të tregtimit dhe të certifikimit të materialeve të shumëzimit dhe të fidanëve të bimëve drufrutore” kreu IV pika 2

⁵⁵ Ligji nr.10416 datë 07.04.2011 “Mbi materialin mbjellës dhe shumëzuesin bimor” i ndryshuar, neni 4 pika 7 germa c.

⁵⁶ Ligji nr.10416 datë 07.04.2011 “Mbi materialin mbjellës dhe shumëzuesin bimor” i ndryshuar, neni 45, pika 1

⁵⁷ Ligji nr.10416 datë 07.04.2011 “Mbi materialin mbjellës dhe shumëzuesin bimor” i ndryshuar, neni 42 pika 1

⁵⁸ Udhëzim nr. 2, datë 24.2.2020 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Kontrolleve Zyrtare me bazë Risku dhe të marrjes së Mostrave Për Ushqimin, Ushqimin për Kafshë, Mbrojtjen e Bimëve dhe In put-eve Bujqësore, si dhe Planin e marrjes së Mostrave në PIK për vitin 2020”;

-Udhëzim nr. 3, datë 18.1.2021 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Kontrolleve Zyrtare me bazë Risku dhe të marrjes së Mostrave Për Ushqimin, Ushqimin për Kafshë, Mbrojtjen e Bimëve dhe In put-eve Bujqësore, si dhe Planin e marrjes së Mostrave në PIK për vitin 2021;

-Udhëzim nr. 24, datë 31.12.2022 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Kontrolleve Zyrtare me bazë Risku dhe të marrjes së Mostrave Për Ushqimin, Ushqimin për Kafshë, Mbrojtjen e Bimëve dhe In put-eve Bujqësore, si dhe Planin e marrjes së Mostrave në PIK për vitin 2022;

-Udhëzim nr. 22, datë 29.12.2022 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Kontrolleve Zyrtare me bazë Risku dhe të marrjes së Mostrave Për Ushqimin, Ushqimin për Kafshë, Mbrojtjen e Bimëve dhe In put-eve Bujqësore, si dhe Planin e marrjes së Mostrave në PIK për vitin 2023.

Pra nuk ka koordinim mes MBZHR-së- ESHFF, AKU si dhe DPD-së, në mënyrë që të kontrollohet i gjithë tregu i materialit mbjellës shumëzues bimor si ai që hyn nëpërmjet importit ashtu edhe prodhimi vendas. Mos koordinimi i këtyre institucioneve sjell risk të shtuar në cilësinë e MMSHB-së pasi nuk jepet garanci nga asnjë institucion që sipërfaqet e mbjella me MMSHB të jenë me fidanë të certifikuar.

Në Shqipëri rezultojnë 818 subjekte që prodhojnë dhe tregtojnë material mbjellës dhe shumëzues bimor të cilat u nënshtrohen kontrolleve me bazë risku nga AKU. Kjo listë duhet të përditësohet periodikisht nga ESHFF pasi Furnizuesi njofton çdo vit organin e certifikimit, në një afat kohor të përcaktuar, për certifikimin zyrtar të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të specieve të përcaktuara sipas Ligjit⁵⁹ me anë të kërkesës së subjekteve. Kjo listë nuk iu vu në dispozicion grupit të auditimit.

6. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2022 janë 7,098 hektarë të mbjella me bimë medicinale në Shqipëri (shifër e përafërt me vitet 2020-2021) dhe nuk rezulton asnjë fidan i tillë i certifikuar nga Enti Shtetëror i Farërave dhe Fidanëve, ndërkohë që për sipërfaqe të përafërta të mbjella për vitet e mëparshme rezultojnë rreth 78 mln fidanë të certifikuar për vitin 2021 dhe 22,7 mln fidanë të certifikuar për vitin 2020. Për vitet 2020-2022 nuk është certifikuar asnjë material mbjellës dhe shumëzues bimor i luleshtrydhes fasules, duhanit, lulediellit sojës dhe panxhar sheqerit.

- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nuk ka realizuar një analizë të detajuar në lidhje me sipërfaqet e mbjella me material mbjellës dhe shumëzues bimor të kulturave të luleshtrydhes, fasules, duhanit, lulediellit sojës dhe panxhar sheqerit.

-Nuk janë analizuar importet dhe eksportet e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të tyre, për të vlerësuar sa material mbjellës dhe shumëzues bimor duhet ti nënshtrohet certifikimit nga ana e Entit Shtetëror të Farërave dhe Fidanëve për vitet 2020-2022 pasi rezulton që nuk është certifikuar asnjë prej këtyre materialeve mbjellës dhe shumëzues bimor.

6.1 Rekomandimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural me institucionet e varësisë të koordinojnë të dhënat në kohë reale me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave për importet dhe eksportet e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor për të saktësuar, listën e furnizuesve, materialin mbjellës dhe shumëzues bimor të certifikuar dhe sipërfaqet e mbjella.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nuk ka realizuar një analizë të detajuar në lidhje me sipërfaqet e mbjella me material mbjellës dhe shumëzues bimor të kulturave të luleshtrydhes, fasules, duhanit, lulediellit sojës dhe panxhar sheqerit duke dhënë statistika që nuk garantojnë dhe nuk japin siguri për kontrollin e fidanëve të certifikuar.

-Nuk ka të dhëna konkrete dhe në kohë reale as nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe as nga institucionet e varësisë në lidhje me sasinë e importuara dhe ato të eksportuara të materialit mbjellës shumëzues bimor të tyre, duke krijuar një gjendje konfuze dhe të pa qartë për garantimin e procesit të certifikimit të materialit mbjellës shumëzues bimor i cili ndikon në cilësinë e MMSHB-së

- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural së bashku me strukturat e saj të varësisë Autoritetin Kombëtar të Ushqimit dhe Entin Shtetëror të Farërave dhe Fidanëve nuk kanë arritur të maksimizojnë të ardhurat nga procesi i certifikimit të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor si

⁵⁹ Ligji nr.10416 datë 07.04.2011 “Mbi materialin mbjellës dhe shumëzuesin bimor” i ndryshuar, neni 15

pasojë e mos koordinimit në kohë në drejtim të verifikimit dhe kontrollit të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor.

2. Konkluzion: Mungesa e bashkëpunimit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural me institucionet e varësisë në drejtim të përpunimit të të dhënave vjetore në fushën e prodhimit dhe të tregtimit të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të krahasuar me sipërfaqet e mbjella të tij, mungesa e të dhënave në bashkërendim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave për importet dhe eksportet e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor ka ndikuar negativisht në hartimin e një plani korrekt me bazë risku për kontrollin e subjekteve prodhuese dhe tregtuese të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor dhe në uljen e të ardhurave që do të krijoheshin nga certifikimi i materialit mbjellës shumëzues bimor.

7.1 Rekomandimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në bashkëpunim me Autoritetin Kombëtar të Ushqimit dhe Entin Shtetëror të Farave dhe Fidanëve të përditësojnë të dhënat mbi materialin mbjellës dhe shumëzues bimor të importuar dhe eksportuar për të hartuar dhe realizuar me objektiva të matshëm dhe gjithë përfshirës planin e kontrollit me bazë risku për subjektet tregtuese të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor.

Menjëherë dhe në vijimësi

7.2 Rekomandimi: Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve të marrë masa dhe të publikojë në web, listën e përditësuar të furnizuesve për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor, periodikisht me qëllim garantimin e zinxhirit të procesit të certifikimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

7.3 Rekomandimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural me institucionet e varësisë të koordinojnë të dhënat në kohë reale me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave për importet dhe eksportet e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor për të saktësuar, listën e furnizuesve, materialin mbjellës dhe shumëzues bimor të certifikuar dhe sipërfaqet e mbjella.

5.2.2 A i kanë shërbyer të ardhurat dytësore të krijuara nga ESHFF, AKU, QTTB, përmirësimit të menaxhimit të materialit shumëzues mbjellës bimor?

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ka krijuar të ardhura nga tarifat⁶⁰ që kanë të bëjnë me materialin mbjellës dhe shumëzues bimor për vitet 2020-2022 sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela 18: Të ardhurat për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor nga AKU


VITI	Të ardhura nga analizat për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor	Të ardhura nga tarifat PIK materialin mbjellës dhe shumëzues bimor	Të ardhura nga pagesat e gjobave vendosur për MMSHB	Totali i të ardhurave materialin mbjellës dhe shumëzues bimor
2020	500	2,192,300	833,460	3,026,260
2021	-	2,171,100	1,800,000	3,971,100
2022	15,000	1,966,100	470,000	2,437,100
Totali	15,500	6,329,500	3,103,460	9,434,460

Burimi MBZHR, AKU, përpunoi grupi i auditimit

⁶⁰ VKM Nr.432, datë 28.6.2006 “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave, që krijojnë institucionet buxhetore”

Sikurse konstatohet, të ardhurat për MMSHB nga AKU kanë ulje të ndjeshme në vitin 2022 krahasuar me vitin 2021 ose e thënë ndryshe 1,534 mijë lekë më pak, për arsye kjo të arkëtimeve të gjobave të kryera në vitin 2021.

Më poshtë paraqitet ilustrimi grafik i të ardhurave të AKU nga materiali mbjellës dhe shumëzues bimor për periudhën në auditim 2020-2022.



Burimi MBZHR, AKU, përpunoi grupi i auditimit

AKU ka krijuar debitorë ndër vite që nga viti 2018 për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor që rrjedhin nga gjoba të vendosura nga Drejtoritë Rajonale të AKU në vlerën totale 5,180,000 lekë nga të cilat rezultojnë të pa arkëtuara deri në fund të vitit 2022, vlera prej 2,810,000 lekë.⁶¹ ose e thënë ndryshe 54 % e tyre.

Qendrat e Transferimit të Teknologjive Bujqësore kanë krijuar të ardhura nga tarifat e analizave laboratorike si dhe të ardhura për testimin e varieteteve për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor sipas kontratave të lidhura me Entin Shtetëror të Farërave dhe Fidanëve për periudhën në auditimi 2020-2022.

Nga përgjigjet e pyetësorëve drejtuar QTTB rezulton që në fund të vitit 2022 nuk rezultojnë subjekte debitorë për tarifat e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor.⁶²

Të ardhurat nga analizat laboratorike, tarifat për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor për periudhën në jepen në tabelën në vijim:

Tabela 19: Të ardhurat e krijuara nga Testimi i varieteteve dhe analizave laboratorike për MMSHB nga QTTB-të .

Nr.	QTTB	Viti			Totali
		2020	2021	2022	
1	Lushnje	196,200	408,450	327,000	931,650
2	Vlorë	0	0	150,000	150,000
3	Fushë Krujë	0	0		0
4	Korçë	3,578,550	3,130,600	5,500,405	12,209,555
5	Shkodër	180,000	180,000	175,000	535,000
Totali		3,954,750	3,719,050	6,152,405	13,826,205


Burimi MBZHR, QTTB, përpunoi grupi i auditimit

⁶¹ Përgjigje e pyetësorit nr.3 nga MBZHR,AKU

⁶² Përgjigje e pyetësorit nr.3 nga MBZHR,QTTB

QTTB Vlorë dhe Shkodër realizojnë të ardhura vetëm nga procesi i testimit të varieteteve në bazë të kontratave të lidhura me ESHFF për kryerjen e provave fushore të mbjelljes, mbikëqyrjes së varietetit deri sa të dalë në prodhim, mbjellje të cilat kryhen në tokat që QTTB kanë në dispozicion. QTTB Fushë- Krujë nuk ka pasur kontrata të lidhura me ESHFF për testimin e varietetit për periudhën 2020-2022. Më poshtë paraqitet grafiku i të ardhurave të realizuara nga QTTB për Materialin mbjellës dhe shumëzues bimor për periudhën 2020-2022.

Grafiku nr. 6



Burimi MBZHR, QTTB, përpunoi grupi i auditimit

Siç vërehet edhe nga grafiku të ardhurat e realizuara nga QTTB për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor kanë pësuar rritje të konsiderueshme për vitin 2022 krahasuar me vitin 2021. Për vitin 2022 rezulton rritje e të ardhurave në shumën 2,433,355 lekë ose rritje me 65% krahasuar me vitin 2021.

-Enti shtetëror i farërave dhe fidanëve realizon të ardhura nga testimet e varieteteve për regjistrim në katalogun kombëtar, të ardhura nga analizat laboratorike si dhe të ardhura nga certifikimet zyrtare të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor.⁶³ Referuar Udhëzimit të Ministrit të Bujqësisë dhe Mbrojtjes së Mbrojtjes së Konsumatorit sot Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural me Ministrinë e Financave⁶⁴, Enti Shtetëror i Farërave dhe Fidanëve 30% të të ardhurave të mbledhura kalojnë në buxhetin e tij dhe 70% e tyre në buxhetin e Shtetit.

Te ardhurat e realizuara nga ESHFF për periudhën në auditim 2020-2022 paraqiten si më poshtë vijon:

Tabela 20.: Të ardhurat dytësore të krijuara nga aktiviteti i ESHFF.

Viti	Te ardhura nga testimet e varieteteve	Të ardhura nga analizat laboratorike	Të ardhura nga certifikimet	Totali
Viti 2020	2,332,056	330,498	2,180,234	4,842,788
Viti 2021	4,323,071	266,020	3,146,950	7,736,041
Viti 2022	3,202,752	323,301	1,748,197	5,274,250

⁶³ Udhëzimi nr. 9 datë 29.05.2014 Për një ndryshim në udhëzimin nr.8 datë 08.05.2007 “Mbi tarifat e të ardhurave dytësore të aplikueshme nga institucionet e varësisë dhe Ministrisë së Bujqësisë Ushqimit dhe mbrojtjes së Konsumatorit”.


Udhëzim nr. 19 datë 22.11.2022 i Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural “Mbi tarifat dhe të ardhurat dytësore të aplikueshme nga institucionet e vartëse të dhe Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.”

⁶⁴ Udhëzim nr. 1 datë 24.10.2006 i Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Bujqësisë.

TOTALI	9,857,879	919,819	7,075,381	17,853,079
---------------	------------------	----------------	------------------	-------------------

Burimi ESHFF përpunoi grupi i auditimit

Te ardhurat nga testimet e varieteteve për regjistrim në katalogun kombëtar kanë pësuar luhatje për periudhën në auditim duke pësuar rritje për vitin 2021 me 1,991,015 lekë krahasuar me vitin 2020 dhe ulje me 1,121,000 lekë për vitin 2022 krahasuar me vitin 2021. *(Trajtuar situata në procesin e testimit të varietetit për regjistrim në katalogun kombëtar në pyetjen 4.2.1)*



Te dhënat ESHFF, përpunoi grupi i auditimit

Enti Shtetëror i farërave dhe fidanëve kryen analiza laboratorike për fuqinë mbirëse të farës si dhe të lagështisë së saj. Analizat kryhen nga Laboratori Qendror i Testimit të Farave (LQTF) i cili funksionon si pjesë e Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve që nga viti 1996.

Laboratori që funksionon pranë ESHFF, është anëtar i Shoqatës Ndërkombëtare të Testimit të Farave (ISTA), që nga viti 1998.

ESHFF për periudhën në auditim ka kryer analiza të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor si më poshtë vijon:⁶⁵

- Analiza për certifikim (mostra të marra nga specialistët e ESHFF-së zyrtare).

-Analiza për cilësinë e farës (mostra nga importi) analiza për efekt kontrolli për vitalitetin e farës te sjelle nga AKU (zyrtare).

-Analiza për efekt kontrolli për verifikimin e rënies së fuqisë mbirëse (ri testim). Më poshtë paraqitet numri i analizave të kryera nga ESHFF për periudhën 2020-2022.

Tabela 21: Numri i analizave të kryera sipas llojeve për periudhën në auditim


Nr.	Viti	Nr. analizave nga mostrat e marra nga ESHFF	Nr. i analizave nga mostra të ardhura nga AKU	Nr. i analizave nga mostra të ardhura nga UBT	Nr. total i analizave
1	2020	281	231	5	517
2	2021	286	197	11	494
3	2022	409	154	0	563

Te dhënat ESHFF përpunoi grupi i auditimit

Të ardhurat nga analizat laboratorike nuk kanë pësuar luhatje të ndjeshme për periudhën në auditim. Ato paraqiten në vlerën 330,498 lekë për vitin 2020, në vlerën 266,020 leke në vitin 2021 dhe në vlerën 323,301 leke për vitin 2022, paraqitur në grafikun si vijon:

⁶⁵ Përgjigje e pyetësorit nr.1


Grafik nr. 8



Të dhënat ESHFF përpunoi grupi i auditimit

Nga procesi i certifikimit të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor për vitin 2020 janë realizuar 2,180,234 lekë të ardhura, për vitin 2021 janë realizuar 3,146,950 lekë dhe për vitin 2022 janë realizuar 1,748,197 lekë të ardhura.

Grafiku nr. 9



Të dhënat ESHFF përpunoi grupi i auditimit

Pra ka një rënie të të ardhurave për certifikimet në vitin 2022 me 1,398,753 lekë ose 44 % më pak në procesin e certifikimit trajtuar më hollësisht në pyetjen 4.2.1.

1. Gjetje nga auditimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural me strukturat e saj të varësisë Autoritetin Kombëtar të Ushqimit dhe Entin Shtetëror të Farërave dhe Fidanëve nuk kanë arritur të maksimizojnë të ardhurat nga procesi i certifikimit të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor si pasojë e mos koordinimit në kohë në drejtim të verifikimit dhe kontrollit të materialit mbjellës dhe bimor.

- Rezultojnë subjekte debitorë në Autoritetin Kombëtar të Ushqimit për penalitetet e vendosura për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor në vlerën 2,810,000 lekë të cilat nuk janë arkëtuar në 3 vite.

1. Konkluzion: Mungesa e bashkëpunimit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural me institucionet e varësisë në drejtim të përpunimit të të dhënave vjetore në fushën e prodhimit të certifikimit, analizave laboratorike dhe të tregtimit të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor ka sjellë uljen e të ardhurave të realizuara për këtë proces.

1.1. Rekomandimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në bashkëpunim me Entin Shtetëror të Farërave dhe Fidanëve të analizojnë situatën e procesit të certifikimit të materialit mbjellës dhe shumëzues me qëllim rritjen e të ardhurave.

1.2. Rekomandimi: Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të marrë masa për arkëtimin e gjobave duke ndjekur të gjitha procedurat e mbledhjes së detyrimeve.

5.2.3. A kanë në dispozicion strukturat e kontrollit dhe inspektimit të AKU, QTTB-ve, ESHFF-së logjistikën e nevojshme dhe burimet njerëzore të mjaftueshme për realizimin e detyrave kontrolluese dhe inspektuese?

Strukturat përgjegjëse për kontrollim dhe inspektim.

Në lidhje me procesin e kontrollit dhe të inspektimit Ligji 10416, datë 07.04.2011, i ndryshuar, “Për materialin mbjellës shumëzues bimor”, përcakton se:

- ESHFF duhet të verifikojë dhe të analizojë mostrat e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të importuara, të sjella nga inspektori i AKU-së,
- Të kontrollojë të dhënat e mbajtura nga furnizuesi për mirëmbajtjen e një varieteti, për sigurimin ose blerjen e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, prodhimin, furnizimin ose importin, përgatitjen për treg, stoqet dhe shitjet;
- të organizojë dhe të kryejë testimin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të ri, të krijuar ose/dhe të importuar;

Detyrat e AKU-së për realizimin e qëllimit të këtij ligji janë si më poshtë:

- Të kontrollojë materialin mbjellës dhe shumëzues bimor të furnizuesit, në çdo kohë dhe në çdo vend ku ai magazinohet, përpunohet, përgatitet për treg e tregtohet;
- Të kontrollojë materialin mbjellës dhe shumëzues bimor nëse plotëson kërkesat e përcaktuara në këtë ligj;
- Të kontrollojë në magazinat e furnizuesve ose në treg materialin mbjellës shumëzues bimor të importuar, për plotësimin e kërkesave për tregtim, të përcaktuara në këtë ligj;

Pra nga sa më sipër grupi i auditimit vlerësoi të rëndësishme auditimin e funksionimit të procesit të kontrollit dhe inspektimit nga strukturat e sipër cituara dhe në varësi të MBZHR-së.

Lidhja dhe varësia e subjekteve në auditim jepet në organigramën e mëposhtme:




Figura 5: Organigrama e MBZHR-së dhe e subjekteve të varësisë

I. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR)⁶⁶, kujdeset për:

Hartimin dhe zbatimin e politikave për sigurinë ushqimore, cilësinë e produkteve ushqimore, duke përfshirë gjithë zinxhirin ushqimor nga ferma në tavolinë;


Hartimin dhe zbatimin e politikave për shëndetin e kafshëve e të bimëve, nëpërmjet Drejtorisë së Politikave të shëndetit të bimëve (DPSHB) dhe Sektorit të Farave, fidanëve dhe produkteve plehëruese (SFFPP), sipas Urdhrit nr. 185, datë 29.03. 2023 “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të MBZHR-së.

Sipas organigramës së strukturës së MBZHR⁶⁷, prej 01.01.2020 deri në muajin korrik të vitit 2022, ka funksionuar Drejtoria e Politikave dhe Programeve të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, e përbërë nga 5 sektorë, midis tyre, **Spektori i shëndetit të mbrojtjes së bimëve dhe OMGJ** (organizmat e modifikuar gjenetiksht) me përbërje: (1+2) punonjës.

Në bazë të detyrave funksionale, strukturat e sipërcituara, kanë pasur përgjegjësi:

- a. mbi hartimin dhe zbatimin e politikave, strategjive për mbrojtjen e bimëve nga parazitët;
- b. për mbrojtjen e shëndetit të njerëzve, kafshëve dhe mjedisit, nga përdorimi i produkteve për mbrojtjen e bimëve (PMB-pesticidet);
- c. për kryerjen e procedurave për regjistrimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve dhe hartimin e listës së PMB të regjistruara sa herë që pëson ndryshime dhe hedhjen e saj në faqen zyrtare të ministrisë;
- d. përmirësimin e legjislacionit në përputhje me direktivat e BE-së.

Figura 6- Organi grama e pjesshme e MBZHR për periudhën 01.01.2020 deri në 01.07.2022.



Në referim të detyrave funksionale sipas rregulloreve të funksionimit të brendshëm të MBZHR, nga auditimi *nuk konstatuam detyra funksionale të specifikuara dhe të dedikuara për menaxhimin dhe monitorimin e farave, fidanëve dhe materialin mbjellës dhe shumëzues bimor.*

Nga dokumentet dhe informacionet e audituara dhe përgjigjeve të pyetësorëve⁶⁸ të vendosura në dispozicion nga MBZHR, nuk rezultoi:

- të ketë gjurmë të kryerjes së kontrollit të analizave operacionale periodike në menaxhimin dhe monitorimin e funksionimit të procesit të certifikimit, testimit dhe monitorimit të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, në koordinim me institucionet e varësisë (ESHFF, AKU dhe QTTB).

- asnjë relacion ose informacion për sasitë e eksportuara nga inspektorët e PIK-ut të AKU-së, rrjedhimisht nuk ka të dhëna mbi sasitë e stokut të MBSHB që mund të jenë krijuar nga operatorët bujqësorë as nga MBZHR dhe institucionet e varësisë (ESHFF dhe AKU).

- të ketë hartuar plane për trajnimin e specialistëve në fushën e farave dhe fidanëve për periudhën 2020-2022.


⁶⁶ Ligji nr.9817 datë 22.10.2007 “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”

⁶⁷ Rregullorja nr.1 datë 27.09.2019 “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të MBZHR” e ndryshuar; Rregullore nr.4276 prot datë 02.06.2021 “Rregullore për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të MBZHR” në zbatim të Urdhrit i Kryeministrit nr.39, datë 22.01.2021.

⁶⁸ Pyetësori nr.1; 2 dhe 3 të hartuar nga grupi i auditimit.

Mungesa e konstatimeve të mësipërme nga strukturat e MBZHR janë në kundërshtim me ligjin⁶⁹ e menaxhimit financiar dhe kontrollit si dhe nxjerrin në pah mungesën e sistemeve të kontrollit mbi aktivitetet e MBSHB, si pasojë e mungesës së një strukture të dedikuar për materialin fara dhe fidanë dhe të një rregulloreje me detyra të specifikuar e role të qarta. Më poshtë jepet organigrama e Sektorit të Farave dhe Fidanëve në MBZHR:

Figura 7- Organigrama e pjesshme e MBZHR për periudhën 01.07.2022 e në vazhdim.



Prej muajit korrik 2022, në MBZHR është miratuar struktura⁷⁰ e re. Strukturat kanë filluar funksionimin në mars të vitit 2023, me miratimin e rregullores së brendshme⁷¹.

Drejtoria e Politikave të Shëndetit të Bimëve, Farave dhe Plehrave, tashmë ka detyra funksionale të qarta dhe të drejtpërdrejta mbi menaxhimin e materialit mbjellës, përfaqësuar me Sektorin e farave, fidanëve dhe produkteve plehëruese (1+2) punonjës me 1 (një) vakant.

Sektor i Farëve, Fidanëve dhe Produkteve Plehëruese, ka këto përgjegjësi:

- Hartoni politikat, strategjitë dhe legjislacionin për prodhimin, regjistrimin, tregtimin, importin, eksportin, përdorimin, kontrollin e cilësisë, gjurmueshmërinë, informimin, reklamimin dhe inspektimin e veprimtarive që lidhen me produktet plehëruese, si dhe kushtet për prodhimin, përgatitjen për tregtim, tregtimin, përfshirë importin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor;
- Hartoni politikat dhe legjislacionin për produktet plehëruese;
- Zhvillon procedurat në lidhje me regjistrimin e produkteve plehëruese;
- Mbikëqyr zbatimin e procedurave ligjore mbi regjistrimin, kontrollin, tregtimin, certifikimin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor;
- Hartoni Politikat dhe Legjislacionin për Materialin Mbajllës dhe Shumëzues Bimor dhe OMGJ-ve.

- Shqipëria është anëtarësuar në UPOV (Unioni për Mbrojtjen e Varieteteve të Reja të Bimëve) me seli në Gjenevë Zvicër, në bazë të Marrëveshjes zyrtare të Qeverisë Shqiptare (MBZHR) më 15 tetor të vitit 2005, duke sjellë mundësi të reja për Shqipërinë në sektorin bimor, përmirësimin e standardeve të varieteteve të bimëve dhe për të lehtësuar aksesin në tregjet ndërkombëtare. Bashkëpunimi është i bazuar në standarde ndërkombëtare për mbrojtjen e varieteteve të reja të bimëve, duke sjellë zhvillim të mëtejshëm të sektorit bujqësor, përmirësim të varieteteve të reja të bimëve dhe ofrim të mbrojtjes ligjore⁷² që vepron, për rritjen e prodhimit dhe konkurrueshmërisë së bimëve të kultivuara në vend. Shqipëria mund të eksportoje produkte bimorë të cilat plotësojnë këto standarde duke pasur akses në tregjet ndërkombëtare të huaja më lehtësisht. Në referim të ligjit⁷³ përkufizimet dhe dispozitat juridike përcaktojnë se, ESHFF duhet të administrojë dhe mirëmbajë regjistrin e së drejtës të seleksionuesit, për të gjithë personat fizikë dhe juridikë që kanë

⁶⁹Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar

⁷⁰Urdhri i Kryeministrit nr.88, datë 20.05.2022, dhe Urdhri i Ministrit të MBZHR nr.318 datë 04.07.2022 “Për miratimin e strukturës së MBZHR”.

⁷¹Urdhri i KM nr.185 datë 29.03.2023 “Për organizimin dhe funksionimi e brendshëm të MBZHR-së” dhe Rregullores nr. 185, datë 29.03.2023.

⁷² Ligji nr.10416 datë 07.04.2011 “Mbi materialin mbjellës dhe shumëzuesin bimor” i ndryshuar;

Ligji nr.8880 datë 15.04.2002 “Për të drejtat e seleksionerit të bimëve”

⁷³ Ligji nr.8880 datë 15.04.2002 “Për të drejtat e seleksionuesit të bimëve” neni 3 (pika 17), neni10, neni19 dhe neni 23.

fituar të drejtën në fjalë. ESHFF-ja duhet ti botojë në mënyrë periodike të dhënat që kanë lidhje me mbrojtjen e varieteteve bimor⁷⁴.

Kohëzgjatja e të drejtës së seleksionuesit për bimët e arave është 20 vjet, ndërsa për bimët drufrutorë, shkurret dhe drurët zbukurues zgjat 25 vjet, të cilat fillojnë në momentin e aplikimit.⁷⁵ Transferimi i teknologjisë dhe njohurive, nëpërmjet bashkëpunimit me UPOV, është mundësi në prodhimin bimor dhe përpunimin e bimëve, duke ndihmuar në rritjen e kapaciteteve vendore dhe zhvillimin e ekspertizës në bujqësi.

Më 30 gusht 2005, Zyra e Unionit (UPOV) mori një njoftim se legjislacioni që rregullon të drejtat e mbarështuesve të Shqipërisë zbatohet për listën e mëposhtme të gjinive dhe specieve:⁷⁶

Tabela 7: Lista e specieve shqiptare në UPOV

NR	Kultura	Emri botanik	NR	Kultura	Emri botanik
1	Gruri	Triticum Aestivum	12	Fasule	Paseolus sp.
2	Elbi	Hordeum Vulgare	13	Bizele	Pisum Sativum
3	Tërshëra	Avena Byzantine	14	Thjerrëzat	Ervum Lens
4	Thekra	Secale Cereale	15	Alfa alfa(jonxha)	Medicago Sativa
5	Misri	Zea Mays	16	Tërfili	Trifolium sp.
6	Domate	Lycopersion Esculentum	17	Ryegrass (thekra)	Ryegrass
7	Kastravec	Cucumis Sativus	18	Mollë	Malus Pumila
8	Piper	Capsicum annum	19	Dardhë	Pyrus Communis
9	Luledielli	Helianthus Annuus	20	Kumbulla	Prunus Domestica
10	Patate	Solanum Tuberosum	21	Pjeshkë	Prunus Persica
11	Panxhar sheqeri	Beta Vulgaris	22	Hardhia e rrushit	Vitis Vinifera

UPOV në faqen zyrtare ka bërë rekomandimet e veta, që MBZHR duhet të realizojë përshtatjen e ligjit për të drejtat e seleksionerit me aktin e Konventës së UPOV-it të vitit 1991⁷⁷. Këto ndryshime nuk janë realizuar ende nga MBZHR dhe ESHFF⁷⁸, duke mos respektuar bashkëpunimin me UPOV, ku vendi ynë aderohet me të drejta të plota. Për periudhën 30 gusht 2005- dhjetor 2022, u konstatua se, funksionimi i ligjit për të drejtat e seleksionerit ekziston “*de jure*”, por “*de facto*” nuk është përdorur, pasi në Shqipëri nuk është regjistruar asnjë varietet i ri për të drejtën e seleksionuesit në Shqipëri. Shteti Shqiptar (MBZHR) që prej vitit 2005 e në vazhdim, paguan 10,728 CH (Franga zvicerane) në vit, si tarifë vjetore e anëtarësimit të vendit tonë në UPOV. (pra për një periudhë 18 vite janë paguar vlëra prej $18 \times 10,728 \text{ CH} = 193,104 \text{ CH}$).

Enti Shtetëror i Farërave dhe Fidanë⁷⁹ (ESHFF), kryen procesin e kontrollit të monitorimit të materialit sipas kërkesave të subjekteve për testim të varieteteve për regjistrim në katalogun kombëtar, kryen analizat laboratorike të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor si dhe kryen

⁷⁴ Ligji nr.8880 datë 15.04.2002 “Për të drejtat e seleksionuesit të bimëve” neni 18 pika 1 dhe neni 19 pika 1.

⁷⁵ Ligji nr.8880 datë 15.04.2002 “Për të drejtat e seleksionuesit të bimëve” neni 23

⁷⁶ <https://www.upov.int/edocs/gendocs/en/al/al001.pdf>

⁷⁷ https://www.upov.int/meetings/en/doc_details.jsp?meeting_id=5444&doc_id=22643

⁷⁸ Përgjigja e pyetësorit nr.2 datë 26.06.2023 nga MBZHR(Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së bimëve dhe Peshkimit)

⁷⁹ Ligji nr.10416 datë 07.04.2011 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor” i ndryshuar (aktet nënligjore të miratuara në zbatim të tij) dhe të VKM nr.204 datë 04.03.2025 “Për organizimin dhe funksionimin e ESHFF”.

procesin e certifikimit të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor. Në vijim skema e organikës së ESHFF:




Figura 8: Organigrama e Entit Shtetëror të farave dhe Fidanëve:

III. Gjatë fazës së terrenit të këtij auditimi dhe pas fokusimit

Struktura organizative dhe organika e ESHFF –së miratohet me urdhër të Kryeministrit, si vijon:

Tabela 22: Struktura e Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve (ESHFF)

Struktura e ESHFF	Drejtori i ESHFF	Sektori i Testimit	Sektori i Certifikimit	Sektori i laboratorit testues	Sektori i Financës	Totali
Numri i të punësuarve vitin 2020 plan/fakt	1/1	4/2	5/3	3/2	3/3	16/11
Numri i të punësuarve për vitin 2021 plan/fakt	1/1	4/2	5/3	3/2	3/3	16/11
Numri i të punësuarve vitin 2022 plan/fakt	1/1	4/2	5/3	3/2	3/3	16/11

Burimi i informacionit ESHFF, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.

Marrëdhëniet e punës në këtë Institucion rregullohen sipas legjislacionit në fuqi të nëpunësit civil nga Departamenti i Administratës Publike (DAP).

Disa nga shkaqet kryesore të mos rekrutimit të punonjësve fitues, është përparësia e tregut privat ndaj atij shtetëror sepse ofron paga më të larta për profesionin: agronom.

Sipas organigramës së miratuar, numri i punonjësve të planifikuar të ESHFF është 16 punonjës, ndërsa gjendja faktike për periudhën në auditim është 11 punonjës, d.m.th. janë 5 (pesë) vende vakant ose 30% e burimeve njerëzore në mungesë, dhe kjo kryesisht në dy sektorët kryesorë të ESHFF që janë Sektori i Testimit të Varieteteve dhe Sektori i certifikimit zyrtar.

Këta sektorë kanë peshën kryesore në rolin e kontrollit dhe inspektimit pasi Sektori i Testimit të Varieteteve organizon dhe kontrollon punën për kryerjen e provave zonale të testimit të varieteteve dhe Sektori i certifikimit zyrtar kryen kontrollin zyrtar dhe “aprobimin fushor”, të parcelave të prodhimit të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor për zbatimin e kushteve teknike të zbatuara, sipas kërkesave dhe kriterëve ligjore, për çdo specie dhe varietet që kërkohet të certifikohet. Për mungesa e specialistëve në sektorët kryesorë të strukturave ka sjellë jo efektivitet të sektorëve për periudhën në auditim.

ESHFF në mënyrë të vazhdueshme ka kërkuar pranë MBZHR-së dhe DAP për plotësimin me burime njerëzore të vendeve të punës

Në bazë të detyrave funksionale të ESHFF, nëpërmjet sektorëve të saj, realizon procedurat si vijon:

- *certifikimin zyrtar*, e cila kryhet në bazë të vlerësimit dhe pranimin e kërkesave të subjekteve të ndryshme të vendit (furnizuesi) të QTTB-ve, që konsiston në:

a) Mbikëqyrjen e mbjelljeve ose të plantacioneve për fara dhe material mbjellës dhe shumëzues bimor, të ngastrave të tokës, të pajisjeve për prodhimin, ruajtjen dhe përgatitjen për treg të tyre;

b) kontrollin e evidencave dhe regjistrave të mbajtura nga furnizuesi, në përputhje me kërkesat e ligjit;

c) marrjen e mostrave

- *testimin*, i cili bazohet në provat krahasuese, që kryhet në dy a më shumë zona, për të treguar aftësinë prodhuese dhe cilësore të një varieteti.

- *analizimin zyrtar të mostrave*, i cili ka të bëjë me cilësinë e MBSHB, me pastërtinë, gjendjen shëndetësore, fuqinë mbirëse të farave dhe fidanëve për mbjellje dhe riprodhim.

Nga dokumentet dhe informacionet e audituara dhe të përgjigjeve të pyetësorëve të vendosura në dispozicion nga ESHFF, u konstatua se:

III. Gjatë fazës së terrenit të këtij auditimi dhe pas fokusimit

-Për periudhën në auditim nga ESHFF sektorët respektivë paraqiten si vijon:

Sektori i testimeve me strukturë (1+3) punonjës, 2 (dy) vende vakant, ka realizuar 147 testime, 41 regjistrime në Katalogun Kombëtar;

Sektori i certifikimit me strukturë (1+4) punonjës, 2 (dy) vende vakant, ka certifikuar 3,078,800 kg drithëra; 69,002,150 fidanë perime & bostanore; 1,787,050 fidanë bimë medicinale dhe 1,787,050 fidanë drufrutorë.

Sektori i certifikimit, nuk ka Plan Kontrolli vjetor, pasi ky sektor monitoron në bazë të aplikimeve dhe kërkesave që operatorët bujqësorë kryejnë në momentin e certifikimit të farave dhe fidanëve.

Nisur nga kjo në vijim jepet ecurinë e monitorimit në terren nga ky sektor për periudhën në auditim.

Tabela 23: Ecuria e monitorimit në terren nga Sektori i Certifikimit.

Emërtimi	Numri i subjekteve			Numri i certifikatave			Totali		
	2020	2021	2022	2020	2021	2022	2020	2021	2022
Pemë frutore	60	66	35	90	91	26	800,000 Rrënjë	616,400 Rr	370,650 Rr
Perime	4	15	28	19	40	141	6,911,800 Rr	9026650 Rr	53,049,950 Rr
Dekorative	2	16	5	3	17	11	5,655 Rr	453,654 Rr	400,232 Rr
Medicinale	7	12	1	18	23	1	22,760,000 Rr	78,404,000 Rr	3300 Rr

Farë Gruri	13	13	13	30	27	30	10,376 Kv	9,634 Kv	10,636 Kv
Farë Patate	1	=	1	1	=	1	300 Kv	=	80 Kv
Farë Misri	1	2	2	1	3	4	33 Kv	100 Kv	79 Kv

Burimi ESHFF, përpunoi grupi i auditimit.

Burimi ESHFF, përpunoi grupi i auditimit.

-Për vitet 2020 dhe 2021, ESHFF nuk ka hartuar Plane Veprimi për monitorimin e aktiviteteve, ndërsa për vitin 2022⁸⁰ është realizuar.

-ESHFF ka hartuar Plane të shërbimeve, udhëtimeve e dietave për trajtim financiar, të miratuara nga MBZHR (Drejtori i Përgjithshëm i Politikave dhe Programeve të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural⁸¹). Qëllimi i planeve të shërbimit ka siguruar mbështetjen me trajtim financiar të punonjësve nga sektori i certifikimit zyrtar dhe testimit të varieteteve, që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendi. Mbi punën e realizuar nga këto shërbime janë përgatitur informacione për efekte të marrjes së dietave, por nuk janë të pasqyruara problematikat e mundshme të evidentuara ose risqet e hasura, me qëllim rritjen dhe efektivitetin e kontroleve për:

(i) rritjen e garancisë gjenetike dhe cilësore në prodhimin e materialit mbjellës bimor;

(ii) rritjen e kontrollit fitosanitar dhe origjine

(iii) rajonizimin dhe aklimatizimin të përshtatshëm

(iv) rritjen e prodhimit vendas.

- *Sektori i Laboratorit Qendror i Testimit të Farës (LQTF)* në ESHFF, është krijuar në vitin 1996 me mbështetje të një projekti të USAID-it. Ky projekt bëri të mundur ngritjen e laboratorit dhe pajisjen e tij me mjetet e domosdoshme për kryerjen e testimit të treguesve fizikë të farërave si fuqia mbirëse, lagështia, pastërtia mekanike dhe identifikimi farave të huaja.

- Laboratori Qendror i Testimit të Farave, nuk është i akredituar, ndonëse kryerja e analizave laboratorike, zyrtare, për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor është detyrim ligjor⁸² të bëhet nga laboratorë të akredituar dhe të miratuar si laborator reference nga ministri i MBZHR-së.

-Infrastruktura me pajisje dhe materiale laboratorike, në ESHFF paraqitet në nivele jo bashkëkohore, ndonëse Shqipëria është anëtare në ISTA (Shoqata Ndërkombëtare e Testimit të Farave) që prej vitit 1998. Anëtarësimi i Laboratorit Qendror i Testimit të Farës, ka bërë të mundur aplikimin e zhvillimit të procedurave standarde në fushën e testimit të farës, promovimin në mënyrë aktive kërkimin dhe shpërndarjen e njohurive në shkencën dhe teknologjinë e farës, për marrjen e mostrave, testimin, ruajtjen, përpunimin dhe shpërndarjen e farërave, në përshtatshmëri me rregulloren⁸³ e shoqatës.

Deri në shtator të vitit 2022, LQTF ka punuar me pajisje të siguruar nga projekti i USAID, më pas është pajisur me 2(dy) copë germinatorë për mbirjen e farave (për analizën e fuqisë mbirëse), 2(dy) aparate për matjen e shpejtë të lagështisë së farës dhe pH metër.

⁸⁰Plan Veprimi dhe objektivat për vitin 2022, me shkresë nr.32 prot datë 24.01.2022.

⁸¹Shkresa nr.8231/1prot datë 03.02.2020; shkresa nr.1899/1 prot datë 02.02.2021 dhe për vitin 2022

⁸² Ligji nr.10 416, datë 7.4.2011 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor” i ndryshuar, neni 44

⁸³Manuali i ISTA depozituar në ESHFF (Seed Science and Technology)



Figura 9: Laboratori Qendror i ESHFF

Analiza e fuqisë mbirëse kryhet vetëm me letër thithëse me kuti plastike, pjata petri të cilat janë material konsumi.

Spektori i Laboratorit Qendror i Testimit të Farës (LQTF) me strukturë (1+3) nëpunës civilë me 1(një) pozicion vakante, realizon testimin e cilësisë së farës, të vlerësimit të kapacitetit të mbirjes së saj, të përcaktimit të përbërjes në përqindje të farërave të pastra, të lëndëve të jashtme dhe përmbajtjes së lagështirës, në zbatim të detyrave funksionale. Për periudhën në auditim numri i analizave të realizuara prej LQTF, paraqitet si vijon:

Tabela 24 Numri i analizave të realizuara nga Laboratori Qendror i Testimit të Farës në ESHFF

Viti	Analiza për certifikim (mostra të marra nga specialistët e ESHFF-së zyrtare)	Analiza për cilësinë e farës dhe për vitalitetin e farës të sjella nga AKU (zyrtare)	Analiza për llogari të UBT(Universiteti Bujqësor Tiranë)	Analiza për efekt kontrolli për verifikimin e rënies së fuqisë mbirëse (ri testim) Private
2020	281	231	5	Nuk ka të dhëna
2021	286	197	11	Nuk ka të dhëna
2022	409	154	0	Nuk ka të dhëna
TOTALI	976	582	16	
1574				

Burimi i informacionit ESHFF, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.

Në referim të të dhënave të mësipërme, konstatohet se për vitet në auditim numri i analizave për cilësinë e farës të sjella nga AKU, është në ulje, ndërsa numri i analizave për certifikim (mostra të marra nga specialistët e ESHFF-së) është në rritje. Etiketa shoqëruese e mostrës që analizohet në laboratorin e ESHFF, paraqitet nëpërmjet kodit sekret të mostrës, për këtë arsye laboratori nuk ka dhëna se sa prej mostrave të sjella nga AKU veçanërisht ato që janë për ri testim të stokut të materialit mbjellës shumëzues dhe bimor.

Për më sipër, ESHFF është një institucion i vogël me burime njerëzore, nuk ka infrastrukturë që të administrojë toka bujqësore për realizimin e procesit të testimit, të cilin e realizon me anë të QTTB-ve në vend. Laboratori Qendror i Testimit të Farës, nuk është i akredituar, ndonëse kryerja e analizave laboratorike, zyrtare, për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor është detyrim

ligjor të bëhet nga laboratorë të akredituar i miratuar si laborator reference nga ministri i MBZHR-së.

Mungesat e sipërcituara, tregojnë se ky institucion realizon procese të fragmentizuara me AKU dhe QTTB si dhe vetë ESHFF nuk e ka mundësinë e plotë në përmbushje të qëllimit të saj që është: Sigurimi i cilësisë së materialit mbjellës dhe shumëzues bimor për mbështetjen e prodhimit bujqësor dhe mbrojtjen e konsumatorit.

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU), është institucion në varësi të MBZHR-së dhe është përgjegjës për veprimtarinë e inspektimeve zyrtare në zbatim të ligjit⁸⁴. AKU kryhen kontrole zyrtare në Pikat e Inspektimit Kufitar (PIK) dhe në terren, pranë operatorëve të biznesit që ushtrojnë aktivitetin e MMSHB të importuara dhe/ose të prodhuara në vend, lidhur me plotësimin e kërkesave ligjore për tregtim, në bazë të planit vjetor të inspektimeve me bazë rrisht.

Struktura e AKU-së jepet në skemën e mëposhtme:




Figura 10: Organigrama e AKU-së.

Struktura e AKU-së e miratuar⁸⁵ në lidhje mbi kontrollin dhe inspektimin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të siguruar nga importi dhe nga prodhimi vendas, ka sektorin e PIK-ut me 4 inspektorë në Drejtorinë e Përgjithshme të AKU dhe 18 inspektor në PIK-et rajonale.

-Sektori i Koordinimit, Kontrollit të mbrojtje së bimëve dhe In-puteve Bujqësore (KKMBIB) ka në organikë: 4 inspektor në Drejtorinë e Përgjithshme të AKU dhe 45 inspektor në terren në 12 Drejtoritë Rajonale të AKU, me dy vende (pozicione) vakant.

Në referim të dokumenteve të audituara nga AKU, konstatohet ky aktivitet pune, paraqitur në tabelën që vijon:

⁸⁴ Ligji nr.10416 datë 07.04.2011 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor” i ndryshuar neni 13, 24, 42, 43 dhe 44.

⁸⁵ Urdhri i KM nr.128 datë 26.10.2020 “për miratimin e strukturës dhe organikës së AKU-së”.


Tabela 25: Përmbledhëse me të dhënat për numrin e furnizuesve, inspektimet e planifikuara dhe të realizuara për periudhën në auditim.

nr.	Viti	Nr. i furnizuesve me aktivitet MMSHB sipas planit	Nr. i inspektimeve me aktivitet MMSHB te planifikuara	Nr. i inspektimeve me aktivitet MMSHB te realizuara	% e realizimit me inspektimet e planifikuara me aktivitet MMSHB
1	2020	679	1555	1312	84,30%
2	2021	695	1567	1642	104,78%
3	2022	818	1872	1725	92,14%

Burimi i informacionit AKU, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.

Më poshtë jepen grafikisht të dhënat e planifikimeve/inspektimeve të kryera nga AKU.

Grafiku 10



Referuar të dhënave të mësipërme, rezulton se, numri i furnizuesve që sigurojnë materialin mbjellës dhe shumëzuesin bimor në vendin tonë, ka trend rritje nga viti 2020 deri 2022 me 139 subjekte, ose me 20.47 % më shumë.

Inspektimet zyrtare të furnizuesve për plotësimin e kërkesave për tregtimin të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të parashikuara në ligjin për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor, të cilat kryen në bazë të “Planeve Kombëtare të Kontrollleve Zyrtare me bazë Risku dhe të marrjes së Mostrave për Ushqimin, Ushqimin për Kafshë, Mbrojtjen e Bimëve dhe Input-eve Bujqësore, si dhe Planin e marrjes së Mostrave në PIK”, të miratuar nga Ministri i Bujqësisë⁸⁶ sipas udhëzimeve si dhe në bazë të rasteve të parashikuara nga legjislacioni i posaçëm në fushën e inspektimit, është në rritje në vite gati me 10%. Në përgjigje të inspektimeve, për materialin e farave dhe fidanëve, nga AKU janë vendosur masa administrative gjatë kontrolleve zyrtare të kryera në operatorët e biznesit që ushtrojnë aktivitetin në fushën e MMSHB-ve, në rastet kur furnizuesit nuk plotësojnë kërkesat e parashikuara në ligji dhe konkretisht:

⁸⁶Udhëzim nr. 2, datë 24.2.2020, Udhëzim nr. 3, datë 18.1.2021 & Udhëzim nr. 24, datë 31.12.2022. “Për miratimin e Planit Kombëtar të Kontrollleve Zyrtare me bazë Risku dhe të marrjes së Mostrave Për Ushqimin, Ushqimin për Kafshë, Mbrojtjen e Bimëve dhe In-put-eve Bujqësore, si dhe Planin e marrjes së Mostrave në PIK”

Tabela 26: Masat administrative të marra për vitet 2020, 2021, 2022.

Qarku	Masat administrative																		
	Paralajmerime			Gjoha								Bilokim Tregtim MMSHB (ton)				Asgjesim produkti MMSHB (ton)			
	2020 – 2021	2022	Total Paralajmerim	2020		2021		2022		Totali gjoha	Vlera /000 leke	2020	2021	2022	Total Bilokim	2020	2021	2022	Total Asgjesime
				Nr.gjoh	Vler/000 lekë	Nr.gjoh	Vler/000 lekë	Nr.gjoh	vler/000 lekë										
TIRANE	0	0	0	1	200	2	400	0	0	3	600	0,003	0	0	0,003	0	8,177	16,87	25,047
VLORE	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
LEZHE	0	0	0	2	400	0	0	0	0	2	400	0,2	0	0	0,2	0	0	0	0
GJIROKA	0	0	0	0	0	0	0	1	70	1	70	0	0	0,000495	0,000495	0	0	0	0
KUKES	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
KORCE	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	26	0	0	26	26	0	0	26
BERAT	0	0	0	3	470	1	200	3	470	7	1140	0,825	0	0,0005	0,8255	0	0,011	0	0,011
ELBASAN	0	8	8	1	200	1	200	1	20	3	420	0	0	0	0	0	0	0	0
SHKODER	0	0	0	2	400	3	450	0	0	5	850	0,05	0,03	0	0,08	0	0	0	0
DIBER	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
FIER	0	0	0	1	200	5	900	0	0	6	1100	0	0	0	0	23,8	0	0	23,8
DURRES	0	0	0	2	400	1	200	0	0	3	600	0	0	0	0	0	0	0	0
TOTAL	0	8	8	12	2270	13	2350	5	560	30	5180	27,078 ton	0.03 ton	0,001	27.109	49,8 ton.	8,188 ton.	16,87 ton.	74,86 ton

Burimi i informacionit AKU, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.

Gjithashtu, për periudhën në auditim, nga ana e AKU-së janë hartuar dhe dërguar shkresa të personalizuar për furnizuesit të MMSHB-ve (fara dhe fidanë), me qëllim sensibilizimin e tyre për njohjen e tyre me bazën ligjore apo ndryshimet ligjore, si dhe vëmendje të shtuar nga ana e furnizuesit për të ri analizuar çdo 6 muaj MMSHB-të (fara) për pajisjen me fletë analize të lotit të farës (për fuqinë mbirëse), si dhe certifikimin e fidanëve të prodhimit vendas dhe pajisjen e tyre me certifikatë zyrtare nga ESHFF.

Krahas volumit të punës së evidentuar të AKU-së, në lidhje me mënyrën e funksionimit të marrjes së mostrave ose kampionëve për analiza laboratorike të dërguara në ESHFF-së, rezultoi se:

- Në lidhje me zbatimin e planit të marrjes dhe analizimit të mostrave për periudhën 2020-2022 rezultoi se nga AKU janë planifikuar për tu analizuar në laboratorin e ESHFF 527 mostra MMSHB (fara), dhe janë marrë dhe dërguar për analizimin e fuqisë mbirëse 596 mostra në laboratorin e ESHFF. Nga përgjigjet e analizave ka rezultuar se 581 konform dhe 15 jo konform. Për mostrat jo konform nga Drejtoritë Rajonale të AKU-së respektive janë marrë masat administrative të parashikuara në legjislacionin në fuqi, duke bllokuar për tregtim MMSHB-je 27 ton (fara) me tregues cilësor (fuqi mbirëse) më të ulët se normat e lejuara për mbjellje si dhe asgjësuar 74 ton (MMSHB-ve (Fara) me tregues cilësor (fuqi mbirëse) më të ulët se normat e lejuara për mbjellje (tab nr. 25).

- Nuk ka bashkëpunim ndërmjet AKU- ESHFF, për sasitë e bllokuara apo sasitë e asgjësuar të furnizuesve për (fara) me tregues cilësor (fuqi mbirëse) më të ulët se normat e lejuara për mbjellje.

- Në referim të bazës ligjore⁸⁷ konstatohet se mostrat për ri analiza laboratorike duhet të merren nga specialisti i autorizuar i ish- Drejtorive të Bujqësisë sot AREB-et. (Trajtuar më hollësisht në pyetjen 4.1.2) dhe jo nga struktura të AKU-së apo të ESHFF-së.

Sa më sipër, hallka e mekanizmit të zinxhirit, për kryerjen e ri analizave për treguesit e fuqisë mbirëse për mostrat e çdo specijeje, varieteti dhe loti, të importuara apo të prodhuara në vendin tonë, nuk ka funksionuar dhe për rrjedhojë paraqet risk të shtuar në cilësinë e MMSHB-së, si një tregues mjaft i rëndësishëm për monitorimin dhe menaxhimin e tregut të produkteve bujqësore.

-MBZHR, ESHFF dhe AKU nuk kanë të dhëna të rakorduara për sasitë e eksporteve për të nxjerrë saktë sasitë e MMSHB të certifikuara të cilat janë mbjellë në Shqipëri dhe rrjedhimisht për

⁸⁷Ligji nr.10416 datë 07.04.2011 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor” i ndryshuar, neni 42, pika1/a

kontrollin me bazë risku të furnizuesit, duke veçuar detyrimet ligjore që kanë aktorët e menaxhimit të këtij sistemi, më konkretisht:

(i) Në referim të ligjit⁸⁸, në lidhje mbi sasitë e importuara për fara dhe fidanë nga furnizuesi (operatorë bujqësor) shprehet se *“ESHFF-ja duhet të verifikojë dhe të analizojë mostrat për të gjitha sasitë e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të importuar, për çdo specie, varietet dhe lot, të sjella nga inspektoriati që mbulon fushën përkatëse pranë Autoritetit Kombëtar të Ushqimit. Çdo 6 muaj, ESHFF-ja duhet të pranojë për rianalizim në laboratorin e saj treguesit e fuqisë mbirëse mostrat e çdo speciejë, varietetit dhe loti, të importuara apo të prodhuara në vendin tonë”*

(ii) Sipas ligjit⁸⁹, sipas përkufizimeve, *“çertifikim zyrtar”* është një procedurë e përcaktuar, që kryhet nga ESHFF-ja, në bazë të kërkesës së paraqitur nga furnizuesi, i cili është çdo person fizik ose juridik, vendas apo i huaj që kryen të paktën njërën nga veprimtaritë (prodhim, përgatitje për tregtim, tregtim, import/eksport) të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor.

(iii) si dhe sipas ligjit⁹⁰, *furnizuesi midis detyrimeve të tjera, duhet të mbajë të dhëna dhe ruan evidencat e prodhimit, furnizimit ose importit për përgatitjen për treg, stoqet dhe shitjet e materialit mbjellës dhe shumëzuesit bimor.*

(iv) Në bazë të Rregullores së brendshme të funksionimit të ESHFF-së⁹¹, në detyrat funksionale që kryen Sektori i Çertifikimit pika 5/11 si dhe detyrat funksionale të specialistit të këtij sektori shprehet se *“Kontrollon të dhënat e mbajtura nga furnizuesi për mirëmbajtjen e një varieteti, për sigurimin ose blerjen e materialit mbjellës dhe shumëzuesit bimor, prodhimin, furnizimin ose importin, përgatitjen për treg, stoqet dhe shitjet.”*

Sa më sipër, nuk ka dhëna mbi sasitë e stokut të materialit mbjellës dhe shumëzuesit bimor që mund të jenë krijuar nga operatorët bujqësorë, duke shtuar riskun që materiali stok mund të përdoret nga furnizuesit në drejtim të fermerëve e për rrjedhojë prodhimi bujqësor i siguruar nga materiali stok (fara dhe fidanë) nuk është i certifikuar.

Qendra e Transferimit të Teknologjisë Bujqësore⁹²(QTTB), janë pesë qendra institucione në varësi të MBZHR-së. Bashkëpunimi midis ESHFF-së me QTTB-të, për ngritjen e provave fushore, realizohet midis tyre në bazë të Marrëveshjeve për kryerjen e provave të testimit të varieteteve. QTTB-të kanë përgjegjësi për transferimin e teknologjive bazuar në provat e testimit varietor të materialit mbjellës dhe shumëzuesit bimor, në zbatim të legjislacionit për fara dhe fidanë, me qëllim në nxitjen e konkurrueshmërisë së bujqësisë.

Bashkëpunimi me QTTB-të, realizohet në mbështetje të akteve nënligjore për fazën e testimit si dhe në mungesë të infrastruktuës së ESHFF-së me sipërfaqe të tokës bujqësore, të numrit minimalist të punonjësve që ka struktura e ESHFF-së.

ESHFF në bashkëpunim me QTTB përgatit skemën e testimit dhe merr pjesë në procesin e caktimit të ngastrës së tokës dhe mbjelljes së materialit mbjellës dhe shumëzues bimor. Testimi i varietetit

⁸⁸ Ligji nr.10416 datë 07.04.2011 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor” i ndryshuar, neni 23, neni 24, neni 27, neni 28, neni 41 pika e.

⁸⁹ Ligji nr.10416 datë 07.04.2011 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor” i ndryshuar, neni 3 (Përkufizime) pika 1,2, 3,5.

⁹⁰ Ligji nr.10416 datë 07.04.2011 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor” i ndryshuar, neni 10 (detyrimet e furnizuesit) pika d dhe neni 12 (Deklarimi i prodhimit të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor).

⁹¹ Rregullore e brendshme e funksionimit të ESHFF, miratuar me shkresë nr.2391/3 prot datë 01.06.2020 nga Ministri i MBZHR.

⁹² VKM nr.515 datë 19.07.2006 “Për ristrukturimin e Instituteve Kërkimore Shkencore në varësi të Ministrisë së Bujqësisë” i ndryshuar.

kryhet për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor në afate kohore të ndryshme në varësi të varietetit. Periudhat e testimit të varietetit fillojnë nga momenti i mbjelljes së mostrës së materialit mbjellës dhe shumëzues bimor deri në daljen në prodhim të frytit të tij. Për bimët e arave dhe perimet është deri në një vit, ndërsa për drufrutorët është 3 vjet. Për periudhën në auditim për vitet 2020-2022, ESHFF ka lidhur kontrata bashkëpunimi për testimin e varieteteve me QTTB-të Shkodër, Lushnjë, Vlorë dhe Korçë për testimin e varieteteve të misrit të hershëm të mesëm dhe të vonë, për testimin e varietetit të grurit të butë, bizele, pazi, sallatë, patate e hershme dhe patate e vonë si dhe mollë kumbull caperi dhe lajthi.

Tabela 27: Struktura me punonjës të QTTB për periudhën në auditim

Qendrat e Trasferimit Teknologjik Bujqësor (QTTB)	Viti 2020		Viti 2021		Viti 2022	
	plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt
QTTB Fushë Krujë	61	46	61	44	61	45
QTTB Shkodër	32	20	32	24	32	26
QTTB Lushnjë	37	32	37	30	37	32
QTTB Vlorë	30	25	30	25	30	25
QTTB Korçë	32	27	32	27	32	27
TOTALI	192	150	192	150	192	155

Burimi i informacionit, QTTB, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.

Në referim të të dhënave të mësipërme, konstatohet që numri i punonjësve pranë QTTB janë me 30% të pozicioneve të punës janë vakante. Vlen të theksohet se punonjësit e QTTB, krahas detyrave funksionale të tyre, realizojnë edhe me ESHFF kontratat e shërbimit për testimin e varieteteve. QTTB ndonëse merren me përpunimin e të dhënave shkencore për testimin e farave dhe fidanëve, laboratorët që janë të përfshirë në to janë në gjendje të degraduar. Baza materiale e laboratorëve të tyre i përkasin kohës të ish Instituteve kërkimore shkencore për Bujqësinë. Mungesa e investimeve për infrastrukturën e laboratorëve të cilët janë edhe të pa akredituar si dhe mungesa më burime njerëzore, shton riskun për të pasur të dhëna shkencore jo cilësore, e për rrjedhojë cilësia e tyre ndikon në materialin mbjellës dhe shumëzuesin bimor.

1. Gjetja nga auditimi: Në referim të detyrave funksionale sipas rregulloreve të funksionimit të brendshëm të MBZHR, për periudhën 2020-2022, nga auditimi *konstatuam se:*

- Nuk ka pasur struktura dhe detyra funksionale të dedikuara për monitorimin e farave, fidanëve dhe materialin mbjellës dhe shumëzues bimor dhe rrjedhimisht nuk ka as targete të plotësuar në referim të prioriteteve strategjike.

- Sektori i Shëndetit të Mbrojtjes së bimëve dhe OMGJ në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nuk ka kryer analiza operationale periodike për menaxhimin dhe monitorimin e funksionimit të sistemit të farave, fidanëve dhe materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, në koordinim me institucionet e varësisë (ESHFF, AKU dhe QTTB).

-nuk ka informacion dhe të dhëna reale në lidhje me sasinë e stokut të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor (MBSHB) në magazinat e furnizuesve, nga inspektorët e Pikave të Inspektimit Kufitar (PIK-ut) të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, e cila sjell mungesë të dhënash në të gjithë zinxhirin administrativ të funksionimit të procesit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

-Mungojnë planet për trajnimin e specialistëve në fushën e farave dhe fidanëve për periudhën 2020-2022.

1.1 Rekomandimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të bashkëpunojë me strukturat e saj inspektuese dhe monitoruese duke konkretizuar veprime me objektiva të matshëm dhe afate të përcaktuara me qëllim evidentimin në kohë të problemeve, rritjen e rolit të saj si institucioni qendror në politikë bërje dhe llogari dhënie.

Në vijimësi

2. Gjetja nga auditimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Enti Shtetëror i Farave nuk kanë realizuar rekomandimet e UPOV-it, për periudhën 30 gusht 2005- dhjetor 2022 pasi nuk është regjistruar asnjë varietet i ri për të drejtën e seleksionerit në Shqipëri duke mos respektuar bashkëpunimin me këtë organizatë, ku vendi ynë aderom me të drejta të plota.

2.1 Rekomandimi: Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve të marrë masa dhe të rrisë bashkëpunimin me institucionet kërkimore shkencore siç është Universiteti Bujqësor i Tiranës për verifikimin e specieve që plotësojnë kushtet shkencore për njohjen e tyre si varietete të reja për të drejtën e seleksionerit në Shqipëri.

Në vijimësi

3. Gjetja nga auditimi: Për periudhën 2020-2022, në referim të detyrave funksionale sipas rregulloreve të funksionimit të brendshëm dhe sipas organigramës së miratuar, konstatohet se numri i punonjësve të planifikuar të institucionit Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve është me 30% mungesë të burimeve njerëzore në sektorët kryesorë për monitorimin dhe kontrollin e procesit të testimit dhe certifikimit të materialit mbjellës shumëzues bimor.

3.1 Rekomandimi: Entin Shtetëror i Farave dhe Fidanëve në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të marrin masa të plotësojnë të gjitha vendet bosh në organikën e saj.

Brenda vitit 2024

1. Konkluzioni:

Mos funksionimi me struktura të dedikuara në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural deri në korrik 2022, mungesa me burime njerëzore në Entin Shtetëror të Farave dhe Fidanëve dhe Qendrat e Teknologjisë dhe Transformimit Bujqësor, mungesa në investime për laboratorët e certifikimit të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor me infrastrukturën e nevojshme bashkëkohore, ka sjellë performancë të dobët të sistemit të strukturave të kontrollit dhe të inspektimit në Entin Shtetëror të Farave. Roli i “pa dukshëm” i MBZHR-së në këtë zinxhir nuk ka sjellë përmirësim të kontrollit dhe monitorimit permanent të materialit mbjellës shumëzues e bimor i cili ndikon drejtpërdrejt në rritjen e cilësinë e MMSHB-së.

4. Gjetja nga auditimi: Laboratori Qendror i Testimit të Farave, nuk është i akredituar prej krijimit të tij dhe nuk është ndërmarrë nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve asnjë nismë për fillimin e këtij procesi me rëndësi në sigurinë e Materialit mbjellës dhe shumëzues bimor.

4.1 Rekomandimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në bashkëpunim me Entin Shtetëror të farave dhe Fidanëve të marrin masa për akreditimin e Laboratorit Qendror të Farave në mënyrë që analizat e tij të jenë të besueshme edhe të akredituara.

Brenda vitit 2024

5. Gjetja nga auditimi: Në referim të detyrave funksionale sipas rregulloreve të funksionimit të brendshëm të Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve, për periudhën 2020-2022, nga auditimi konstatuam se:

-Për vitet 2020 dhe 2021, Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve nuk ka hartuar Plane Veprimi për monitorimin e aktiviteteve.

-Nuk ka regjistër apo listë të unifikuar të subjekteve furnizues importues dhe prodhues në vend të materialit mbjellës shumëzues e bimor në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

- Autoriteti Kombëtar i Ushqimit nuk ka një metodologji tip për hartimin e planit të riskut në përcaktimin e saktë dhe korrekt të subjekteve me risk si dhe mungon bashkëpunimi e roli i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve në këtë planifikim.

2. Konkluzion: Mos regjistrimi i asnjë varieteti të ri për të drejtën e seleksionuesit në Shqipëri për një periudhë prej 18 vite tregon për një proces pune kërkimor e shkencor të dobët në drejtim të njohjes së varieteteve të reja të seleksionuesit në Shqipëri duke mos respektuar bashkëpunimin në këtë organizatë.

5.1 Rekomandimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Enti Shtetëror i farave dhe Fidanëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të marrin masa në përgatitjen e një listë të unifikuar të subjekteve importues, tregtues dhe prodhues të materialit mbjellës shumëzues e bimor dhe ta publikojnë atë në faqen zyrtare të web-it.

Brenda datës 31.03.2024

Për projekt Raportin e auditimit të performancës dërguar nga KLSH me nr. 444/7.prot., datë 08.11.2023 për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural , me Or.444/5 datë. 8.11.2023, për Autoritetin Kombëtar të Ushqimit dhe nr. 444/6.prot., datë 8.11.2023 për Entin Shtetëror të Farërave dhe Fidanëve është paraqitur observacion nga MBZHR me shkresën nr.5982/2 datë 11.12.2023 protokolluar në KLSH me nr.444/8.prot., datë 13.12.2023.

Grupi i auditimit shqyrtoi obsevaconin e MBZHR dhe trajtimi i tijë ndodhet në Aneksin nr.1 bashkëngjitur raportit të auditimit.

6. GRUPI I PUNËS

1. E. LL, përgjegjëse e grupit
2. V. G, anëtare
3. L. GJ, anëtar

KONTROLI I LARTË I SHTETIT